



Terre des hommes  
Ndihmë për fëmijët.



VOICE OF ROMA, ASHKALI  
AND EGYPTIANS IN KOSOVO



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera  
- Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/  
Office on Good Governance

# HULUMTIM KOMBËTAR MBI MARTESAT E HERSHME TEK KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOSOVË

Qershor 2025



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



**Të drejtat e njeriut janë të panegociueshme, veçanërisht të drejtat e fëmijëve, me theks të veçantë te grupet e cënueshme të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.**

Ky raport është realizuar me mbështetjen e një konsorciumi të përbërë nga tri organizata: Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (VoRAE), Fondacioni Terre des hommes (Tdh) dhe Swiss Church Aid (HEKS/EPER), në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në kuadër të projektit: *“Drejtësia sociale për Romët, Ashkalit dhe Egjiptianët në Kosovë”* që financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)

Opinionet e shprehura në këtë hulumtim u përkasin autorëve ose personave të intervistuar dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të VoRAE, TdH dhe HEKS/EPER.

Hulumtimi mbi martesat e hershme brenda komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, i hartuar dhe përpunuar nga Prof. Asoc. Dr. Bedri Bahtiri, në cilësi të udhëheqësit ekipës së hulumtimit, Sonila Hasaj dhe të tjerët nga UBO Consulting, si dhe Kaltrina Zhushi hulumtuese, trajton një çështje të ndjeshme jo vetëm brenda këtyre komuniteteve, por edhe në shoqërinë kosovare në përgjithësi.

# PËRMBAJTJA

|                                                                                                                      |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E HULUMTIMIT                                                                                  | 6  |
| Metoda e Hulumtimit                                                                                                  | 8  |
| Kufizimet dhe vështirësitë në realizimin e hulumtimit                                                                | 9  |
| HYRJE                                                                                                                | 10 |
| I. PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT TË MARTESAVE TË HERSHME                                                                   | 12 |
| 1. Martesat e hershme në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian                                                      | 12 |
| 2. Format e martesave të hershme                                                                                     | 13 |
| II. ÇËSHTJET E POLITIKAVE DHE SHKAQET E MARTESAVE TË HERSHME                                                         | 15 |
| 1. Politikat drejtuar komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian                                                         | 15 |
| 2. Ndikimi i të drejtave të njeriut në martesat e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian                | 16 |
| 3. Pasojat e martesave të hershme                                                                                    | 18 |
| a) Dhuna në familje                                                                                                  | 19 |
| b) Mohimi i të drejtës në arsim dhe ndikimi në punësim                                                               | 19 |
| c) Ndikimi shëndetësor, fizik dhe psikologjik i martesave të hershme                                                 | 20 |
| d) Pamundësia për të kërkuar drejtësi për dëmet që rrjedhin nga martesa e fëmijëve                                   | 20 |
| e) Martesa e fëmijëve dhe trafikimi me qenie njerëzore                                                               | 20 |
| III. LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR DHE VENDOR LIDHUR ME MARTESAT E HERSHME                                              | 21 |
| 1. Aktet juridike ndërkombëtare                                                                                      | 21 |
| 2. Aktet juridike të brendshme                                                                                       | 31 |
| IV. TRAJTIMI ME KUJDES I MARTESAVE TË HERSHME TË FËMIJËVE DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL PËR PARANDALIMIN E TYRE | 40 |
| V. ROLI I MEDIAVE PËR MARTESAT E HERSHME                                                                             | 42 |
| VI. RASTE STUDIMI NGA HULUMTIMET NË TEREN DHE TË DHËNA STATISTIKORE LIDHUR ME FENOMENIN E MARTESAVE TË HERSHME       | 44 |
| 1. Gjetjet kryesore nga hulumtimi sasior                                                                             | 47 |
| 1.1 Rezultatet e pyetësorit me të mitur (13-18 vjeç)                                                                 | 48 |
| 1.2 Njohuri dhe qëndrime për martesën e hershme                                                                      | 50 |
| 1.3 Përvojat personale rreth martesës së hershme                                                                     | 58 |
| 1.4 Ndikimi dhe perspektivat e komunitetit                                                                           | 59 |
| 1.5 Rezultatet e pyetësorit me të rritur (18-40 vjeç)                                                                | 66 |

|                                                                                                                                                                                        |            |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| 1.6 Seksioni rreth martesave të hershme                                                                                                                                                | 67         |
| 1.7 Arsimimi dhe shkollimi                                                                                                                                                             | 75         |
| 1.8 Ndikimi i martesës së hershme në mirëqenie dhe punësim                                                                                                                             | 77         |
| 1.9 Perceptimet dhe normat e komunitetit                                                                                                                                               | 80         |
| 1.10 Politikat dhe rekomandimet                                                                                                                                                        | 86         |
| 2. Gjetjet kryesore nga hulumtimi cilësor                                                                                                                                              | 90         |
| 2.1 Mostra e realizuar                                                                                                                                                                 | 90         |
| 2.2 Kufizimet e hulumtimit cilësor                                                                                                                                                     | 91         |
| 2.3 Fenomeni i martesave të hershme                                                                                                                                                    | 91         |
| 2.4 Zbatueshmëria e ligjeve në praktikë                                                                                                                                                | 94         |
| 2.5 Pasojat e martesave të hershme                                                                                                                                                     | 95         |
| 2.6 Dhuna dhe abuzimet seksuale                                                                                                                                                        | 96         |
| 2.7 Sfidat me të cilat përballen QPS-të në trajtimin e rasteve të martesave të hershme                                                                                                 | 97         |
| 3. Gjetjet kryesore nga të dhënat e siguruar nga Policia e Kosovës 2022-2024                                                                                                           | 97         |
| <b>TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET</b>                                                                                                                                                    | <b>98</b>  |
| 1. TË GJETURAT                                                                                                                                                                         | 98         |
| 1.1 Të përgjithshme:                                                                                                                                                                   | 98         |
| 1.2 Nga hulumtimi:                                                                                                                                                                     | 98         |
| 1.2.1 Nga pyetësi me të mitur (13-18 vjeç):                                                                                                                                            | 100        |
| 1.2.2 Nga pyetësi me të rritur (18-40 vjeç):                                                                                                                                           | 100        |
| 2. REKOMANDIME                                                                                                                                                                         | 102        |
| 2.1. Për institucionet e administratës shtetërore:                                                                                                                                     | 102        |
| 2.2. Për organet e hetuesisë dhe gjyqësisë:                                                                                                                                            | 102        |
| 2.3. Për shoqërinë civile dhe organizatat për mbrojtjen e të drejtave të vajzave dhe grave:                                                                                            | 103        |
| 2.4. Organizatat ndërkombëtare dhe donatorët:                                                                                                                                          | 104        |
| 2.5. Mediat dhe vetëdijësimi:                                                                                                                                                          | 104        |
| 2.6. Përpjekjet brenda komuniteteve:                                                                                                                                                   | 104        |
| 2.7. Qasja e lehtë në informacione, ndihma juridike dhe këshillimi falas, si dhe përditësimi i të dhënave statistikore lidhur me martesat e hershme                                    | 104        |
| 2.8. Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë së arsimit, ndërgjegjësimi ligjor, fuqizimi i mekanizmave, mbështetja ekonomike, ndryshimi i normave shoqërore dhe promovimi i barazisë gjinore | 105        |
| <b>REFERENCAT</b>                                                                                                                                                                      | <b>107</b> |

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E HULUMTIMIT

Ky hulumtim paraqet një hap të rëndësishëm për hulumtimin e fenomenit të martesave të hershme<sup>1</sup> në Republikën e Kosovës dhe përbën një përpjekje serioze për të sjellë në diskutim këtë temë të ndjeshme për fëmijët në përgjithësi, e në veçanti për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Përmes këtij hulumtimi synohet të bëhet një analizë e hollësishme e këtij fenomeni shqetësues dhe mënyrës së rregullimit të çështjes së martesës dhe bashkësisë faktike jashtëmartesore sipas normave juridike ndërkombëtare dhe legjisllacionit të brendshëm. Deri më tani, në Republikën e Kosovës janë themeluar mekanizma institucionalë në nivel qendror përsa i takon adresimit të kësaj çështje. Ky është pa dyshim një kontribut me vlerë të shtuar për kauzën e *“interesit më të mirë të fëmijës”*.

Kritika kryesore ndaj martesave të hershme është se ato përbëjnë abuzim ndaj fëmijëve dhe shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre. Ky fenomen pengon emancipimin e komuniteteve, pasi u kufizon të miturve (djemve dhe vajzave) qasjen në të drejtat themelore, si arsimimi dhe zhvillimi i shëndetshëm sipas moshës së tyre.

Problemi i martesave të hershme nuk është vetëm çështje e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, por prek edhe komunitetet tjera në Kosovë në një masë të caktuar. Në këtë aspekt, nuk duhet konsideruar se ky fenomen ka të bëjë vetëm me këto komunitete, pasi që i njëjti ka qenë prezent deri në shekullin e kaluar, në shkallë të ndryshme, edhe në komunitetet tjera në Kosovë, ndërsa sot haset në raste më të pakta.

Martesat e hershme u mohojnë fëmijëve të drejtën për të shprehur lirisht dëshirat dhe interesat e tyre, pasi ata nuk kanë kapacitet të plotë për të marrë vendime, e nëse shprehin një pëlqim, ai nuk ka vlerë juridike për shkak të moshës.

Nga aspekti ligjor, martesat e hershme nuk mund të konsiderohen marrëdhënie të rregulluara me norma juridike, pasi që ato janë të ndaluara. Megjithatë, ky fenomen nuk mund të kalojë në heshtje duke u justifikuar me vlera kulturore dhe tradicionale. Ato duhen trajtuar si shkelje të të drejtave të njeriut, të cilat krijojnë pabarazi sociale dhe përmbajnë elemente të diskriminimit të rëndë.

<sup>1</sup> Për qëllimet e këtij dokumenti, termi *“martesë”* do të përdoret për të përfshirë të gjitha format e bashkësisë mes partnerëve, pavarësisht nëse martesë është e regjistruar apo jo. Kjo përfshin rastet kur gjykata lejon martesën e të miturve (16-18 vjeç) si dhe bashkëjetesat tradicionale mes personave nën moshën madhore. Qëllimi është të shmangët konfuzioni te lexuesit që nuk kanë njohuri të mjaftueshme juridike mbi këtë çështje.

Parandalimi i martesave të hershme ngërthen në vete domosdoshmërinë e ndërmarrjes së masave dhe veprimeve konkrete që përfshijnë familjen, sistemin e edukimit, shërbimet sociale, hetuesinë, drejtësinë, organizatat e shoqërisë civile dhe shoqërinë në përgjithësi. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim kanë edhe mediat, të cilat duhet të trajtojnë këtë çështje në mënyrë profesionale dhe multidisiplinare, duke ndihmuar në ngritjen e vetëdijes dhe ndërtimin e qëndrimeve të fuqishme kundër fenomenit të martesave të hershme, kundër racizmit dhe antigjipsizmit.

Gjatë takimeve me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, është vërejtur se perceptimet e tyre mbi gruan, seksualitetin, martesën dhe riprodhimin shpesh reflektojnë një tendencë për të mbrojtur pastërtinë kulturore dhe për të ruajtur traditat.

Kjo situatë tregon nevojën për punë të vazhdueshme në ndryshimin e këtyre perceptimeve dhe edukimin për respektimin e të drejtave të fëmijëve, si dhe parandalimin e martesave të hershme. Përplasja e perceptimeve ndërmjet komuniteteve tregon një kontestim të vlerave familjare dhe martesore të njëra-tjetrës.

Duke njohur diversitetin e brendshëm të shoqërisë kosovare, është e nevojshme të intensifikohen përpjekjet për mobilizim dhe për solidaritet ndëretnik, me qëllim përmirësimin e mirëqenies dhe barazisë për të gjithë qytetarët.

Me qëllim që të kemi një pasqyrim të mirëfilltë të gjendjes, ky hulumtim është kryer në 19 komuna me popullatë të madhe nga komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si: Deçan, Gjakovë, Gjiilan, Istog, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë, Lipjan, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Shtime, Suharekë, Ferizaj dhe Graçanicë. Pyetësi i parë u realizua me 196 fëmijë të moshës 13 deri në 18 vjeç nga këto komunitete, ndërsa pyetësi i dytë përfshiu 178 burra dhe gra të moshës 18 deri në 40 vjeç, të cilët ishin martuar nën moshën 18 vjeç.

Në këtë kuadër, janë zhvilluar edhe intervista gjysmë të strukturuar, duke krijuar hapësirë për diskutime të hapura dhe përshtatje të pyetjeve sipas informatave të dhëna nga secili respondent. Një proces i ngjashëm është ndjekur edhe për fokus-grupet.

Të dhënat e mbledhura dhe raporti i hartuar nga ky studim do të shërbejnë si mjet i rëndësishëm për një gamë të gjerë palësh të interesit në adresimin e martesave të hershme në Kosovë. Ky raport hulumtues ofron edhe udhëzime praktike për Grupin Ndërinstitucional për Parandalimin dhe Raportimin e Martesave të Hershme, institucionet publike të nivelit lokal dhe qendror, si dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Po ashtu, ai do të jetë një burim i vlefshëm për donatorët ndërkombëtarë në orientimin e strategjive të tyre të financimit dhe mbështetjes, si dhe për hulumtuesit dhe ekspertët në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe përfshirjes sociale.

Nëpërmjet të dhënave dhe rekomandimeve të bazuara në hulumtim, raporti synon të mbështesë zbatimin e masave konkrete dhe të informuara për parandalimin dhe trajtimin e martesave të hershme në Kosovë.

Raporti nxjerr në pah faktin se vajzat dhe gratë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, shpesh gjenden në pozitë më të pafavorshme se djemtë, si në arsim ashtu edhe në fusha të tjera të jetës. Niveli i ulët arsimor dhe presioni i prindërve për martesë të hershme mbeten ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë fenomen.

Në përfundim, raporti ofron rekomandime konkrete për adresimin e fenomenit të martesave të hershme. Këto rekomandime përfshijnë fuqizimin e vajzave përmes arsimit, forcimin e mekanizmave ligjorë, rritjen e ndërgjegjësimit në komunitet dhe sigurimin e mbështetjes socio-ekonomike për familjet. Masat e propozuara synojnë krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe më të drejtë për të rinjtë në këto komunitete, duke i mundësuar atyre të marrin vendime të informuara dhe të pavarura për të ardhmen e tyre.

## Metoda e Hulumtimit

Ky hulumtim është hartuar pas një analize të thelluar të të dhënave primare dhe sekondare.

Ky hulumtim përbën ftesë për reflektim për të gjitha institucionet dhe shoqërinë kosovare në tërësi, me synimin për të ndërgjegjësuar opinionin publik dhe për të ndërtuar qasje që mundësojnë zhvillimin e ardhshëm të personave dhe grupeve të prekura nga kjo praktikë.

Që në fillim, ky studim nënvizon rëndësinë e një analize të gjithanshme dhe të argumentuar të martesave të hershme, duke përdorur metoda analitike dhe të dhëna reale. Në këtë mënyrë, synohet të shmangët përgjithësimi dhe të identifikohen rastet e veçanta brenda kontekstit kulturor dhe social.

Autorët e këtij hulumtimi janë të vetëdijshëm për ndjeshmërinë e kësaj çështjeje dhe rrezikun e paragjytimeve apo stigmatizimit të komuniteteve të përfshira, veçanërisht të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Një qasje e gabuar mund të çojë në pasoja të pariparueshme për këto grupe, ndaj dhe ky hulumtim është zhvilluar me kujdes të veçantë për të shmangur stereotipizimin dhe për të ofruar një analizë të drejtë.

Ky studim mbështetet në hipotezën se: ***“martesat e hershme cenojnë të drejtat individuale të fëmijëve dhe të rinjve brenda komuniteteve tradicionale, duke favorizuar të drejtat kolektive të komunitetit përkatës mbi ato individuale”***.

*Pyetjet thelbësore që lindin nga kjo hipotezë dhe që kërkojnë përgjigje dhe reflektim janë:*

1. A ka përparësi vazhdimësi e një praktike kulturore të diskutueshme mbi të drejtat universale të njeriut, në këtë rast të drejtat e fëmijës?
2. Çfarë vendimesh duhet të merren për të adresuar këtë fenomen, duke qenë të vetëdijshëm për shkeljet e të drejtave themelore të njeriut, me theks të veçantë tek fëmijët?
3. Çfarë roli luan shteti në parandalimin e kësaj praktike në komunitete të caktuara?

Shikuar edhe nga një perspektivë krahasuese, kjo çështje nuk mund të shterojë me një hulumtim të vetëm të kufizuar vetëm në një pjesë të komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Nevojiten studime të vazhdueshme dhe analiza të detajuara mbi martesat e hershme, duke e trajtuar këtë temë si një debat të hapur për shoqërinë kosovare, për të shikuar lëvizjen e tendencave të këtij fenomeni në vazhdimësi, si dhe ndërmarrjen e masave dhe veprimeve adekuata e të vazhdueshme.

Çështjet dhe reflektimet e ngritura në këtë hulumtim kanë rëndësi për gjithë shoqërinë, duke pasur parasysh përplasjen mes aspekteve ligjore dhe praktikave kulturore të martesave të hershme.<sup>2</sup>

Megjithatë, martesat e hershme nuk janë ekskluzivisht dukuri e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, edhe pse janë më të përhapura në këto grupe. Ky fenomen ndikohet gjithashtu nga faktorë të tjerë, si roli

<sup>2</sup> [https://kosovo.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/KOSOVO-Albanian-final\\_0.pdf](https://kosovo.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/KOSOVO-Albanian-final_0.pdf), fq. 6 dhe 10, qasur me datën 02.04.2025.



i martesës në ruajtjen e pasurisë familjare dhe si mekanizëm për të shmangur varfërinë, veçanërisht në mjedise ku alternativat për një të ardhme më të mirë janë të kufizuara.

Ky hulumtim përqipet të analizojë martesat e hershme në mënyrë të gjithanshme, duke eksploruar ndërthurjen mes diskriminimit gjinor dhe racor. Ai thekson se racizmi ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, marginalizimi dhe marrëdhëniet gjinore brenda këtyre komuniteteve kanë ndikim të madh mbi gratë dhe vajzat. Mungesa e reagimit të duhur nga shteti bën që ky fenomen të mbetet një çështje serioze dhe shqetësuese për gjithë shoqërinë kosovare.

### **Cilat janë risitë që sjell ky hulumtim përmbajtësor dhe shkencor?**

Risia kryesore e këtij hulumtimi është analiza dhe qartësimi i dallimeve ndërmjet formave të martesës me fëmijë dhe të mitur, si: martesa e rregulluar (mbi moshën 16 vjeçare me leje të gjykatës), martesa e detyruar dhe martesa e hershme.

Përshkrimi i secilit lloj martese, i mbështetur nga raste studimore dhe intervista, ndihmon në identifikimin e mekanizmave të përfshirë në këto praktika kulturore. Kështu, ky hulumtim synon të shërbejë si një pikënisje e vlefshme për studime të mëtejshme mbi martesat e hershme.

Të gjeturat dhe rekomandimet e studimit theksojnë nevojën për veprime të përbashkëta nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe nga autoritetet, për të mbështetur fëmijët e këtyre grupeve në realizimin e të drejtave të tyre ligjore. Këto të drejta janë të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe instrumente të tjera juridike kombëtare e ndërkombëtare, si dhe legjislacioni i brendshëm.

Gjithashtu, hulumtimi nënvizon rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit të prindërve mbi të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve të tyre. Çdo fëmijë duhet të ketë mundësinë për zhvillim të shëndetshëm dhe status të pavarur social, duke marrë vendime për martesë vetëm pasi të ketë arritur moshën madhore dhe aftësinë për të gjykuar vetë për të ardhmen e tij.

### **Kufizimet dhe vështirësitë në realizimin e hulumtimit**

Një nga sfidat kryesore gjatë realizimit të këtij hulumtimi ka qenë vështirësia në sigurimin e të dhënave për tri vitet e fundit mbi rastet e martesave të hershme, nga policia e Kosovës dhe nga të gjitha komunat e kontaktuara. Kjo ka ardhur si pasojë e mungesës së të dhënave të agreguara sipas gjinisë, moshës, etnisë dhe vendbanimit, kapaciteteve të kufizuara për raportim të detajuar, por edhe/ose hezitimit të institucioneve për të ndarë informacionet e kërkuara.

Pavarësisht këtyre sfidave, të dhënat e mbledhura ofrojnë një pasqyrë të rëndësishme mbi fenomenin e martesave të hershme dhe sfidat institucionale në trajtimin e këtij fenomeni.

# HYRJE

Përveç tjerash, ky hulumtim synon të nxisë edhe diskutime mbi fenomenin shqetësues të martesave të hershme në përgjithësi, ndërsa në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në veçanti.

Për më tepër, qëllimi i këtij hulumtimi është mbledhja e informacionit mbi këtë çështje, përfshirë përkufizimet, aspektet ligjore dhe përgjegjësinë e palëve në shoqëri, si dhe që të trajtojë konfliktin e vlerave midis shtetit të së drejtës, autonomisë kulturore dhe të drejtave të grave dhe fëmijëve, të cilët janë më të prekurit nga ky fenomen.

Fillimisht, do të shqyrtojmë pozicionet e ndryshme të palëve institucionale dhe të shoqërisë civile, duke analizuar mungesën e veprimit kolektiv për të nxitur shtetin të respektojë ligjet përmes mekanizmave përkatës shtetërorë dhe të shoqërisë civile.

Një aspekt kyç është dualiteti i aktiviteteve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në këto komunitete, duke përfshirë organizatat që promovojnë barazinë gjinore dhe mbrojtjen e fëmijëve, si dhe institucionet shtetërore që mbikëqyrin zbatimin e këtyre të drejtave. Është thelbësore që të mos tolerohen standarde të dyfishta në mbrojtjen e fëmijëve të komuniteteve tjera në raport me fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, pasi që kjo mund të çojë në stigmatizim të fëmijëve të këtyre komuniteteve dhe diskriminim.

Shkelja e të drejtave të fëmijëve nuk mund të arsyetohet asnjëherë në emër të autonomisë kulturore të komuniteteve përkatëse, pasi që kjo krijon një konflikt në mes të vlerave kulturore dhe të drejtave individuale, duke përbërë një shkelje të rëndë të të drejtave themelore të njeriut. Në këtë aspekt asnjë kulturë apo traditë, e cila cenon të drejtat e fëmijëve nuk guxon të tolerohet në asnjë shoqëri demokratike ku sundon rendi dhe ligji, siç është edhe Kosova.

Në Kosovë janë zhvilluar hulumtime të caktuara të fenomenit të martesave të hershme, por që mungojnë të dhëna të sakta dhe të plota mbi përhapjen dhe pasojat e tij. Kjo për faktin se për institucionet mbetet sfida eidentimi i rasteve të bashkësive faktike jashtëmartesore që fillojnë që në moshë të hershme, për të cilat nuk ka të dhëna të sakta, e sidomos për fëmijët vajza.

Për të kuptuar më mirë këtë fenomen, nevojiten hulumtime gjithpërfshirëse që shtrihen edhe përtej komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, pasi që edhe pjesa tjetër e shoqërisë kosovare, ndonëse në shkallë më të vogël, mund të jenë të prekura, sidomos në viset rurale.

Juridikisht, termi “*martesë*” përdoret për të përshkruar martesën ligjore, të regjistruar me pajtimin e të

dyja palëve, duke e dalluar nga format e bashkësive faktike jashtëmartesore, të cilat shpesh nuk kanë bazë ligjore dhe mund të jenë të detyruara. Megjithatë, në këtë hulumtim, termi “*martesë*” përdoret edhe për bashkësitë faktike jashtëmartesore të fëmijëve që jetojnë apo kanë jetuar në bashkësi të këtilla faktike.

Në të kaluarën, diskutimet mbi këtë çështje zhvilloheshin kryesisht në mënyrë joformale, por pas luftës së vitit 1999 në Kosovë dhe me ardhjen e administratës ndërkombëtare, ndërgjegjësimi për mbrojtjen e fëmijëve dhe familjes si përgjegjësi shtetërore u rrit dukshëm.

Gjatë viteve ka pasur përpjekje për të minimizuar këtë problem nëpërmjet barazisë gjinore dhe qasjes së barabartë në arsim për vajzat dhe djemtë e komuniteteve që praktikojnë martesat e hershme. Po ashtu, janë zhvilluar programe për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Martesat e hershme ndërlidhen me faktorë të ndryshëm, përfshirë statusin ekonomik, qëndrimet patriarkale dhe stereotipet mbi këto komunitete. Vajzat e këtyre grupeve kanë nivele më të ulëta arsimimi dhe shpesh braktisin shkollën për shkak të presionit familjar për t’u martuar herët. Kjo tregon se edhe përkundër progresit të arritur, nevojitet një fokus i veçantë në avancimin e arsimimit të vajzave dhe grave të këtyre komuniteteve,<sup>3</sup> e po ashtu kërkohet ndërgjegjësimi edhe i prindërve mbi rëndësinë e shtyrjes së moshës së martesës dhe arritjen e një niveli më të lartë arsimor.

■ Përvoja e vajzave dhe grave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ndryshon në varësi të faktorëve si origjina gjeografike, mosha, niveli arsimor dhe statusi ekonomik. Ky hulumtim do të shqyrtojë këta faktorë dhe jo vetëm, për të kuptuar më mirë ndikimin e tyre në martesat e hershme.

Studime të ndryshme në vende të tjera kanë treguar se niveli i ulët arsimor i familjeve është një nga faktorët kryesorë që çon në martesat dhe lindjet e hershme në këto komunitete. Familjet shpesh këmbëngulin për martesën e hershme të vajzave, duke ndjekur një model tradicional, ku roli i gruas mbetet i kufizuar brenda familjes. Ndikimi i komunitetit është shpesh më i fortë se vullneti individual, gjë që ndikon që vajzat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të martohen disa vjet më herët se popullsia shumicë në Kosovë, si dhe linden fëmijën e tyre të parë më herët. Mosha e martesës varion midis komuniteteve, me dallime mes grupeve tradicionale dhe moderne.

Në çdo rast, është e rëndësishme të kuptohet se ligji duhet të ketë përparësi mbi të gjitha dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve duhet të jetë i pakompromis nga ana e organeve kompetente shtetërore para së gjithash. Eliminimi i martesave të hershme kërkon qasje të koordinuar midis institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe komuniteteve.

Nga ky hulumtim rrjedh se martesa e hershme nuk është më temë tabu, por problemi kryesor mbetet mungesa e informacionit të saktë dhe diskutimit të hapur për të adresuar këtë fenomen në nivel shtetëror dhe shoqëror.

<sup>3</sup> <https://www.rcc.int/romaintegration2020/files/admin/docs/ded1dbecbd2a639e8b47f82bab0500e1.pdf>, faqe 5, qasur me datën 02.04.2025.

# I. PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT TË MARTESAVE TË HERSHME

## 1. Martesat e hershme në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

Romët, ashkalitë dhe egjiptianët janë grupe jashtëzakonisht heterogjene, si në Republikën e Kosovës, ashtu edhe në shtetet e tjera evropiane dhe më gjerë. Historikisht, ata janë përballur me persekutim dhe diskriminim nga shoqëria shumicë për qindra vjet. Edhe pse shifrat e sakta nuk janë të disponueshme, vlerësohet se sot në Evropë jetojnë mbi dhjetë milionë romë, të cilët vazhdojnë të përballen me diskriminim dhe varfëri të thellë.

Vajzat dhe gratë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë veçanërisht të prekura nga diskriminimi i dyfishtë, si për shkak të gjinisë, ashtu edhe për shkak të përkatësisë së tyre në një pakicë të diskriminuar. Ato janë gjithashtu më të rrezikuara nga martesat e hershme, të cilat zakonisht ndodhin në moshë fëmijërore. Pritshmëritë kulturore dhe traditat i detyrojnë vajzat të martohen herët, shpesh me adoleshentë mbi 16 vjeç ose edhe me burra të rritur.

Një nga problemet më serioze që e vënë vajzën dhe gruan në këto komunitete në pozitë të pafavorshme është edhe abuzimi me pushtetin prindëror, ku ushtrohet presion për lidhjen e martesave të hershme. Prindërit shpesh e vendosin martesën për fëmijët e tyre, gjë që përbën shkelje serioze të të drejtës prindërore dhe të ligjeve me të cilat rregullohen marrëdhëniet familjare. Kjo praktikë është veçanërisht e përhapur më shpesh në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, e ndërsa këto komunitete ballafaqohen me këtë problematikë edhe në vendet e rajonit dhe Evropës.

Një nga arsyt kryesore pse shumica e vajzave të këtyre komuniteteve martohen nën moshën 18 vjeçare është presioni shoqëror dhe familjar.

Një sfidë plotësuese për vajzat që martohen herët është edhe testi i virgjërisë, praktikë kjo poshtëruese dhe degraduese, e cila për shumicën e rasteve përbën presion të madh psikologjik dhe fizik. Kjo praktikë ka pasoja afatgjata për shëndetin dhe mirëqenien e vajzave të reja, duke i ekspozuar ato ndaj dhunës dhe stigmatizimit të vazhdueshëm.

Martesat e hershme në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian zakonisht lidhen në mënyrë jozyrtare, nuk regjistrohen dhe nuk pasqyrohen në statistikat zyrtare, pasi që ligjërisht nuk lejohet të lidhen.

Një nga faktorët kryesorë që nxit martesat e hershme është besimi se virgjëria është thelbësore për vlerësimin e një vajze në komunitet. Dështimi në të provuarit e virgjërisë mund të bëjë që vajza të humbë statusin e saj, si dhe ta bëjë më të vështirë gjetjen e bashkëshortit. Kjo shpesh çon në stigmatizim, izolim dhe në raste ekstreme, vajzat mund të bëhen edhe viktimat të trafikimit me qenie njerëzore, një nga format më të shëmtuara të shkeljes së të drejtave të njeriut.

## 2. Format e martesave të hershme

Kur flasim për martesat e hershme, kemi parasysh disa forma të tyre, të cilat dallohen kryesisht nga liria e zgjedhjes dhe kufizimet që i shoqërojnë ato. Një aspekt i rëndësishëm është përcaktimi ligjor i moshës së pjekurisë, e cila ndikon në aftësinë për të marrë vendime të tilla.

Duke u bazuar në këtë, identifikohen disa forma të martesës: martesa e detyruar, martesa e hershme dhe martesa e rregulluar. Dallimi mes këtyre llojeve nuk është gjithmonë i qartë, por ekzistojnë elemente specifike që i veçojnë.

Shteti ka interes t'i mbrojë martesat, sidomos të atyre personave që nuk janë në gjendje të kujdesen për të drejtat dhe interesat e tyre. Si pasojë e kësaj, shteti me ligj ka caktuar moshën minimale për lidhjen e martesës, e cila mund të dallojë prej shtetit në shtet; p.sh. në disa juridiksione, gruaja dhe burri, që nga moshja 18 vjeçare, mund të martohen pa pëlqimin e prindërve të tyre. Megjithatë, me lejen e prindërve të personit më të ri se 18 vjet, ose atë të kujdestarit, e me vendim të gjykatës, personi 16 ose 17 vjeçar gjithashtu mund të martohet,<sup>4</sup> natyrisht nëse i plotëson edhe kushtet tjera ligjore.

**Martesa e detyruar** ndodh kur të paktën njëri nga bashkëshortët nuk jep pëlqimin e tij/saj të lirë dhe të plotë, ose kur ai pëlqim nuk është i vlefshëm në aspektin juridik. Kjo lloj martese mund të rezultojë nga presioni familjar, kërcënimi apo forma të tjera të detyrimit psikologjik. Statistikat për këtë fenomen mungojnë për shkak të hezitimit për ta denoncuar atë.

Martesat e detyruara aktualisht praktikohen kryesisht brenda komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, por në të kaluarën ky fenomen ka qenë i pranishëm edhe në mesin e shumicës së popullsisë në Kosovë. Gratë janë më shpesh viktimat të kësaj praktike, megjithëse raste të tilla janë hasur edhe te burrat.

**Martesa e hershme** ka ekzistuar në shumë kultura përgjatë historisë, por me industrializimin dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve dhe grave, ky fenomen ka rënë ndjeshëm. Megjithatë, ai mbetet i pranishëm në disa komunitete, e posaçërisht te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

**Martesa e rregulluar (e aranzhuar)** nënkupton martesat midis moshave 16 dhe 18 vjeç. Karaste kur martesat e tilla lidhen me ndërhyrjen e prindërve ose ndërmjetësve për të ndihmuar në gjetjen e bashkëshortit. Edhe pse kjo praktikë është në rënie, ende haset në raste të caktuara. Me rritjen e emancipimit shoqëror, gjithnjë e më shumë të rinj zgjedhin vetë partnerin e tyre jetësor.

Marrja me forcë e nuses, apo rrëmbimi, ka qenë një nga format më të zakonshme të martesës së detyruar.

<sup>4</sup> Robert E. Oliphant - Nancy Ver Steegh, "Family Law", Aspen Publishers, 2007, fq. 11

Përveç faktorëve kulturorë, martesat e hershme ndikohen edhe nga faktorë si statusi social, izolimi, vendbanimi (urban ose rural), niveli arsimor i prindërve dhe modelet familjare.

Është e rëndësishme të theksohet se traditat dhe kultura nuk janë gjithmonë arsytet e vetme të martesave të hershme. Në disa raste, faktorët socio-ekonomikë dhe konkurrenca mes familjeve për *"famën"* dhe reputacionin mund të jenë shtytës kryesorë. Brenda komuniteteve ku martesa e hershme praktikohet, virgjëria e vajzave dhe imazhi i familjes kanë rol qendror tek arsytet për lidhjen e martesave të hershme.

Në organizimin e këtyre martesave, shpesh bëhen shpenzime të mëdha, pavarësisht gjendjes ekonomike të familjeve, për të ruajtur imazhin dhe prestigjin e tyre në komunitet, të cilat falë rrjeteve sociale edhe bien në *"veshët dhe syrin"* e organeve shtetërore, të cilat duhet të ndërmarrin veprime për parandalimin e tyre. Të gjitha format e martesave nën moshën madhore përbëjnë shkelje të të drejtave të fëmijëve, e rrjedhimisht edhe të dispozitave ligjore. Meqenëse mosha ligjore për martesë është 18 vjeç, martesat e hershme janë të paligjshme, edhe nëse ka pëlqim nga të dyja palët, përveç rasteve kur ekziston vendim gjyqësor që lejon martesën për personat midis 16 dhe 18 vjeç.

## II. ÇËSHTJET E POLITIKAVE DHE SHKAQET E MARTESAVE TË HERSHME

### 1. Politikat drejtuar komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian

Lidhur me masat e ndërmarra nga shteti për situatën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, Republika e Kosovës vitet e fundit ka ndërmarrë nisma qeveritare që trajtojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse problemet e këtyre komuniteteve, gjë që edhe shpërfaqet në **Strategjinë për avancimin e të Drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2022-2026**.<sup>5</sup> Kjo strategji është shembull i mirë i përfshirjes aktive të komuniteteve në hartimin e politikave publike. Procesi i hartimit të saj është zhvilluar përmes një qasjeje konsultative dhe pjesëmarrëse, ku janë përfshirë të gjitha organizatat relevante të shoqërisë civile që përfaqësojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. Zëri i këtyre komuniteteve është reflektuar në objektivat dhe masat konkrete të Strategjisë, duke dëshmuar përkushtimin e institucioneve për përfshirje dhe transparencë.

Edhe pse çështja e martesave të hershme nuk trajtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të thelluar si masë specifike brenda Strategjisë, ajo përmendet në disa pjesë që lidhen me mbrojtjen sociale dhe edukimin. Megjithatë, mbetet nevoja për thellim të mëtejshëm të masave që adresojnë fenomene si martesat dhe shtatzënitë e hershme, shkëputja nga arsimi, si dhe fuqizimi i vajzave dhe grave të reja brenda këtyre komuniteteve.

Përveç Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës 2022–2026, ekzistojnë disa dokumente dhe mekanizma shtesë që janë të rëndësishëm për adresimin e çështjes së martesave të hershme.

**Programi për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut 2021–2023**<sup>6</sup>, që si program i Qeverisë së Kosovës synon të forcojë sistemin institucional për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë masat për mbrojtjen nga diskriminimi dhe përfshirjen e grupeve të marginalizuara, si komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

<sup>5</sup> <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/05/Strategjia-per-avansimin-e-te-drejtave-te-komuniteteve-rom-dhe-ashkali-ne-Republiken-e-Kosoves-2022-2026-dhe-Plani-i-veprimet-2022-2024.pdf>

<sup>6</sup> [https://www.google.com/search?q=%E2%80%A209Programi+p%C3%ABr+Mbrojtjen+e+t%C3%AB+Drejtave+t%C3%AB+Nje+riut+2021%E2%80%932023&client=safari&sca\\_esv=d2e7cdd0b004c888&channel=mac\\_bm&sxsrf=AHTn8zq0WPcMiYYG2A8UpnwPYtnVX4PQBg%3A1747295728742&source=hp&ei=8J0laL7bKrGI7NYP2sXxmQ0&iflsig=ACkRmUkAAAAAaCWsAPaWYV9tqUGTOiYKa66WR-vF2bPs](https://www.google.com/search?q=%E2%80%A209Programi+p%C3%ABr+Mbrojtjen+e+t%C3%AB+Drejtave+t%C3%AB+Nje+riut+2021%E2%80%932023&client=safari&sca_esv=d2e7cdd0b004c888&channel=mac_bm&sxsrf=AHTn8zq0WPcMiYYG2A8UpnwPYtnVX4PQBg%3A1747295728742&source=hp&ei=8J0laL7bKrGI7NYP2sXxmQ0&iflsig=ACkRmUkAAAAAaCWsAPaWYV9tqUGTOiYKa66WR-vF2bPs)

**Strategjia e Arsimit 2022–2026**<sup>7</sup> është dokument i miratuar nga Ministria e Arsimit. Kjo strategji përfshin masa për përmirësimin e qasjes në arsim për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, duke kontribuar në parandalimin e braktisjes së hershme të shkollës, si dhe rrjedhimisht, të martesave të hershme.

**Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**<sup>8</sup>, e themeluar nga Zyra për Qeverisje të Mirë në vitin 2022. Kjo platformë ofron një mekanizëm për raportimin e rasteve të diskriminimit dhe ka trajtuar raste që lidhen me martesat e hershme dhe shkeljet e të drejtave të fëmijëve në këto komunitete.

**Grupi Teknik për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**<sup>9</sup> është themeluar nga Zyra e Kryeministrit. Ky grup luan një rol kyç në koordinimin e përpjekjeve për të adresuar diskriminimin dhe për të promovuar të drejtat e këtyre komuniteteve.

**Mekanizmat për promovimin e punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian**<sup>10</sup> janë masa dhe veprime konkrete të cilat Qeveria e Kosovës i ka ndërmarrë, si masa për të inkurajuar punësimin e anëtarëve të këtyre komuniteteve, duke përfshirë vendime për kuota punësimi dhe programe trajnimi, të cilat kontribuojnë në fuqizimin ekonomik dhe social të tyre, duke ndikuar pozitivisht në parandalimin e martesave të hershme.

Përfshirja e këtyre dokumenteve dhe mekanizmave në analizën e politikave për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian do të ofrojë një pasqyrë më të plotë dhe të saktë të përpjekjeve institucionale për të adresuar çështjen e martesave të hershme dhe për të promovuar të drejtat e këtyre komuniteteve.

Me qëllim të parandalimit dhe raportimit të martesave të hershme në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendim<sup>11</sup> ka themeluar grupin punues ndër-institucional që ka për obligim të hartojë një plan dhe një agjendë të aktiviteteve në vazhdimësi lidhur me adresimin e kësaj problematike. Ky grup punues është funksional dhe ka ndërmarrë veprime domethënëse në koordinimin e institucioneve dhe mekanizmave të ndryshëm për parandalimin dhe raportimin e martesave të hershme.

## **2. Ndikimi i të drejtave të njeriut në martesat e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian**

Martesat që përfshijnë të paktën një person nën 18 vjeç janë të ndaluara nga legjislacioni në shumicën e vendeve evropiane, përfshirë Kosovën, ndërsa me vendim gjykatë, në raste përjashtuese, mund të lejohet lidhja e martesës mes moshave 16-18 vjeçare. Shpesh, për të shmangur përgjegjësinë penale, fëmijët e lindur nga këto martesë mbeten të paregjistruar, sidomos kur lindjet ndodhin në shtëpi dhe pa përfshirjen e institucioneve shëndetësore. Kjo i bën ata edhe më të cenueshëm ndaj trafikimit me qenie njerëzore, pasi trafikuesit shënjestrojnë posaçërisht këtë kategori, për shkak të vështirësisë në gjurmim dhe identifikim nga ana e organeve të hetuesisë dhe drejtësisë.

Për më tepër, martesat e hershme nuk regjistrohen, pasi janë të ndaluara me ligj, ku si pasojë, fëmijët e lindur nga këto martesë shpesh nuk regjistrohen ose regjistrohen me vonesë. Kjo i ekspozon ata ndaj rreziqeve të shumta, duke përfshirë trafikimin dhe abuzimin.

<sup>7</sup> <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/10/03-Strategjia-e-Arsimit-2022-2026-Alb-Web.pdf>

<sup>8</sup> <https://raportodiskriminimin.org/news/121>

<sup>9</sup> <https://zqm.rks-gov.net/dokumentet/54/grupi-punues-antidiskriminim-per-rom-ashkali-dhe-egjiptian>

<sup>10</sup> <https://www.raportodiskriminimin.org/news/137>

<sup>11</sup> Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 41/178, i datës 13.12.2023.



Edhe pse çdo shtet ka detyrimin të mbrojtë qytetarët e tij dhe të respektojë standardet ndërkombëtare, gratë dhe vajzat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian shpesh mbeten viktimat e shkeljeve të të drejtave të tyre. Këto standarde nuk zbatohen në masën e duhur dhe problematikat e tyre nuk trajtohen me seriozitetin e nevojshëm.

Sigurimi i të dhënave mbi martesat e hershme mbetet sfidë në mbarë botën, përfshirë Kosovën. Ekziston mungesë e theksuar e statistikave të sakta, pavarësisht se ky fenomen është i pranishëm. Kjo mungesë informacioni ndikon edhe në vetëdijen publike për pasojat e martesave të hershme, sidomos për gratë dhe vajzat e komuniteteve të përmendura.

Hulumtimet në këtë fushë, të mbështetura nga diskutime me palë e profesionistë të të drejtave të njeriut, tregojnë një mungesë të theksuar vullneti për të trajtuar këtë çështje. Kjo ndodh për shkak të vështirësisë në qasje në të dhëna të besueshme, gjë që pengon pastaj edhe të kuptuarit e problemit dhe mobilizimin e institucioneve. Për t'u përballur me këtë fenomen, nevojitet angazhim më i gjerë nga të gjitha palët, shoqëria civile, ofruesit e shërbimeve, zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe autoritetet qeveritare, për të forcuar mekanizmat mbrojtës dhe për të ndërmarrë hapa efektivë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga martesat e hershme dhe pasojat e tyre.

Martesa e hershme të fëmijëve në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian krijojnë kushte për abuzim të vazhdueshëm dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Këto martesa shpesh çojnë në braktisjen e arsimit dhe pamundësinë për të siguruar punësim, për shkak të nivelit të lartë të analfabetizimit dhe mungesës së shkollimit. Gjithashtu, martesa e hershme ka efekte negative shëndetësore, si shtatzëni të parakohshme, të cilat përcillen me probleme fizike, psikologjike, ekonomike etj. Vajzat e këtyre komuniteteve shpesh ekspozohen ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit seksual, varësisht nga dhëndri dhe familja e tij, duke u përballur gjithashtu me dhunë në familje. Një problem i madh mbetet fakti se një fëmijë që bëhet nënë ka vështirësi të kujdeset për fëmijën e saj.

Beteja kundër martesave të hershme është detyrë e secilit, pasi kjo praktikë ndodh kryesisht në mesin e familjeve rom, ashkali dhe egjiptian dhe në shumicën e rasteve, mbetet joformale, duke anashkaluar institucionet shtetërore. Numri i saktë i këtyre martesave mbetet i panjohur dhe është më i lartë sesa raportohet.

Organet shëndetësore luajnë rol kyç dhe duhet të evidentojnë rastet e shtatzënisë dhe lindjes për vajzat që janë viktimat e martesave të hershme, duke siguruar kujdesin e duhur shëndetësor, veçanërisht atë riprodhues. Po ashtu, personeli shëndetësor duhet të jetë i vetëdijshëm për detyrimin e raportimit të rasteve të tilla tek institucionet përkatëse për mbrojtje sociale dhe për mbrojtje nga organet e hetuesisë dhe drejtësisë.

Një problem serioz mbetet edhe mungesa e përkushtimit të institucioneve për trajtimin e kësaj dukurie për shkak të stigmatizimit etnik. Ky perceptim duhet të ndryshojë urgjentisht, duke përfshirë tek shërbimet sociale, arsimore, shëndetësore, organet e hetuesisë dhe drejtësisë dhe shoqërinë në përgjithësi.

Martesa e hershme nuk mund të justifikohet me të qenit pjesë e traditës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, pasi që ato përfaqësojnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut si dhe formë diskriminimi që ndikon në jetën e vajzave dhe djemve të këtyre komuniteteve,

Një problem i rëndë që prek shoqërinë kosovare, duke përfshirë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, është edhe privimi i grave dhe vajzave nga e drejta trashëgimore. Kjo dukuri vjen si pasojë e zakoneve dhe traditave patriarkale, pavarësisht se legjislacioni parasheh pjesëmarrje të barabartë të trashëgimtarëve ligjorë, pa dallim gjinie. Megjithatë, shumë gra dhe vajza heqin dorë nga kjo e drejtë, duke përforcuar kështu ciklin e diskriminimit brez pas brezi. Lidhur me të drejtën e trashëgimisë së grave dhe vajzave, hasen probleme edhe në pjesën tjetër të popullatës shumicë në Kosovë.

Autonomia e grave në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, është e kufizuar në shumë aspekte, përfshirë arsimin, punësimin, marrëdhëniet familjare dhe planifikimin familjar. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë të dominuar nga mentaliteti patriarkal, gjë që reflektohet në statusin e ulët të përfshirjes së grave të këtyre komuniteteve në jetën shoqërore në përgjithësi. Familjet janë shpesh të mëdha, me disa breza që ndajnë të njëjtin ambient, ndërsa gratë e reja të martuara shpesh përballen me dhunë jo vetëm nga burrat, por edhe nga vjehrrit apo vjehrra, si dhe anëtarët tjerë të familjes.

Gratë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian përballen me diskriminim të dyfishtë ose të shumëfishtë, që shpesh nuk njihet, apo nuk trajtohet nga institucionet shtetërore. Për pasojë, nuk funksionojnë sa duhet mekanizmat efektivë për mbrojtjen e tyre nga diskriminimi, veçanërisht në tregun e punës.

Martësat e hershme burojnë nga politikat shtetërore joefektive, të cilat bëjnë që këto gra e familje të komuniteteve të mbahen në varfëri dhe izolim. Lagjet e këtyre komuniteteve janë shpesh të getoizuara, duke u bërë qendra të pabarazisë sociale dhe ekonomike, gjë të cilën e hasim nëpër të gjitha komunat ku ka pjesëtarë të këtyre komuniteteve, e që pastaj çon edhe tek emërtimi i lagjeve të këtyre komuniteteve me emra denigrues në zhargonin e përditshëm.

Masat konkrete për trajtimin e martesave të hershme nuk janë zbatuar kurrë plotësisht, dhe kjo dukuri vazhdon të jetë shqetësuese.

Standardet e të drejtave të njeriut duhet të respektohen gjithnjë, e sidomos kur janë në pyetje fëmijët, pasi që njëra ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve pa dyshim se është martesa e hershme e fëmijëve.

### 3. Pasojat e martesave të hershme

*Martësat e hershme si fenomen shqetësues sjellin me vete pasoja serioze, ndër të cilat mund të jenë:*

- a)** Dhuna në familje;
- b)** Mohimi i të drejtës për arsim;
- c)** Ndikimi negativ në shëndet;
- d)** Pamundësia për të kërkuar ose marrë drejtësi për dëmet që rrjedhin nga këto martesa;
- e)** Ndërlidhja e martesave të hershme me trafikimin e qenieve njerëzore.

*Në vijim trajtohet secila prej këtyre pasojave:*

#### **a) Dhuna në familje**

*Martestat e hershme i ekspozojnë vajzat ndaj dhunës në familje për shkak të pozitës së tyre të pafuqishme, mungesës së arsimimit dhe kufizimeve në punësim. Në Kosovë, veçanërisht në familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, rastet e dhunës raportohen rrallë për shkak të një sërë faktorësh:*

- dhuna ndaj grave pranohet si normale në disa familje të këtyre komuniteteve;
- ekziston frika nga izolimi dhe ndjenja e turpër nga komuniteti dhe familjet e tyre, nëse ndodh raportimi;
- mosndëshkimi i autorëve të dhunës, fakt ky që i dekurajon gratë të raportojnë rastet dhe të kërkojnë ndihmë ligjore;
- frika nga viktimizimi i mëtejshëm nga komuniteti, autoritetet dhe shoqëria.

Për më tepër, mungesa e strehimit alternativ, pamjaftueshmëria ekonomike dhe pamundësia për punësim e bëjnë pothuajse të pamundur që viktimat e dhunës në familje të largohen nga situata e tyre.

#### **b) Mohimi i të drejtës në arsim dhe ndikimi në punësim**

Martestat e hershme shpesh e pengojnë vijimin e shkollës, duke privuar vajzat nga e drejta për arsim dhe duke zvogëluar mundësitë e tyre për punësim. Shumë vajza të martuara herët nuk ndjekin asnjë formë arsimi formal të mirëfilltë, e kjo i penalizon ato gjatë gjithë jetës së tyre.

Një arsye tjetër për braktisjen e shkollës është presioni që vajzat të ruajnë, siç thuhet, nderin e tyre deri në martesë, gjë që i detyron ato të largohen nga mjediset shkollore për t'u përgatitur për martesë dhe krijimin e familjes, si dhe për kryerjen e detyrave shtëpiake familjare. Përveç kësaj, fëmijët e këtyre komuniteteve shpesh ndahen në klasa ose shkolla të veçanta, gjë që i ballafaqon ata me diskriminim e ngacmime si nga mësuesit ashtu edhe nga bashkëmoshatarët e tyre.

Zgjerimi i mundësive arsimore është mënyrë e rëndësishme për të parandaluar martestat e hershme. Është i domosdoshëm inkurajimi i fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që të vijnë në shkollë dhe mesme dhe arsimin e lartë, përmes masave afirmative si bursa dhe mbështetje institucionale, të cilat mund të ndihmojnë në këtë drejtim.

Në Kosovë ka pasur iniciativë për përfshirjen e edukimit seksual dhe riprodhues në kurrikulën shkollore, por aktualisht ato nuk janë pjesë e sistemit arsimor. Mungesa e këtij edukimi e lë rininë të ekspozuar ndaj informacionit të pakontrolluar nga interneti, me pasoja afatgjata.

Martestat e hershme lidhen ngushtë me braktisjen e shkollës tek vajzat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Prindërit shpesh i tërheqin vajzat nga shkolla, duke besuar se duhet të përgatiten për martesë dhe amësi. Familjet frikësohen se aktivitetet sociale në shkollë mund të ndikojnë në humbjen e virgjërisë së vajzave, gjë që për ta do të ishte e turpshme, për ato personalisht dhe për nderin familjar në përgjithësi.

Një zgjidhje mund të jetë detyrimi ligjor për vijimin e arsimit deri në moshën 18 vjeç, ashtu si në disa vende të BE-së, për të parandaluar martestat e hershme. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit duhet të rrisë mbështetjen për këto komunitete, duke siguruar libra falas, ushqime dhe lehtësira të tjera për fëmijët që vijnë në shkollë.

Ky dokument trajton nevojën urgjente për veprime të strukturuar për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve dhe për të garantuar një të ardhme më të sigurt për ta.

### **c) Ndikimi shëndetësor, fizik dhe psikologjik i martesave të hershme**

Martesat e hershme kanë ndikime serioze negative në shëndetin fizik dhe psikologjik të vajzave në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Një nga pasojat më të rënda është rritja e shkallës së vdekshmërisë së foshnjëve dhe rreziku i lartë i komplikimeve gjatë shtatzënisë dhe lindjes, të cilat mund të jenë fatale. Vajzat që martohen në moshë të re bëhen jashtëzakonisht të varura nga bashkëshortët dhe familjet e tyre, gjë që ato i vë në një pozitë të brishtë dhe të nënshtruar gjatë gjithë jetës së tyre. Për më tepër, ato shpesh përballen me stigmatizim nga familjet biologjike, gjë që rrit edhe rrezikun e dhunës në familje, varfërisë dhe shfrytëzimit, sidomos në rastet e ndarjes nga bashkëshorti.

Marrëdhëniet seksuale në moshë të hershme, si dhe testimi i virgjërisë, shpesh rezultojnë me probleme shëndetësore, përfshirë gjakderdhje serioze që kërkon ndërhyrje mjekësore. Këto përvoja mund të shkaktojnë trauma psikologjike, ankth dhe depresion, duke ndikuar negativisht në mirëqenien e vajzave.

### **d) Pamundësia për të kërkuar drejtësi për dëmet që rrjedhin nga martesa e fëmijëve**

Gratë dhe vajzat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian përballen me pengesa të shumta në kërkimin e drejtësisë për dëmet që u shkakton martesa e hershme. Mungesa e arsimimit dhe ndërgjegjësimit për të drejtat e tyre, si dhe normat kulturore që i detyrojnë të binden ndaj bashkëshortit dhe familjes së tij, i pengojnë të ndërmarrin hapa ligjorë. Për më tepër, diskriminimi racor dhe mungesa e vëmendjes nga institucionet shtetërore shpesh i bëjnë denoncimet e tyre të pavlera.

Shkeljet e të drejtave të njeriut në këto martesa mbeten të pandëshkuara në shumicën e rasteve, për shkak të mungesës së raportimeve, e për këtë arsye edhe statistikatat janë të pasakta. Institucionet që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me këta fëmijë, si shkollat, shërbimet shëndetësore dhe shërbimet sociale, kanë përgjegjësi të raportojnë rastet, por në praktikë, paditë për kompensim dëmi janë shumë të rralla, pavarësisht se dëmet janë shpesh të dukshme dhe të dokumentuara.

### **e) Martesa e fëmijëve dhe trafikimi me qenie njerëzore**

Varfëria, diskriminimi dhe mungesa e arsimimit janë faktorët kryesorë që e bëjnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të prekshëm edhe nga dukuria e trafikimit me qenie njerëzore. Edhe pse martesat e hershme nuk janë trafikim në vetvete, ato mund të çojnë në trafikimin e gruassë re dhe të rrisin rrezikun e saj për shfrytëzim. Gratë dhe vajzat e këtyre komuniteteve shpesh ndodhen në situata të dëshpëruara, duke u bërë më të cenueshme ndaj trafikimit, veçanërisht për prostitucion.

Në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian flitet dhe ekzistojnë dyshime të forta për shitjen e vajzave në kuadër të martesave të hershme, veçanërisht për shkak të varfërisë ekstreme, por kjo është vështirë të argumentohet për shkak se askush nuk pranon të jetë dëshmitar real. Një tjetër problem shqetësues është edhe braktisja e fëmijëve të lindur nga këto martesa, të cilët pastaj edhe përballen me sfida ligjore, por edhe shpesh mbeten jashtë sistemit të kujdesit dhe bëhen barrë e shoqërisë në përgjithësi. Për shkak të diskriminimit dhe stigmatizimit, ata rrallëherë pranohen për birësim brenda vendit, duke e bërë adoptimin ndërkombëtar shpeshherë alternativën e vetme.

# III. LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR DHE VENDOR LIDHUR ME MARTESAT E HERSHME

## 1. Aktet juridike ndërkombëtare

Martesat e hershme përbëjnë një kontradiktë midis legjislacionit dhe teorisë juridike në njërën anë, si dhe praktikës në anën tjetër. Kjo nënkupton se sistemi ligjor, si në nivel vendor ashtu edhe ndërkombëtar, përcakton masa dhe veprime për rregullimin dhe eliminimin e këtij fenomeni. Njëkohësisht, debatet dhe reagimet ndaj martesave të hershme, duke përfshirë edhe programet e shoqërisë civile, mbështesin një qëndrim të qartë se këto martesat duhet të ndalohen dhe jo të arsyetohen me kulturë apo tradita. Praktikant antiligjor duhet të ndërpriten me të gjitha mjetet dhe mundësitë e disponueshme.

Dispozitat ligjore vendore dhe ndërkombëtare të trajtuara në këtë hulumtim nuk inkurajojnë dhe nuk lejojnë martesat e hershme, pavarësisht bazës së tyre kulturore apo tradicionale. Çdo person nën moshën 18 vjeç konsiderohet fëmijë dhe gëzon të drejta të garantuara me Kushtetutë, Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe pjesën tjetër të legjislacionit përkatës. Përveç kësaj, e gjithë shoqëria ka një rol aktiv në mbrojtjen, promovimin dhe respektimin e këtyre të drejtave themelore.

*Megjithëse Republika e Kosovës nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, si dhe nuk mund të ratifikojë konventat dhe instrumentet juridike ndërkombëtare të këtij mekanizmi, ajo ka zgjedhur që përmes Kushtetutës t'i bëjë ato pjesë të legjislacionit të saj të brendshëm. Sipas nenit 22 të Kushtetutës, disa nga konventat dhe instrumentet juridike ndërkombëtare më të rëndësishme që zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë janë:*

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Poshtëruese;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje.<sup>12</sup>

<sup>12</sup>Po aty, neni 22 parag. 2. Pjesë e nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në të cilën zbatohen drejtpërdrejt konventat dhe instrumentet e caktuara ndërkombëtare janë edhe Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe Konventa

Martestat e fëmijëve, si nëngrup i martesave të detyruara, janë të palejueshme sipas legjislacionit ndërkombëtar, ndërsa e drejta për martesë është e garantuar.

**Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,**<sup>13</sup> përcakton se: *“Burrat dhe gratë e moshës madhore kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të krijojnë familje, pa asnjë kufizim në bazë të racës, shtetësisë ose fesë. Ata kanë të drejta të barabarta gjatë martesës dhe në rast të shuarjes së saj. Martesa duhet të lidhet vetëm me pëlqimin e lirë dhe të plotë të bashkëshortëve të ardhshëm.”*<sup>14</sup> Familja konsiderohet *“njësia e grupit natyror dhe themelor të shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti”*.

**Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut,**<sup>15</sup> e plotësuar nga Protokolli 11, si dhe e shoqëruar me Protokollin shtesë dhe Protokollet 1, 4, 6, 7, 12 dhe 13, në nenin 8, paragrafi 1, parasheh të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, duke specifikuar se: *“secili ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës së tij”*, ndërsa në paragrafin 2 përcaktohet se: *“asnjë autoritet publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveç asaj që është në përputhje me ligjin dhe është e nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalimin e çrregullimit apo krimin, për mbrojtjen e shëndetit ose moralin, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”*. Fatkeqësisht, neni 8 nuk është krejt i qartë për rastin kur vajza e fejuar nga prindërit e saj shkon në shtëpinë e familjes së burrit të saj të ardhshëm. Megjithatë, autoriteteve shtetërore u njihet e drejta për të inkriminuar disa akte që i referohen jetës private, si shfrytëzimi i personave të cënueshëm nga aspekti i moshës apo gjendja fizike dhe mendore.

Neni 10 rregullon lirinë e shprehjes, ku në paragrafin 1, parashihet që: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur mendime dhe për të marrë dhe për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje nga autoriteti publik dhe pavarësisht nga kufijtë...”*

E drejta për martesë, sipas nenit 12, përcakton: *“Burrat dhe gratë në moshën e martesës kanë të drejtën e martesës dhe të krijimit të familjes sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte.”*<sup>16</sup>

Gjithashtu, sipas nenit 14 për ndalimin e diskriminimit, parashihet që: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*<sup>17</sup>

Për të shmangur çdo keqkuptim të Konventës, neni 17 për ndalimin e abuzimit të të drejtave thotë se: *“Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individ, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë”*.

---

për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas.

<sup>13</sup> [https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR\\_Translations/aln.pdf](https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf)

<sup>14</sup> Deklarata Universale për të drejtat e njeriut, e miratuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Këshillit të Evropës, me Rezolutën e saj 217 A (III) të datës 10 dhjetor 1948, neni 16.

<sup>15</sup> [https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention\\_sqi](https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_sqi)

<sup>16</sup> Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, e miratuar në Romë më 4 nëntor 1950, neni 12.

<sup>17</sup> Neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, e qasur në [https://www.echr.coe.int/documents/convention\\_sqi.pdf](https://www.echr.coe.int/documents/convention_sqi.pdf)



**Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore,**<sup>18</sup> në nenin 2, thekson se shtetet nënshkruese garantojnë se: *“të drejtat e shpallura në këtë Pakt do të ushtrohen pa asnjë lloj diskriminimi për sa i përket racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, politikës, apo opinionit tjetër, origjinë kombëtare ose sociale, pronë, lindje ose status tjetër”* dhe gjithashtu, në nenin 3, që shtetet angazhohen për të *“siguruar të drejtën e barabartë të burrave dhe grave për të gëzuar të gjitha gjërat ekonomike, sociale dhe kulturore të drejtat e përcaktuara në këtë Pakt”*.

Dispozitat e Paktit dhe shtetet nënshkruese të tij pranojnë, në nenin 10, se: *“familjes, e cila është grupi natyror dhe themelor i shoqërisë, duhet t’i jepet mbrojtja dhe ndihma sa më e gjerë, veçanërisht për krijimin e saj dhe ndërkohë që ajo është përgjegjëse për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve në ngarkim, martesë duhet të lidhet me pëlqimin e lirë të bashkëshortëve”* (Par. 1).

Gjithashtu, në paragrafin 2 të nenit 10 përcaktohet se: *“mbrojtje e veçantë duhet t’u jepet nënave gjatë një periudhe të arsyeshme para dhe pas lindjes”*.

Paragrafi 3 i nenit 10 urdhëron që *“masa të veçanta të mbrojtjes dhe ndihmës duhet të merren në emër të të gjithë fëmijëve dhe të rinjve pa asnjë diskriminim për arsye prindërimi ose kushte të tjera. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të mbrohen nga shfrytëzimi ekonomik dhe social. Punësimi i tyre në punë të dëmshme për moralin ose shëndetin e tyre ose të rrezikshme për jetën ose që mund të pengojë zhvillimin normal të tyre duhet të dënohet me ligj. Shtetet gjithashtu duhet të vendosin kufijtë e moshës nën të cilët punësimi me pagesë i punës së fëmijëve duhet të ndalohet dhe të dënohet me ligj”*.

Shtetet palë në Paktin ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike,<sup>19</sup> sipas nenit 3, *“marrin përsipër të sigurojnë të drejtën e barabartë të burrave dhe grave për të gëzuar të gjitha të drejtat civile dhe politike”*.

Neni 5, paragrafi 1 nënvizon se *“asgjë në këtë Pakt nuk mund të interpretohet sikur nënkupton për cilindo shtet, grup ose person ndonjë të drejtë për t’u përfshirë në ndonjë aktivitet ose kryer ndonjë veprim që synon shkatërrimin e ndonjë prej të drejtave dhe lirive të njohura këtu ose në kufizimin e tyre në një masë më të madhe sesa parashikohet në këtë Pakt”*. ndërsa në paragrafin 2 parashihet që: *“nuk do të ketë asnjë kufizim ose shmangie nga asnjë prej të drejtave themelore të njeriut të njohura ose ekzistuese në çdo shtet palë ndaj këtij Pakti në përputhje me ligjin, konventat, rregulloret ose zakonet me pretekstin se ky Pakt nuk i njej këto të drejta ose se i njej ato në një masë më të vogël”*.

**Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike (ICCPR),**<sup>20</sup> neni 23.3, obligon shtetet të sigurojnë *“pëlqimin e lirë dhe të plotë”* për personat që hyjnë në martesë.

**Konventa për pëlqimin për martesë, moshën minimale për martesë dhe regjistrimin e martesave**<sup>21</sup> bazohet në dispozitat e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, ku Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara kishte deklaruar se disa zakone, ligje e praktika të lashta në lidhje me martesën dhe familjen nuk ishin në përputhje me parimet e përcaktuara në Kartën e Kombeve të Bashkuara si dhe në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

<sup>18</sup> Miratuar dhe hapur për nënshkrim nga Rezoluta 2200A (XXI) e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të 16 dhjetorit 1966, e cila ka hyrë në fuqi më 3 janar 1976, në përputhje me nenin 27. Në dispozicion te: <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>. Ky akt nuk është i zbatueshëm drejtpërdrejtë në Kosovë.

<sup>19</sup> Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 16 dhjetor 1966 dhe hyri në fuqi më 23 mars 1976, në dispozicion te: [http://www.unhcr.ch/html/menu3/b/a\\_ccpr.htm](http://www.unhcr.ch/html/menu3/b/a_ccpr.htm)

<sup>20</sup> <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>

<sup>21</sup> <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-consent-marriage-minimum-age-marriage-and>

Konventa ripohon se shtetet “duhet të marrin të gjitha masat e duhura me synimin për të shfuqizuar këto zakone, ligje dhe praktika të lashta, duke siguruar, ndër të tjera, liri të plotë në zgjedhjen e bashkëshortit, duke eliminuar plotësisht martesat e fëmijëve dhe fejesën e vajzave të reja para moshës madhore, duke vendosur dënimet e duhura aty ku është e nevojshme dhe duke krijuar një regjistër civil ose ndonjë regjistër tjetër në të cilin do të regjistrohen të gjitha martesat”. Kjo tregon se shteti duhet të angazhohet, me masa urgjente e specifike, në parandalimin dhe eliminimin e martesave të hershme. Sipas nenit 1 të Konventës, ku parashihet që “pëlqimi i plotë dhe i lirë i të dyja palëve, pëlqimi i tillë të shprehet personalisht prej tyre”, kërkon që të regjistrohet ligjërisht martesa. Personat të cilët nuk kanë arritur moshën minimale të paraparë me legjislacionin vendor nuk mund të lidhin ligjërisht martesë, “përveç rasteve kur një autoritet kompetent ka lejuar një përjashtim për moshën, për arsye serioze, në interes të bashkëshortëve në fjalë ” (sipas nenit 2). Mbi këto arsye, shumica absolute e martesave të lidhura nga fëmijët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, nuk kanë bazë ligjore.

Ruajtja e kulturave dhe traditave nuk mund të ketë përparësi ndaj të drejtave individuale, si liria e zgjedhjes së partnerit, zhvillimi arsimor dhe profesional, mirëqenia fizike, mendore, shpirtërore dhe morale. Konventa për Pëlqimin për martesë, moshën minimale për martesë dhe regjistrimin e martesave obligon secilin shtet të ndërmarrë masa për shfuqizimin e zakoneve dhe praktikave të dëmshme, duke siguruar liri të plotë në zgjedhjen e bashkëshortit dhe eliminimin e martesave të fëmijëve.

**Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW)**<sup>22</sup> përcakton diskriminimin ndaj grave, duke e përkufizuar në nenin 1 të Konventës si: “çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasojë ose për qëllim të komprometojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër”.

Kjo konventë dënon diskriminimin ndaj grave në të gjitha format e tij dhe sipas nenit 2, par. 6, thekson se shtetet nënshkruese duhet “të marrin të gjitha masat e përshtatshme, duke përfshirë legjislacionin, për të ndryshuar ose shfuqizuar ligjet ekzistuese, rregulloret, zakonet apo praktikatat të cilat përbëjnë diskriminimin ndaj gruas”.

Gjithashtu, neni 5a përcakton: “Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e duhura për të modifikuar modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së burrave dhe grave, me synimin për të arritur eliminimin e paragjyqimeve dhe praktikave zakonore dhe të tjera që bazohen në idenë e inferioritetit ose të epërsisë së cilësdo prej gjinive, apo në rolet e stereotipizuara për burrat dhe gratë”.

Neni 10 i Konventës kërkon që shtetet t’u sigurojnë grave “të drejta të barabarta me burrat në fushën e arsimit dhe në veçanti të sigurojnë barazi midis burrave dhe grave”. Pastaj në paragrafin 1 përcaktohet se “Kushte të njëjta të bërjes së karrierës dhe të kualifikimit profesional, të vijimit të shkollave dhe të marrjes së diplomave në institucionet arsimore të të gjitha kategorive, si në fshat ashtu edhe në qytet; kjo barazi sigurohet në arsimin parashkollor, të përgjithshëm, teknik profesional dhe në arsimin teknik të lartë, si dhe në çdo institucion tjetër të kualifikimit profesional”. Mes tjerash në paragrafin 6 përcaktohet se detyrimi për ndërmarrjen e masave për “uljen e shkallës së braktisjes së shkollës dhe organizimin e programeve për vajzat dhe gratë që kanë lënë shkollën para kohe”. Gjithashtu, paragrafi 8 parasheh të drejtën për “qasje në informata specifike arsimore për të ndihmuar në sigurimin e shëndetit dhe mirëqenies së familjeve, duke përfshirë informacionin dhe këshillat për planifikimin familjar”.

<sup>22</sup> <https://hrrp.eu/alb/docs/CEDAw-a.pdf>



Konventa rikonfirmon, në nenin 16, paragrafi 1, pika a), të drejtën e burrave dhe grave për t'u: *"lidhur në martesë"*, ndërsa në pikën b) përcaktohet e drejta për ta *"zgjedhur lirisht bashkëshortin dhe për të lidhur martesë vetëm me pëlqimin e vet të lirë dhe të plotë"*. Gjithashtu pika c) siguron *"të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi gjatë martesës dhe në rast të zgjidhjes së saj"* dhe pika d), ku përcaktohet se *"të drejtat dhe përgjegjësitë e njëjta si prindër, pavarësisht nga gjendja martesore, për ato çështje që kanë të bëjnë me fëmijët. Në të gjitha rastet interesi i fëmijëve duhet të jetë në vend të parë"*.

Ndërsa, Neni 16 i CEDAW përcakton: *"Shtetet Palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe marrëdhëniet familjare"*. Për më tepër në nenin 16, paragrafi 2 përcaktohet se: *"Fejesat dhe martesat e fëmijëve të mitur nuk kanë efekt juridik, prandaj duhet të merren të gjitha masat e nevojshme, duke përfshirë legjislacionin, me qëllim që të caktohet një moshë minimale për martesë dhe të bëhet i detyrueshëm regjistrimi i martesës në një regjistër zyrtar"*.

Në këtë drejtim, neni 24 përcakton se: *"Shtetet palë zotohen të miratojnë të gjitha masat e nevojshme në shkallë kombëtare për të arritur realizimin e plotë të të drejtave të njohura në këtë Konventë"*.

Po ashtu, Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 21 i CEDAW përcakton: *"E drejta e gruas për të zgjedhur bashkëshortin dhe për të hyrë lirisht në martesë është thelbësore për jetën e saj dhe për dinjitetin dhe barazinë e saj si qenie njerëzore"*.

**Konventa Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare**<sup>23</sup>, në nenin 4, paragrafi 1, kërkon që shtetet nënshkruese t'u *"garantojnë personave që u përkasin pakicave kombëtare të drejtën e barazisë para ligjit dhe të mbrojtjes së barabartë nga ligji. Lidhur me këtë, ndalohet çdo diskriminim bazuar në përkatësinë në një pakicë kombëtare"* si dhe, gjithashtu, në paragrafin 2 përcaktohet se shtetet duhet të miratojnë: *"masa adekuate për të promovuar, në të gjitha fushat ekonomike, sociale, politike dhe kulturore, barazi të plotë dhe efektive midis personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës. Lidhur me këtë, shtetet duhet të marrin parasysh në mënyrën e duhur kushtet e veçanta të personave që u përkasin pakicave kombëtare"*. Paragrafi 3 përcakton se: *"Masat e miratuara në përputhje me paragrafin 2 nuk mund të konsiderohen si akt diskriminimi"*.

Neni 9, mes tjerash, përcakton se: *"e drejta e lirisë së shprehjes së çdo personi që i përket një pakice kombëtare përfshin lirinë për të pasur mendime, si dhe për të marrë e shpërndarë informacione e ide në gjuhën e pakicës, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pavarësisht nga kufijtë. Palët duhet të sigurojnë, brenda kuadrit të sistemeve të tyre ligjore, që personat që i përkasin një pakice kombëtare të mos diskriminohen lidhur me raportet e tyre me shtypin"*.

Neni 20 i kësaj Konvente thotë se *"në ushtrimin e të drejtave dhe lirive që burojnë nga parimet e parashikuara në këtë Konventë Kornizë, secili do person që i përket një pakice kombëtare duhet të respektojë legjislacionin kombëtar dhe të drejtat e të tjerëve, veçanërisht atyre të personave që i përkasin shumicës apo pakicave të tjera kombëtare"*.

Në vazhdim, neni 21 përmend se: *"asgjë në këtë Konventë Kornizë nuk mund të interpretohet se nënkupton ndonjë të drejtë për t'u angazhuar në aktivitete apo për të kryer ndonjë veprim kundër parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare, e veçanërisht barazisë sovrane, integritetit territorial dhe pavarësisë politike të shteteve"*. Neni 22 thotë se asgjë *"në këtë Konventë Kornizë nuk do të kuptohet se kufizon apo shmang ndonjë prej të drejtave të njeriut dhe lirive themelore që mund të sigurohen sipas ligjeve të ndonjë Pale Kontraktuese, apo sipas ndonjë marrëveshje tjetër ku ajo është Palë"*.

<sup>23</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=73766>

**Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës (KDF)**<sup>24</sup> përbën kontratë për të drejtat e fëmijëve me më së shumti ratifikime (mbi 200 shtete). Gjithashtu, kjo Konventë, me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është bërë juridikisht e detyrueshme sipas nenit 22 (7), pjesë e sistemit juridik të brendshëm të Republikës së Kosovës si dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Është me rëndësi të përmendet Neni 2 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, i cili ndalon diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike. Gjithashtu, neni 3.1 i KDF-së ofron mbrojtje të posaçme për fëmijët, ku parashihet: *“Në të gjitha veprimet në lidhje me fëmijët [...] interesi më i mirë i fëmijës do të jetë një konsideratë parësore”*. Po ashtu, neni 24.3 thekson domosdoshmërinë e braktisjes së traditave primitive të cilat dëmtojnë fëmijët, ku përcaktohet se: *“shtetet palë do të marrin të gjitha masat efektive dhe të përshtatshme me qëllim të shfuqizimit të praktikave tradicionale që dëmtojnë shëndetin e fëmijëve”*. Ndërsa, e drejta për arsim përcaktohet në nenin 28 të kësaj konvente.

Në këtë Konventë, në fakt, në një vend të vetëm janë përfshirë të gjitha të drejtat njerëzore të cilat pranohen për një grup të veçantë të njerëzve (fëmijët), gjë që paraqet risi në të drejtën ndërkombëtare që vendoset nën ombrellën e Kombeve të Bashkuara. Falë kësaj, Konventa është bërë kontrata ndërkombëtare më e rëndësishme për të drejtat e fëmijëve, ndërsa të gjitha instrumentet tjerë ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, dispozitat e veçanta të të cilëve i kushtohen të drejtave të fëmijëve, janë të natyrës subsidiare. Me një fjalë, Konventa e Kombeve të Bashkuara (KB) për të drejtat e fëmijës sot është autoriteti më i lartë në fushën e të drejtës ndërkombëtare të fëmijëve (sipas dispozitës së nenit 1 të Konventës, fëmijë është çdo qenie njerëzore e cila nuk i ka mbushur 18 vjet, nëse, sipas ligjit i cili zbatohet ndaj fëmijës, mosha madhore nuk fitohet më herët). Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës në mënyrë të hollësishme trajton të drejtat politike, civile, ekonomike, sociale dhe kulturore nga perspektiva e fëmijës.

Kjo Konventë, duke u bërë juridikisht e detyrueshme në Republikën e Kosovës, si dhe pjesë e sistemit juridik të brendshëm, mandaton respektimin e këtij dokumenti ndërkombëtar, por me këtë edhe detyrimin që në kuadër të juridiksionit shtetëror të ndërmarrë aktivitetet që kanë të bëjnë me hartimin e legjislacionit dhe të rregullave, por edhe të dispozitave të cilat, në mënyrë të veçantë, vlejnë për të miturit delikuentë, si dhe të formojë institucione e organe të cilëve u besohen funksione të drejtësisë për të mitur, e të cilat kanë për qëllim të japin përgjigje për nevojat e ndryshme të delikuentëve të mitur, duke mbrojtur njëkohësisht të drejtat e tyre themelore, pastaj që të japin përgjigje për nevojat e shoqërisë si dhe të sigurojnë zbatimin bazik dhe të drejtë të këtyre rregullave.

Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës ndahet në tri pjesë. Preambula i ngjan parimeve themelore të Kombeve të Bashkuara dhe dispozitave të veçanta të instrumenteve relevante të caktuara për të drejtat njerëzore. Ajo thekson që fëmijëve, për shkak të ndjeshmërisë së tyre, u nevojitet mbrojtja dhe kujdesi i veçantë, ndërsa në këtë drejtim theksohet edhe roli kryesor i familjes. Në preambulë riafirmohen domosdoshmëria e mbrojtjes së të drejtave dhe e llojeve tjera të mbrojtjes për fëmijë, para dhe pas lindjes, rëndësia e respektimit të vlerave kulturore të bashkësisë nga e cila rrjedh fëmija, si dhe roli vital i bashkëpunimit ndërkombëtar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Shteti nënshkruar duhet të bëjë gjithçka që është në fuqinë e tij që të zbatojë të drejtat e renditura në Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijës.

<sup>24</sup> Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës (1989) – A/Rezol/44/25, 20 nëntor 1989. – Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës, miratuar në Asambleenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, ndërsa ka hyrë në fuqi më 2 shtator 1990.

Pjesa e parë e Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës përmban katalogun e të drejtave që u njihen fëmijëve, por edhe disa dispozita me të cilat shteteve nënshkruese u urdhërohet ndërmarrja e të gjitha masave për realizimin e drejtave nga Konventa, si dhe respektimi i standardeve më të larta në këtë fushë, si në nivelin ndërkombëtar, ashtu edhe në nivelin nacional.

*Duke qenë që të drejtat e fëmijës janë përshkruar në Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijës, duhet theksuar se Komiteti për të drejtat e fëmijës (i cili është organ mbikëqyrës i Konventës) ka miratuar një klasifikim të veçantë të të drejtave të fëmijës, me ndihmën e të cilit shteteve anëtare u lehtësohet raportimi për zbatimin e detyrimeve të marra përsipër nga Konventa. Në të vërtetë, Komiteti për të drejtat e fëmijës së pari ndan çështjen e përkufizimit të fëmijës (fëmijë është çdo qenie njerëzore deri në moshën 18 vjeçare)<sup>25</sup>, e më pastaj jep tërësinë e parimeve themelore, të cilën e përbëjnë:*

- a)** Të drejtat, pa kurrfarë diskriminimi ndaj fëmijës, prindërve të tij, kujdestarëve në pikëpamje të racës, gjinisë, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, fesë, gjendjes pasurore, prejardhjes nacionale, etnike ose sociale, etj.,<sup>26</sup>
- b)** e drejta e respektimit të interesit më të mirë të fëmijës në të gjitha aktivitetet e organizatave, publike ose private, të cilët merren me fëmijë, duhet të jetë me rëndësi prioritare;<sup>27</sup>
- c)** e drejta e fëmijës për jetë – në masën më të madhe të mundshme, shteti duhet të sigurojë ekzistencën dhe zhvillimin e fëmijës;<sup>28</sup> dhe
- d)** e drejta në participim, përkatësisht pjesëmarrje të fëmijës, apo thënë thjesht respektimi i qëndrimeve të fëmijës.<sup>29</sup>

*Këto të drejta janë parakushte për realizimin e të gjitha të drejtave tjera nga Konventa dhe paraqesin çështje paraprake në realizimin e të drejtave të fëmijëve. Pas këtyre, renditen të drejtat civile dhe politike:*

- a.** e drejta në identitet, duke përfshirë nënshtetësinë, emrin dhe marrëdhëniet familjare, përkatësisht lidhjet;
- b.** e drejta e fëmijës që të dijë se cilët janë prindërit, si dhe e drejta për kujdesin e tyre;<sup>30</sup>
- c.** e drejta e shprehjes së lirë të mendimit të tij dhe qasja e fëmijës në informacione;<sup>31</sup>
- d.** liria e mendimit, ndërgjegjes dhe të religjionit;<sup>32</sup>
- e.** liria e bashkimit të qetë dhe liria e tubimit të lirë;<sup>33</sup>
- f.** e drejta e privatësisë;<sup>34</sup> dhe
- g.** e drejta e ndalimit të maltretrimit ose procedurave tjera të vrazhda, çnjerëzore apo nënçmuese, apo të dënimeve.<sup>35</sup>

Mjedisi familjar dhe kujdesi alternativ për fëmijën paraqesin sferë të ndarë, në të cilën janë gjithësesi të drejtat e ndërlidhura me jetën familjare dhe mbajtjen e marrëdhënieve me prindërit dhe kujdestarët.<sup>36</sup> Në veçanti janë definuar të drejtat e fëmijës që privohet nga mjedisi familjar. Te drejtat e fëmijës në lidhje me

<sup>25</sup> Neni 1 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>26</sup> Neni 2 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>27</sup> Neni 3 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>28</sup> Neni 6 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>29</sup> Neni 12 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>30</sup> Neni 7 - 8 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>31</sup> Neni 13 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>32</sup> Neni 14 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>33</sup> Neni 15 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>34</sup> Neni 16 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>35</sup> Neni 37 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>36</sup> Neni 9, 10 dhe 18 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

vendosjen alternative,<sup>37</sup> në veçanti adoptimin,<sup>38</sup> janë të njohura me dispozita të veçanta. Pjesë përbërëse e kasaj kategorie janë edhe të drejtat e fëmijës në mbrojtje nga kalimi i paligjshëm i kufirit, ndalimit jashtë vendit dhe kidnapimit prindëror<sup>39</sup> dhe e drejta e fëmijës në mbrojtje nga dhuna, keqtrajtimi dhe lënia pas dore nga prindërit e tij apo nga dikush tjetër që kujdeset për të.<sup>40</sup> Grup të veçantë përbëjnë e drejta në mbrojtje të veçantë shëndetësore dhe sociale,<sup>41</sup> pastaj e drejta në arsimim, kohë të lirë, rekreacion dhe aktivitete kulturore (nenet 28 – 31).<sup>42</sup>

Në grupin e veçantë të të drejtave, Komiteti i radhit të drejtat e fëmijëve të cilët gjenden në situata të posaçme ku bien të drejta e fëmijëve refugjatë;<sup>43</sup> të drejtat e fëmijëve në konflikt të armatosur ushtarak;<sup>44</sup> e drejta në mbrojtje nga eksploatimi seksual, ekonomik dhe të eksploatimit tjetër;<sup>45</sup> e drejta në procedurë në kuadër të sistemit të drejtësisë për të mitur;<sup>46</sup> e drejta e fëmijëve pjesëtarë të grupit të pakicës apo të popullatës autoktone<sup>47</sup> dhe në fund, e drejta e fëmijëve viktimat të ndonjë rrethane që kanë kontribuar në statusin e fëmijës në situatë të veçantë, në përmirësimin fizik dhe psikik, si dhe të reintegritimit shoqëror të fëmijës.<sup>48</sup>

Pjesa e dytë e Konventës përmban dispozita me të cilat më tej elaborohen detyrimet e shteteve anëtare dhe rregullohet edhe themelimi dhe puna e organit të veçantë mbikëqyrës – Komitetit për të drejtat e fëmijëve.

Pjesa e tretë e Konventës rregullon çështjet e nënshkrimit, ratifikimit, hyrjes në fuqi, depozitimit të rezervimeve, ndryshimeve, revokimeve dhe deponimit të këtij instrumenti.

*Nga pikëpamja e të drejtës penale të të miturve, janë gjithësesi të rëndësishme në veçanti dispozitat e Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijëve lidhur me drejtësinë për të mitur, të cilat i gjejmë në nenet 37, 39 dhe 40 të Konventës. Kështu në nenin 37 (a) të Konventës është paraparë se palët, përkatësisht shtetet nënshkruese të Konventës, duhet të sigurojnë:*

- që asnjë fëmijë të mos i nështrohet maltretimeve ose formave tjera të veprimit apo dënimit të vrazhdë, çnjerëzor ose nënçmues;
- ndalimin e aplikimit të dënimit me vdekje ose burgimit të përjetshëm pa mundësi lirimi;
- që asnjë fëmijë të mos paraburgoset në mënyrë jo të ligjshme apo arbitrare, përkatësisht të privohet nga liria në atë mënyrë;
- që mbajtja në paraburgim, burgim dhe mbajtje të fëmijës të kryhet në pajtim me ligjin dhe që të zbatohet si masë apo mjet i fundit i mundshëm, si dhe atë në kohëzgjatje më të shkurtër të mundshme, përkatësisht në kohëzgjatje të përshtatshme (neni 37 (b) i Konventës);
- që me secilin fëmijë të privuar nga liria të veprohet në mënyrë humane, duke respektuar dinjitetin e fituar me lindje si çdo qenie njerëzore, si dhe në mënyrën në të cilën respektohen nevojat e personit të moshës së tij;

<sup>37</sup> Neni 20 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>38</sup> Neni 21 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>39</sup> Neni 11 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>40</sup> Neni 19 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>41</sup> Neni 24-26 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e fëmijës

<sup>42</sup> Neni 28-31 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>43</sup> Neni 22 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>44</sup> Neni 38 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>45</sup> Neni 32 - 36 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>46</sup> Neni 40 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>47</sup> Neni 30 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

<sup>48</sup> Neni 39 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës

- që secili fëmijë të privuar nga liria të mbahet i ndarë nga të rriturit, përveç nëse është vendosur në të kundërtën me qëllim të mirëqenies së fëmijës dhe të interesit të tij, si dhe që fëmija i privuar të ketë të drejtë të mbajë kontakt me familjen e vet përmes korrespondencës dhe vizitave, përveç në rrethana të jashtëzakonshme;
- që çdo fëmijë i privuar nga liria të ketë të drejtë që menjëherë t'i mundësohet qasja në ndihmë juridike dhe ndihmë tjetër përkatëse, si dhe të drejtë që fëmija të kontestojë ligjshmërinë e privimit nga liria para gjykatës ose organeve të tjera kompetente, të pavarura dhe të paanshme, përkatësisht të drejtë të ankohet ndaj vendimit për paraburgim, si dhe e drejta në vendim-marrje të shpejtë në çdo procedurë të tillë.

Dispozita e nenit 39 të Konventës thekson rëndësinë e rehabilitimit dhe të reintegrimit shoqëror të fëmijës, si dhe obligon shtetet kontraktuese të nxisin rimëkëmbjen fizike e psikike të fëmijës, si dhe që të ruajnë shëndetin, vetë-respektin dhe dinjitetin e fëmijës gjatë të gjitha përpjekjeve të orientuara kah rehabilitimi e reintegrimi.

*Në anën tjetër, të drejtat të cilat duhet respektuar në të gjitha etapat e procedurës penale, e që janë elemente thelbësore për gjykim të ndershëm dhe të drejtë, janë radhitur në nenin 40 të Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijëve, Rregullat e Pekinit (shih rregullën 7) dhe dokumentet e tjera ndërkombëtare, ndërsa ato kanë të bëjnë me:*

- të drejtën që fëmijës t'i tregohet se për çka dyshohet;
- të drejtën që mos të deklarohet (të mbrohet në heshtje);
- të drejtën të deklarohet i pafajshëm (prezumimi i pafajësisë);
- e drejta që pranimi mos të bëhet me dhunë;
- të drejtën në ndihmë juridike në përgatitje për procedurë gjyqësore;
- të drejtën e pranisë së prindërve ose të kujdestarit;
- të drejtën në mjete juridike efektive;
- të drejtën në zbatimin e procedurës "pa shtyerje";
- të drejtën e marrjes në pyetje të tërthortë të dëshmitarit në anën tjetër, si dhe sigurimi e marrja në pyetje e dëshmitarëve të vet në kushte të njëjta.

Gjithashtu, Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës në nenin 40 (3) i detyron shtetet kontraktuese të nxjerrin ligje e të vendosin procedura e institucione të cilat duhet të veprojnë në rastet e fëmijëve të cilët bien në konflikt me ligjin, pastaj i obligon që të krijojnë programe të heqjes dorë nga procedura gjyqësore (të ashtuquajtura procedura diversiteti), pastaj të alternativave të trajtimit institucional të të miturve, me qëllim të mbrojtjes dhe mirëqenies së tyre.

**Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit),<sup>49</sup>** në nenin 32 përcakton pasojat civile të martesave të detyruara, ku specifikisht kërkohet që: *"Palët të marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që martesat e detyruara të mund të jenë të pavlefshme, të anulohen ose zgjidhen pa barra të papërshtatshme financiare ose administrative të vendosura ndaj viktimës".* Gjithashtu, edhe neni 37 i kësaj Konvente përmban dispozita mbi martesat e detyruara, ku në paragrafin 1 përcakton se: *"Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e detyrimit të qëllimshëm të një të rrituri ose fëmije për të lidhur martesë",* ndërsa në paragrafin 2 përcakton se: *"Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e tërheqjes së qëllimshme të një të rrituri ose fëmije për të shkuar në territorin e një Pale apo Shteti tjetër nga ai ku ai ose ajo banon, me qëllim detyrimin e të rriturit ose fëmijës për të lidhur martesë".*

<sup>49</sup> <https://awenetwork.org/media/646206ffddf6d.pdf>.



**Rezoluta 1468 për martesat e detyruara dhe martesat e fëmijëve, miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në vitin 2005,**<sup>50</sup> është dokument shumë i rëndësishëm, në të cilin, Këshilli i Evropës shpreh shqetësimin e tij lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut, e sidomos të të drejtave të fëmijës, nga martesat e detyruara dhe martesat e fëmijëve. Martesën e fëmijëve Asambleja Parlamentare e përcakton si “bashkimin e dy personave, të paktën njëri prej të cilëve është nën moshën 18 vjeç”, neni 7.

Rezoluta e Asamblesë Parlamentare, në nenin 3, tërheq vëmendjen për faktin se “nën petkun e respektit për kulturën dhe traditat e komuniteteve të migrantëve, ka autoritete që tolerojnë martesat e detyruara dhe martesat e fëmijëve, përkundër që cenojnë të drejtat themelore të çdo viktime”. Kjo problematikë së pari prek vajzat dhe gratë e reja, andaj lidhja e martesave të hershme është shkelje drastike e të drejtave të fëmijëve. Me këto martesë ndikohet në përqendrim të mirëqenies fiziologjike dhe psiko-fizike të fëmijëve, e në të shumtën e rasteve, ata përballen me pengesa në vijimin e shkollës, duke shkaktuar kështu pengesa në zhvillimin e tyre intelektual dhe social.

**Rezoluta 2263 (XXII), e datës 7 nëntor, 1967, e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara,** sanksionon diskriminimin ndaj gruas, ku në nenin 1 përcakton se: “Diskriminimi ndaj gruas, për faktin që mohon dhe kufizon barazinë e të drejtave të gruas me burrin, është në themel i padrejtë dhe përbën shkelje të dinjitetit njerëzor”<sup>51</sup>.

**Strategjia për Avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, si dhe Plani i veprimit 2022-2024**<sup>52</sup> paraqesin një vazhdimësi të politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërtimin e një shoqërie shumetnike dhe krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve.

**Korniza e BE-së për Integrimin e Romëve** ka definuar pesë fusha të veprimit, të cilat adresohen në Strategji, si: **arsimi, punësimi dhe mirëqenia sociale, shëndetësia, banimi dhe mos-diskriminimi.** Këto fusha paraqesin prioritetet me të cilat duhet të ballafaqohet zbatimi i Strategjisë, të cilat edhe ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Në shumicën e rasteve, paraqiten edhe shkaqe apo pasoja e efekte të njëra-tjetres, prandaj është jetike të punohet në secilën prej fushave, në mënyrë që të arrihen rezultate efektive. Kjo Strategji përmban pjesë të caktuara ku përmenden edhe martesat e hershme, si dhe pjesë që trajtojnë pozitën e grave, duke përfshirë rekomandimet që synojnë përmirësimin e gjithëmbarshme të gjendjes së përgjithshme të të drejtave të grave dhe fëmijëve, duke përfshirë edhe martesat e hershme të fëmijëve.

**Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim, Deklarata Politike Pekin dhe Rezultati,**<sup>53</sup> në dispozitat e neneve 39 dhe 71, martesat e hershme të fëmijëve i konsideron si praktikë të dëmshme, diskriminuese përse i takon qasjes në procesin arsimor, veçanërisht për vajzat, si dhe rekomandon të ndërmerren masa specifike për përmirësimin e masave për mbrojtjen e vajzave.

Sipas pikës 259 të kësaj Deklarate, qëndrimet dhe praktikat për martesat dhe shtatzënitë e hershme çojnë në braktisje të hershme të shkollës dhe rezultate të dobëta shkollore të vajzave në krahasim me djemtë, në shumicën e rasteve për shkak të qëndrimeve patriarkale, detyrave shtëpiake të vajzave pas martesës së hershme, si dhe obligimet e shumta që sjell me vete martesë. Për më tepër, siç përcaktohet në pikën 268

<sup>50</sup> <https://assembly.coe.int/nw/xml/xref/xref-xml2html-en.asp?fileid=17380&lang=en>

<sup>51</sup> Për më tepër për këtë dhe për akte tjera juridike ndërkombëtare të interesuarit i udhëzojmë në literaturë: Të drejtat e njeriut-përmbledhje e instrumenteve ndërkombëtare, Vëllimi i parë, Kombet e Bashkuara New York dhe Gjenevë, 1994

<sup>52</sup> <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/05/Strategjia-per-avansimin-e-te-drejtave-te-komuniteteve-rom-dhe-ashkali-ne-Republiken-e-Kosoves-2022-2026-dhe-Plani-i-veprimit-2022-2024.pdf>

<sup>53</sup> [https://archive.unescwa.org/sites/www.unescwa.org/files/u1281/bdpfa\\_e.pdf](https://archive.unescwa.org/sites/www.unescwa.org/files/u1281/bdpfa_e.pdf)

të Platformës për Veprim, martesat e hershme janë pengesë për përmirësimin e statusit arsimor, ekonomik dhe social të grave në të gjitha pjesët e botës. Marrë në përgjithësi, martesa e hershme dhe amësia e hershme mund të tkurrin ndjeshëm mundësitë e arsimimit dhe punësimit, si dhe ka të ngjarë të kenë ndikim negativ afatgjatë në cilësinë e jetës së tyre dhe të fëmijëve të tyre.

Sipas pikës 274, paragrafi (e), për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit ndaj vajzave, qeveritë nënshkruese duhet të miratojnë dhe të zbatojnë rreptësisht ligje për të siguruar që martesa të lidhet vetëm me pëlqimin e lirë dhe të plotë të bashkëshortëve. Përveç kësaj, shtetet duhet të miratojnë dhe zbatojnë në mënyrë rigorozë ligje në lidhje me moshën minimale për martesë.

Gjithashtu, një pikë e rëndësishme është pika 277, në të cilën përcaktohet se për të eliminuar qëndrimet dhe praktikën negative kulturore ndaj vajzave, qeveritë dhe organizatat joqeveritare duhet të *“zhvillojnë politika dhe programe, duke i dhënë përparësi programeve të edukimit formal dhe informal që mbështesin vajzat dhe u mundësojnë atyre të fitojnë njohuri, të zhvillojnë vetë-vlerësimin dhe të marrin përgjegjësinë për jetën e tyre, si dhe të vendosin fokus të veçantë në programet për edukimin e grave dhe burrave, veçanërisht prindërve, mbi rëndësinë e shëndetit fizik dhe mendor të vajzave, mirëqenien, duke përfshirë eliminimin e diskriminimit ndaj vajzave në ndarjen e ushqimit, martesat e hershme, dhunën ndaj vajzave, gjymtimin gjental femëror, prostitucionin e fëmijëve, abuzimin seksual, përdhunimin dhe incestin”*.

## 2. Aktet juridike të brendshme

Është e papranueshme dhe shqetësuese prania e martesave të hershme në Republikën e Kosovës, veçanërisht tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, ku shkelet e drejta e njeriut dhe në veçanti, e drejta e fëmijës për mbrojtje nga martesat e detyruara. Kjo situatë nuk mund të tolerohet nga autoritetet shtetërore dhe shoqëria në përgjithësi, që në një mënyrë apo tjetër me heshtjen e tyre të lejojnë një praktikë të tillë, duke u fshehur prapa justifikimit të respektimit të kulturës dhe traditës, sepse kjo bie ndesh me të drejtat themelore të fëmijëve, në kundërshtim me nenin 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Në këtë drejtim, institucionet publike të mandatuar për zbatimin e ligjit kundër diskriminimit dhe për barazinë gjinore duhet të veprojnë në përputhje me ligjin dhe të bashkëpunojnë me komunitetet e prekura, si dhe me organizatat që promovojnë të drejtat e pakicave dhe mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat. Fatkeqësisht, autoritetet shpesh nuk ndërhyjnë në mënyrë efektive për të parandaluar ose eliminuar shkeljet e të drejtave të fëmijës që ndodhin për shkak të martesave të hershme. Mungesa e reagimit institucional sjell pasojë të rënda, si mungesa e mbrojtjes sociale për çiftet e reja dhe mohimi i mbështetjes që shteti duhet të ofrojë për familjen.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës njeh të drejtën e martesës dhe krijimit të familjes si një të drejtë themelore të njeriut. Shprehimisht ajo përcakton: *“Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin”*.<sup>54</sup>

Një përkufizim uniform i termit *“fëmijë”* nuk ekziston brenda kornizës ligjore, por ekziston një harmonizim i përgjithshëm se fëmija arrin moshën madhore kur mbush 18 vite të jetës, pavarësisht se mund të ketë dallime në përdorimin e terminologjisë, përmbajtja është e njëjtë. Për më tepër edhe Kushtetuta përdor termin fëmijë për të gjithë personat që nuk kanë mbushur moshën madhore.

<sup>54</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 37.

**Ligji i Kosovës Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës**<sup>55</sup> përmban rregulla me të cilat mbrohen të drejtat dhe interesat e fëmijëve. Kështu, vlen të përmendet neni 3 i Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, në pjesën e përkufizimeve, paragrafi 1, nënparagrafi 1.10. përcaktohet se kush është fëmijë në nevojë: *“Fëmijë në nevojë për mbrojtje - është personi nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individ i nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer veprë penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin”*. Andaj secili fëmijë ka nevojë për mbrojtje dhe kjo është e drejtë e tyre, ndërsa prindërit, familja, shoqëria dhe institucionet shtetërore në përgjithësi kanë për detyrë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, duke përfshirë edhe mbrojtjen e fëmijëve nga martesat e hershme dhe format e ndryshme të abuzimit me të drejtat e tyre. Nga kjo dispozitë e përkufizimeve shihet qartë se sa është e gjerë fusha e mbrojtjes së fëmijëve.

Gjithashtu ky Ligj përshkruan parimin e interesit më të mirë të fëmijës, ku në nenin 5, paragrafi 1, përcaktohet që: *“të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo nga organet legjislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese dhe më e larta”*. Në linjë me këtë, është me rëndësi edhe paragrafi 3 i nenit 5, i cili përcakton se: *“Interesi më i mirë i fëmijës kërkon një përpjekje tërësore për të siguruar integritetin fizik, psikologjik, moral dhe shpirtëror të fëmijës dhe për të promovuar dinjitetin njerëzor, duke marrë parasysh karakteristikat individuale dhe gjendjen sociale të fëmijës”*.

Detyrimi për respektimin e pikëpamjes së fëmijës është detyrim ligjor edhe në Ligjin për mbrojtjen e fëmijës në Kosovë, ku në nenin 7, paragrafi 1 përcaktohet se: *“Në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, kanë për obligim t’i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t’i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit në fuqi”*.

Kjo nënkupton se të gjitha autoritetet publike dhe private, duke përfshirë edhe personat fizikë dhe juridikë kanë për detyrë të përfaqësojnë fëmijën në të gjitha vendimet, veprimet dhe masat e marra në lidhje me të drejtat e tyre, duke ofruar edhe mbështetjen kujdesin, edukimin, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve, ndërsa fëmijë konsiderohet secili që nuk ka arritur moshën 18 vjeçare.

Gjithashtu ky Ligj, me dispozitën e nenit 8 sanksionon edhe mos-diskriminimin, ku në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Çdo fëmijë ka të drejtë në të njëjtat të drejta të njohura me legjislacionin në fuqi dhe Konventën, t’i garantohen ato pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij, apo përfaqësuesve të tij ligjorë”*.

Pra siç shihet, me këto dhe shumë dispozita tjera të këtij ligji promovohen mundësitë e barabarta, mosdiskriminimi, si dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, të cilat duhet të konsiderohen të shenjta, ashtu siç është i shenjtë secili fëmijë, pa asnjë dallim.

<sup>55</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>



Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventës për të Drejtat e Njeriut, Konventës për të drejtat e fëmijës, si dhe ligjeve përkatëse që përmbajnë dispozita për të drejtat e njeriut, e drejta e lirisë së shprehjes u sigurohet të gjithë personave, pavarësisht moshës. Edhe fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes dhe kjo e drejtë duhet të promovohet dhe sigurohet veçanërisht nga prindërit ose kujdestari ligjor, të cilët duhet të ofrojnë informata, shpjegime dhe këshilla sipas moshës dhe shkallës së pjekurisë së fëmijëve, të cilat pastaj i mundësojnë atyre të shprehin pikëpamjet, idetë dhe mendimet e tyre. Pa dyshim se fëmija ka aftësinë për të dalluar dhe të drejtën për të shprehur lirisht mendimin e tij/saj në lidhje me çdo çështje që ka të bëjë me të. E drejta për t'u dëgjuar i jep fëmijës mundësinë për të kërkuar dhe të marrë çdo informacion përkatës, të konsultohet, të shprehë mendimin e tij ose të saj dhe të informohet për pasojat që mund të gjenerojë mendimi i tij ose i saj, nëse vërehet, si dhe për pasojat e çdo vendimi që e përfshin atë. Të drejtat e njëjta me legjislacionin në fuqi në Kosovë u njihen edhe fëmijëve që i përkasin një pakice etnike, fetare ose gjuhësore, të cilët padyshim se kanë të drejtë të kenë jetën e tyre kulturore, të deklarojnë përkatësinë e tyre etnike dhe fetare, të ushtrojnë fenë, si dhe të drejtën për të përdorur secilën të drejtë, e cila i njihet sipas legjislacionit në fuqi.

**Ligji për familjen i Kosovës**<sup>56</sup> përmban dispozita materiale juridike dhe procedurale për familjen dhe marrëdhëniet familjare, duke përfshirë edhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Martestat e fëmijëve deri në 16 vjeç, përveç që janë të kundërligjshme, ato shkaktojnë debate edhe mbi aftësinë e tyre për të dalluar, si dhe lidhur me faktin e pajtimit për martesë, si dhe për rolin përcaktues dhe pozicionin e prindërve në sigurimin e informatave relevante për fëmijët, e sidomos për pasojat që mund të kenë nga veprime të tilla.

Është e drejtë themelore e fëmijës të rritet së bashku me prindërit e tij ose të saj. Prindërit duhet të ofrojnë, në mënyrën e duhur për zhvillimin e aftësive të fëmijës, udhëzimet dhe këshillat e nevojshme që nevojiten për ushtrimin e duhur të të drejtave të përcaktuara me këtë ligj.

Secili fëmijë ka të drejtë të rritet në një mjedis dhe të ketë një standard jetese që do të mundësojë zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe social të fëmijës, ndërsa prindërit kanë për detyrë të kujdesen dhe ta mbikëqyrin rritjen dhe zhvillimin e fëmijës, të bashkëpunojnë me fëmijën dhe të respektojnë të drejtat personale dhe private të fëmijës për jetë dhe dinjitet. Gjithashtu, fëmija ka të drejtën të marrë edukimin që i mundëson atij ose asaj të zhvillojë kapacitetet dhe personalitetin e tij, në kushte jodiskriminuese. Prindërit e fëmijës kanë përparësi në zgjedhjen e llojit të edukimit që do të marrë fëmija, si dhe duhet të sigurojnë vijimin e rregullt të mësimi nga fëmija.

Fëmijët gëzojnë mbrojtje nga të gjitha format e dhunës, duke përfshirë dhunën seksuale, dëmtimin ose abuzimin fizik ose mendor, keqtrajtimin apo shfrytëzimin, braktisjen ose neglizhencën, e gjithashtu e edhe mbrojtjen nga martesat e hershme. Në rast të çdo shkeljeje, legjislacioni i Republikës së Kosovës i jep fëmijës të drejtën për t'u mbrojtur nëpërmjet masave të cilat duhet t'i ndërmarrin institucionet publike, sektori privat dhe jo-qeveritar, si dhe e gjithë shoqëria, të cilat në çfarëdo mënyre vijnë në kontakt me fëmijën për shkak të ushtrimit të profesionit të tyre, apo rrethanave tjera kanë dyshime në lidhje me ndonjë rast të mundshëm të abuzimit, neglizhimit ose keqtrajtimit të fëmijëve, menjëherë duhet të njoftohen urgjentisht organet kompetente që kanë për mandat mbrojtjen e fëmijëve.

Në këtë drejtim, martesat e hershme ndikojnë drejtpërdrejt në cenimin e të drejtave të fëmijës për mbrojtje nga shfrytëzimi dhe abuzimi, e edhe në mbrojtjen nga detyrimi për të kryer punë me rrezik të mundshëm

<sup>56</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>

dhe që ka të ngjarë të rrezikojë edukimin e fëmijës, ose të jetë e dëmshme për shëndetin mendor dhe fizik të fëmijës, si dhe ndalohen të gjitha ato punë që e pengojnë zhvillimin mendor, shpirtëror, moral ose social të fëmijës.

Sipas Ligjit për Familjen, njëri ndër kushtet për lidhjen e martesës është që personi të ketë minimum tetëmbëdhjetë (18) vjet. Përfundimisht, gjykata mund të lejojë të miturin që ka mbushur moshën 16 vjeç të lidhë martesë nëse personi ka aftësitë e nevojshme fizike dhe psikike për t'i përmbushur të drejtat dhe detyrimet martesore.<sup>57</sup>

Ligji për Familjen i Kosovës parashikon gjithashtu se martesa nuk është e vlefshme nëse është lidhur në kundërshtim me vullnetin e bashkëshortëve, në cilëndo prej formave (shtrëngim, lajthim, kanosje etj).<sup>58</sup>

Ndërsa në nenin 14, paragrafi 1, të Ligjit të Kosovës për Familjen, parashihet: *"Martesa është bashkësi e regjistruar ligjrisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes"*.

Bashkësia jashtëmartesore është bashkësi faktike e vazhdueshme, e ngjashme me martesën, e lidhur me shprehjen e lirë të vullnetit midis burrit dhe gruas, e cila për një kohë të gjatë nuk ka qenë e rregulluar me norma juridike, edhe pse ka pasur shumë elemente të martesës, nuk është konsideruar si martesë, por shpeshherë i ka paraprirë martesës.<sup>59</sup> Si element themelor i bashkëjetesës është jeta e përbashkët e bashkëshortëve në këtë bashkësi,<sup>60</sup> ku në nenin 4 të Ligjit për Familjen të Kosovës parashihet: *"Të gjithë personat gëzojnë trajtim të barabartë të të drejtave dhe detyrimeve të parapara me këtë Ligj"*.

Nga bashkësia jashtëmartesore lind familja faktike, e cila krijohet nga persona të cilët nuk janë të lidhur me martesë, megjithatë ajo i jep jetë një gjendje juridike të ligjshme, e cila në mjaft aspekte është e mbrojtur nga e drejta.<sup>61</sup>

Edhe Ligji për Familjen i Kosovës, e njeh bashkësinë jashtëmartesore, ku shprehimisht thuhet: *"Bashkësia faktike (Bashkësia jashtëmartesore) konsiderohet marrëdhënia faktike midis burrit dhe gruas që jetojnë në çifte, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmëri"*.<sup>62</sup>

Bashkësia jashtëmartesore si e tillë nuk lidhet para organit kompetent shtetëror dhe si e tillë ajo është vetëm bashkim faktik midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift.<sup>63</sup>

E metë kyç e bashkësisë jashtëmartesore është ajo që secili nga bashkëjetuesit në çdo moment është i lirë që ta bëjë zgjidhjen e tij/saj,<sup>64</sup> pa asnjë formalitet apo procedurë, gjë e cila ndikon negativisht edhe për vetë personat që gjenden në bashkëjetesë, e po ashtu edhe për fëmijët e lindur nga kjo lidhje.

<sup>57</sup> LFK, neni 16.

<sup>58</sup> LFK, neni 18.

<sup>59</sup> Podvorica. H. "E drejta familjare", Prishtinë, 2006, fq. 141

<sup>60</sup> Aliu., A & Gashi., H "E drejta familjare", Prishtinë, 2007, fq. 187

<sup>61</sup> Galgano. F, "E drejta Private", Luarasi, Tiranë, fq. 909

<sup>62</sup> Ligji për familjen i Kosovës, neni 39

<sup>63</sup> Për më tepër shih: Grup autorësh "E drejta familjare", Tiranë, 2006, fq. 118

<sup>64</sup> Galgano. F, "E drejta Private", Luarasi, Tiranë, fq. 909

Thelbi i jetesës së përbashkët në kuptim bashkëkohor të së drejtës familjare është realizimi bashkërisht nga bashkëshortët i të gjitha funksioneve të martesës.<sup>65</sup> Te jetesa e përbashkët e bashkëshortëve dallon nga të jetuarit e bashkëshortëve në të njëjtën banesë, gjë e cila nënkupton se ata duhet t'i kryejnë të gjitha funksionet e martesës, por në rastin konkret martesat e hershme të fëmijëve nuk arrijnë t'i kryejnë të gjitha detyrimet që lindin qoftë nga martesë apo bashkësi faktike jashtëmartesore.

Bashkësi jashtëmartesore është bashkëjetesa e vazhdueshme midis burrit dhe gruas e bazuar mbi një marrëdhënie efektive reciproke, pa qenë të detyruar juridikisht ndaj njëri tjetrit, gjë e cila e hasim te martesë.<sup>66</sup> Edhe kjo krijon një problem në vete, pasi që fëmijët që jetojnë në bashkësinë faktike jashtëmartesore janë të cenuar, për faktin se për një mosmarrëveshje tejet të vogël, kjo bashkësi mund të shpëputet pa asnjë procedurë, gjë e cila nuk ndodh te martesë, pasi që aty kërkohet respektim i procedurës edhe me rastin e lidhjes së martesës, e sidomos në rastet e shkurorëzimit.

*Kushtet për lidhjen e martesës, si dhe për themelimin e bashkësisë faktike jashtëmartesore janë elemente me ngarkesë pozitive, pra ato duhet të përmbushen nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm.<sup>67</sup> Si kushte thelbësore për lidhjen e martesës në të drejtën martesore bashkëkohore, janë ato të cilat parashihen taksativisht me ligj,<sup>68</sup> mosplotësimi i të cilave e bën martesën të pavlefshme. Kushtet për lidhjen e martesës janë:*

- a) Shprehja e vullnetit të lirë të bashkëshortëve të ardhshëm, e cila nënkupton se bashkëshortët janë të lirë nga çfarëdo presioni për lidhjen e martesës, me përjashtim të pengesave dhe ndalesave martesore;
- b) Sekset e kundërta, nënkupton se martesë mund të lidhet dhe ka kuptim vetëm nëse ajo lidhet midis dy personave me sekse të kundërta, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të arrihen qëllimet e martesës;
- c) Lidhja e martesës para organit kompetent shtetëror dhe sipas formës së paraparë me ligj, nënkupton se të gjitha martesat duhet patjetër të lidhen para organit kompetent të autorizuar për këtë çështje, në formën e parashikuar me ligj;
- d) Mosha madhore;
- e) Shëndeti mendor (zotësia e veprimit).<sup>69</sup>

**Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi** (në tekstin e mëtejshëm LMD), si dhe pjesa tjetër e ligjeve nuk përmbajnë ndonjë dispozitë specifike në lidhje me gjendjen e vajzave dhe grave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, e as në lidhje me martesat e hershme. Në proceset integruuese në BE dhe Këshillin e Evropës, Republika e Kosovës është në fazën e përafrimit, ndërsa pastaj duhet të bëjë harmonizimin e plotë të dispozitave të brendshme, në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, ku edhe konsiderojmë se përkufizimi i diskriminimit të shumëfishtë në LMD përfaqëson çdo akt diskriminimi bazuar në dy ose më shumë forma të diskriminimi.

Një nga instrumentet ligjore për zbatimin e dispozitave lidhur me ndalimin e diskriminimit të cilat gjenden në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e po ashtu edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare, është edhe LMD. Ky ligj është pjesë e pakos së rëndësishme ligjore për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës, me theks të veçantë mbrojtjen nga diskriminimi.

<sup>65</sup> Për më tepër shih: Grup autorësh "E drejta familjare", Tiranë, 2006, fq. 248

<sup>66</sup> Galgano, F., "E drejta Private", Luarasi, Tiranë, fq. 907

<sup>67</sup> Grup autorësh "E drejta familjare", Tiranë, 2006, fq. 93

<sup>68</sup> Ligji për familjen i Kosovës, neni 16.

<sup>69</sup> Galgano, F., "E drejta Private", Luarasi, Tiranë, 1999, fq. 919

LMD rregullon fushën e mbrojtjes nga diskriminimi direkt dhe indirekt në përgjithësi. Për më tepër, mosdiskriminimi është edhe njëra nga vlerat kushtetuese në të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës.<sup>70</sup> Neni 24 i Kushtetutës garanton të drejtën që secili të gëzojë të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Për më tepër, ky nen përcakton se: *“Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”*<sup>71</sup>

Edhe Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, e zbatueshme drejtpërdrejt në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës<sup>72</sup>, në nenin e saj 14 po ashtu përmban dispozita lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi, ku përcaktohet se: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*<sup>73</sup>

Një nga instrumentet ligjore për zbatimin e këtyre dispozitave kushtetuese, si nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e po ashtu edhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare, është edhe Ligji Nr. 05/L-021 për mbrojtje nga diskriminimi. Ky ligj është pjesë e pakos së rëndësishme ligjore për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës, me theks të veçantë mbrojtjen nga diskriminimi.

Siç përcaktohet në nenin 1 të tij, *“Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë”*.

Marrë parasysh rëndësinë që ka ky ligj në sigurimin e trajtimit të barabartë para ligjit dhe mosdiskriminimin, ekzistojnë sfida dhe vështirësi të mëdha në zbatimin e këtij ligji, me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimin, duke përfshirë edhe martesat e hershme, andaj do duhej që kjo gjendje të ndryshojë duke ndërmarrë hapat e nevojshëm për të fuqizuar zbatimin e tij.

Martesat e hershme të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, rrezikojnë jetën, shëndetin dhe perspektivën e kategorisë së fëmijëve që qëndrojnë në pozitë të pabarazisë në raport me shumicën e qytetarëve për shkak të dallimeve identitare me shumicën, ose përballet me një sjellje refuzimi dhe marginalizimi.

**Kodi Penal i Republikës së Kosovës** përcakton se është vepër penale që një person madhor të jetojë në bashkësi faktike jashtëmartesore, e natyrisht edhe në martesë të zakonshme, me një të fëmijë apo të

<sup>70</sup> Shih nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e qasur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702> më 27.04.2023.

<sup>71</sup> Po aty, neni 24.

<sup>72</sup> Po aty, neni 22 parag. 2. Pjesë e nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në të cilën zbatohen drejtpërdrejt konventat dhe instrumentet e caktuara ndërkombëtare janë edhe Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas.

<sup>73</sup> Neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, e qasur në [https://www.echr.coe.int/documents/convention\\_sqi.pdf](https://www.echr.coe.int/documents/convention_sqi.pdf).

mitur.<sup>74</sup> Megjithatë, në praktikë hasen probleme jashtëzakonisht të mëdha për rastet që paraqiten kur ekzistojnë martesë të fëmijëve, të cilët në masë shumë më të madhe i përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në shumicën e rasteve, vetëm njëri prej bashkëshortëve, në rastin konkret vajza, është nën moshën 18 vjet.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, termi “fëmijë” nënkupton personin i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç,<sup>75</sup> ndërsa termi “i mitur” nënkupton personin i cili është midis moshës katërmëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet.<sup>76</sup>

*Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës ekziston një Kapitull i veçantë (XX) ku përshkruhen veprat penale kundër integritetit seksual, si:*

- Dhunimi - neni 227;
- Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit - neni 228;
- Sulmi seksual - neni 229;
- Degradimi i integritetit seksual - neni 230;
- Ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën 16 vjet - neni 231;
- Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi - neni 232;
- Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës - neni 233;
- Mundësimi ose detyrimi në prostitucion - neni 234;
- Ofrimi i lokaleve për prostitucion - neni 235 dhe
- Marrëdhëniet seksuale brenda familjes - neni 236.

Me vetë faktin se Kodi Penal i kushton një kapitull të veçantë, me disa nene, çështjes së integritetit seksual, flet më së miri se gjykata ofron mbrojtje të integritetit seksual të çdo individi, pasi që jeta seksuale e çdo personi është e paprekshme, si dhe çdokush vendos vetë dhe në mënyrë të lirshme se kur dhe me kë do të ketë marrëdhënie seksuale, ashtu që çdo veprim i dhunshëm që një person të ketë marrëdhënie seksuale me një person tjetër konsiderohet veprë penale, duke i dhënë mbrojtje të posaçme viktimave fëmijë të dhunës seksuale, ku edhe janë përcaktuar format kualifikuese dhe dënime më të ashpra, varësisht nga mosha e fëmijës. Nga përgjegjësia penale nuk përjashtohen as individët që shtytin apo nxisin këto lloj veprash penale, përfshirë edhe prindërit dhe familjarët e viktimave fëmijë.

**Kodi i Drejtësisë për të Mitur** (në tekstin e mëtejshëm KDM), akti më i rëndësishëm juridik i fushës së drejtësisë penale për të mitur, ku **në nenin 108** është përcaktuar kapitulli për mbrojtjen e fëmijëve viktimë të veprës penale, parasheh kompetencën lëndore si dhe rendit veprat penale që kryhen nga madhorët ndaj fëmijëve, e që ndër tjera përfshin edhe veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijës viktimë.

**Gjatë zhvillimit të procedurës, fëmija viktimë apo dëshmitar ka nevojë për kujdes të posaçëm**, duhet të mbizotërojë interesi i tij më i lartë, të trajtohet pa diskriminim, të respektohet dinjteti i tij, të trajtohet në ambiente dhe mënyrë miqësore duke ia plotësuar nevojat lidhur me moshën, rrethanat familjare, aftësitë dhe rrethanat e tjera, me qëllim që të mos i ndjejë pasojat e veprës penale.

<sup>74</sup> Shih kapitullin XX, Veprat Penale kundër integritetit seksual, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në dispozicion te: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>

<sup>75</sup> Neni 113, paragrafi 22 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në dispozicion te: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>

<sup>76</sup> Po aty, neni 113, paragrafi 23.

Në KDM është përcaktuar që në rastet kur zbatohet procedurë për veprë penale të kryer ndaj fëmijës, ***institucionet vepronë me kujdes të posaçëm ndaj fëmijës i cili ka pësuar dëmtime nga vepra penale.*** Duke marrë për bazë pasojat që shkaktohen tek fëmija viktimë e dhunës seksuale, është shumë me rëndësi edhe ***ruajtja e konfidencialitetit*** lidhur me detajet dhe rrethanat e rastit konkret, me qëllim që viktimë, gjatë fazës pas kryerjes së veprës penale dhe fazës së rehabilitimit të saj në jetën e përditshme dhe në shoqëri, të mos pësojë shpërndarje të informacionit rreth rastit të ndodhur, ashtu që viktimë të mos i kujtojë rrethanat e ngjarjes. Për këtë arsye, në nenin 115 të KDM-së parashihet fshehtësia e informacionit, ku theksohet se përveç mbrojtjes ekzistuese ligjore për jetën private të fëmijëve viktimë apo dëshmitarë, me përjashtim të paragrafit 3 të nenit 12 të këtij kapitulli, të gjithë personat që punojnë me fëmijën viktimë apo dëshmitar, duhet të mbajnë të fshehtë gjithë informacionin për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, që mund ta kenë marrë gjatë kryerjes së detyrës së tyre.

Në lidhje me rastet kur kemi të bëjmë me veprat penale kundër integritetit seksual, e specifikisht tek martesat e hershme, ***zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore*** shpeshherë paraqitet si sfidë për gjyqtarët dhe prokurorët si dhe për profesionistë tjerë që punojnë me fëmijën dhe për fëmijën. Prandaj është shumë e rëndësishme që aplikimi i dispozitave ligjore të KDM-së, lidhur me ***marrjen e deklaratës së viktimës jo më shumë se dy herë gjatë zhvillimit të procedurës penale***, sqarimi apo interpretimi i dispozitave ligjore lidhur me (mos)dhënien e pëlqimit nga fëmija lidhur me veprimet e të pandehurit në drejtim të fëmijës, pastaj gjatë zhvillimit të procedurës, prezenca e personave që duhet të jenë të pranishëm gjatë marrjes së deklaratës, përmirësimi i bashkëveprimit dhe koordinimit institucional për siguri maksimale për viktimën gjatë gjithë procesit ligjor, zhvillimi i njohurive në zbatimin e protokollit shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale nga të gjithë profesionistët pjesëmarrës. Po ashtu, duhet pasur parasysh, ashtu siç parashihet në nenin 227 të KPRK-së, ***forma themelore e veprës penale të dhunimit është përcaktuar në paragrafin 1, ku më pas në paragrafët në vijim janë përcaktuar edhe format kualifikuese, duke përfshirë edhe kategorinë kur kemi të bëjmë me viktimë të dhunës seksuale me aftësi të zvogëluar mendore, të përcaktuara në paragrafin 4 dhe nën-paragrafët vijues, duke paraparë edhe dënim më të lartë në krahasim me formën themelore të kryerjes së kësaj veprë penale.***

Gjithashtu, në nenin 117 të KDM-së, është përcaktuar roli i zyrës për mbrojtje dhe ndihmë viktimave, e cila ka për obligim që të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të viktimave në sistemin e drejtësisë.

■ Në procedurën penale, me qëllim të vërtetimit të fakteve relevante, ***varësisht nga rasti konkret, mund të angazhohen ekspertë të ndryshëm*** me kualifikime adekuate, varësisht nga nevoja për ekspertizë. Kur jemi tek vepra penale kundër integritetit seksual, apo vepra penale e dhunimit, është shumë me rëndësi momenti i kryerjes së veprës penale, respektivisht nevoja për të siguruar provat materiale nga vendi i ngjarjes në përgjithësi. Njëra ndër mënyrat kryesore të sigurimit të provës qenësore është ajo e ***ekzaminimit gjinekologjik të viktimës së dhunës seksuale***, gjithmonë me qëllim të sigurimit të kësaj prove.

Një çështje e rëndësishme të martesat e hershme është edhe fakti se sipas nenit 225 të KPRK-së, edhe nëse ekziston dhënia e pëlqimit, kjo është krejtësisht e parëndësishme, duke qenë se viktimë nuk ka aftësi psikike për ta dhënë pëlqimin për lidhjen e martesës, përkatësisht për kryerjen e marrëdhënieve seksuale. Në këtë kuptim, dispozita e nenit 226 ka përcaktuar si vijon:



***“Lajthimi lidhur me moshën e viktimës, e cila është nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, nuk është lajthim në fakt sipas nenit 25 të këtij Kodi, nëse kryesi me vetëdije ka qenë i pakujdesshëm në vënien e vetes në lajthim të tillë.”***

Në këtë drejtim, instituti i lajthimit në fakt lidhur me moshën e viktimës nuk vjen në shprehje kur kryerësi, me vetëdije, ka qenë i pakujdesshëm në vënien e vetes në një lajthim të tillë. Prandaj ajo që konsiderohet pakujdesi e të pandehurit lidhur me moshën e viktimës mund të nxirret nga rrethanat faktike, mënyra e sjelljes, kohëzgjatja e njohjes së viktimës me të pandehurin, komunikimet që ajo mund të ketë pasur, si dhe mënyra e të vepruarit të të pandehurit në raport me viktimën, etj.

***Fëmija si viktimë e veprës penale duhet të ketë përfaqësues të autorizuar në të gjitha fazat e procedurës penale***, në rast se nuk caktohet nga përfaqësuesi ligjor i fëmijës, atëherë përfaqësuesi i autorizuar duhet të caktohet sipas detyrës zyrtare. Kjo flet më së miri për paaftësinë për të ndërmarrë veprime të vlefshme juridike për shkak të miturisë, duke përfshirë edhe pamundësinë e lidhjes së martesës.

**Ligji për Evidencën Penale** ka përcaktuar që kryerësit e veprave penale kundër integritetit seksual të përfshihen në databazën përkatëse (Regjistri i dhunuesve seksualë të fëmijëve dhe Regjistri i ngacmuesve dhe dhunuesve seksualë), në përputhje me këtë ligj. Kjo siguron që pasojat e kryerjes së një veprë të tillë penale të bien drejtpërdrejt mbi kryerësin. Njëkohësisht, personat e tjerë do të jenë të vetëdijshëm se nëse kryejnë vepra të tilla, përveç dënimit, do të regjistrohen në këtë databazë, ku do të mbeten edhe pas vuajtjes së dënimit.



## IV. TRAJTIMI ME KUJDES I MARTESAVE TË HERSHME TË FËMIJËVE DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL PËR PARANDALIMIN E TYRE

Për të trajtuar rastet e martesave të hershme në mënyrë profesionale dhe të duhur, është thelbësore që institucionet përgjegjëse të kenë bashkëpunim të ngushtë dhe efikas që nga momenti i marrjes së informacionit ose paraqitjes së rastit të martesës së hershme. Ky bashkëpunim është i domosdoshëm jo vetëm për të garantuar trajtim dinjitoz të fëmijës që është viktimë e martesës së hershme, por edhe për t'i ofruar asaj mbështetje psikologjike dhe emocionale. Martesat e hershme të fëmijëve konsiderohen edhe ushtrim i dhunës seksuale, për shkak të moshës së tyre të re, andaj atyre duhet t'iu krijohet një ambient ku ata ndjejnë siguri dhe përkrahje institucionale, të ketë një mjedis miqësor dhe të qetë që inkurajon për të dëshmuar pa frikë se cilat kanë qenë arsyet reale për martesë të hershme.

Bashkëpunimi ndërinstitutional përfshin të gjitha hallkat e sistemit, duke filluar nga organet policore në fazën fillestare, duke vazhduar me zhvillimin e hetimeve në prokurori dhe shqyrtimin gjyqësor në gjykatë, në procedurë penale, ndërsa për të pasur sukses në zbulimin e tyre, nevojitet të ketë bashkëpunim edhe me sistemin e arsimit, sistemin shëndetësor, shërbimet sociale dhe familjare, mbrojtësit e viktimave dhe profesionistët tjerë. Një rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet edhe masave të trajtimit mjekësor dhe psikologjik të viktimës, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e saj në shoqëri, gjë e cila ndodh fare pak në Kosovë. Të gjitha këto procedura duhet të zhvillohen në përputhje me parimet e drejtësisë miqësore për fëmijët dhe të drejtave të tyre në proceset gjyqësore dhe administrative, duke respektuar standardet që garantojnë interesin më të mirë të fëmijës, i garantuar me aktet juridike në fuqi në Kosovë.

Në trajtimin e fëmijëve viktimë të dhunës seksuale dhe martesave të hershme, institucionet duhet të veprojnë me kujdes të veçantë për shkak të ndjeshmërisë së moshës së tyre dhe ndikimit të madh psikologjik dhe emocional që sjellin këto vepra penale. Për këtë arsye, sistemi juridik dhe procedura që zhvillohet duhet të sigurojë mbrojtje të plotë për fëmijën dhe shmangien e çdo lloj ri-viktimizimi.

Gjithashtu, në përputhje me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, fëmija viktimë ka të drejtë të mbështetet nga Qendra për Punë Sociale (QPS), nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse nga zyrtarët përgjegjës, në të gjitha procedurat, duke komunikuar vazhdimisht me viktimën dhe duke ndihmuar kështu në parandalimin e ushtrimit të dhunës apo ri-viktimizimit.

Në literaturën juridike, viktimizimi i fëmijës nga vepra penale konsiderohet si viktimizim primar, ndërsa gjatë procedurës, për shkak të përjetimeve të rënda, mund të ndodhë edhe viktimizimi sekondar. Për këtë arsye, ligjvënësi ka përcaktuar standarde evropiane për zhvillimin e procedurës, duke synuar shmangien e ri-viktimizimit dhe për këtë arsye edhe intervistimi i shumëfishtë për të njëjtën çështje i një fëmije është i ndaluar me KDM. Kjo përfshin marrjen e deklaratës së viktimës me ndihmën e një psikologu dhe kufizimin e numrit të marrjeve të dëshmive në maksimum dy herë, për të mbrojtur mirëqenien e fëmijës.

## V. ROLI I MEDIAVE PËR MARTESAT E HERSHME

**M**ediat në çdo shoqëri demokratike kanë rol të jashtëzakonshëm dhe mediat shërbejnë si kujdestare të raportimit të dukurive negative. Në këtë aspekt, edhe Ligji për mbrojtjen e fëmijëve, në nenin 45, ka disa dispozita që trajtojnë rolin e mediave dhe kufizimet që ato kanë në rastet e raportimeve, kur janë në pyetje fëmijët, ndërsa ky ligj nuk ka asnjë dispozitë që i referohet martesave të hershme.<sup>77</sup> Mediat na mësojnë se kush janë bashkëqytetarët tanë etnikë romë, ashkali dhe egjiptian, çfarë bëjnë, ku janë, sa janë, si janë, pse janë të tillë dhe çfarë i përcakton ata si komunitete në Republikën e Kosovës. Pse? Kjo për faktin se shkollat dhe institucionet kulturore në Republikën e Kosovës e kanë lënë këtë hapësirë të patrajtuar e të paprekur sa duhet.

Çështja e martesave të hershme, sidomos në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian nuk është trajtuar as në media sa duhet, ato janë trajtuar në kronika të shkurtra, apo vetëm kur janë shpërfaqur në publik informata për martesat e hershme nga rrjetet e ndryshme sociale dhe postimet e caktuara, por jo që është bërë ndonjë seri emisionesh lidhur me këtë problematikë.

Rëndësia e medias në përballjen me fenomenin e martesave të hershme është e jashtëzakonshme, duke marrë parasysh mënyrën se si raporton për situata të caktuara të martesës së hershme ose mbi iniciativat qeveritare lidhur me martesat e hershme në disa komunitete tradicionale për këtë fenomen, siç janë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Vlen të përmendet se prania e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në media nuk është e papërfillshme, pasi që në televizionin publik ka edhe disa minuta transmetim në gjuhën rome, por temat lidhur me martesat e hershme dhe parandalimin e tyre mungojnë përgjithësisht. E vetmja temë e përbashkët e të gjitha publikimeve është lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet përkatësisë etnike dhe kriminalitetit, gjë e cila nuk i kontribuon progresit.

Edhe pse kohët e fundit, media ka ofruar vëmendje dhe ka kontrolluar gjuhën e përdorur në prezantimin e lajmeve për të qenë sa më korrekt, ndërsa shoqëria civile e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian është përpjekur të zhvillojë një komunikim sa më efikas me shtypin, nëpërmjet programeve të ndryshme, por ende dëgjojmë apo lexojmë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian: "fëmijët ...", "gratë ..." që "nuk punojnë, por vetëm kanë fëmijë" në "lagjet e ...", "Arrestohet i mituri i komunitetit rom për vjedhje në shkollë në ..." <sup>78</sup> etj.

<sup>77</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

<sup>78</sup> Mjafton të futemi në google dhe gjejmë me dhjetra raste të raportimit të portaleve dhe mediave të ndryshme të rasteve ku specifikohen këto komunikime.

Në shumicën e rasteve, martesat e hershme u imponojnë vajzave humbje të gëzimit të të drejtave themelore si liria e zgjedhjes, liria e shprehjes, e drejta për zhvillim harmonik fizik dhe mendor, për formim arsimor e profesional etj., e ky aspekt është kapur shpesh nga mediat.

Martestat midis fëmijëve përfaqësojnë një fenomen mbi të cilin autoritetet shtetërore humbin kontrollin e kësaj situate, gjë që është kaotike për fëmijët që gjinden në këtë situate tejet të rëndë.

Publikimi i dasmave të fëmijëve nëpër rrjetet sociale duhet të shërbejë si kampion alarmi për ndalimin e tyre, si dhe ndërhyrjen urgjente ashtu që vajza të largohet nga shtëpia ku është martuar dhe të kthehet menjëherë në familjen e saj biologjike, nëse ka kushte, në të kundërtën të gjendet mundësi e strehimit adekuat nga ana e organeve kompetente. Kjo ndërhyrje e shtetit mund të konsiderohet edhe si shqetësim nga ana e familjes, si dhe si formë presioni dhe njëra nga format radikale të ndërhyrjes nga autoritetet shtetërore, në veprim e zbatim të legjislacionit në fuqi, paralelisht me programet dhe politikat e mbrojtjes së kësaj kategorie të fëmijëve.

Duke pasur parasysh faktin se Kosova është në fazën e proceseve integruuese në BE dhe KiE, secili nga institucionet, mekanizmat qeveritarë e jo-qeveritarë, si dhe qytetarët në përgjithësi, duhet të përpiqen të ndryshojnë këtë mentalitet, këto tradita, së pari sepse shkelim ligjin.

Mediat mund të konsiderohen “armik” i dasmave të hershme. Për më tepër, ka raste, por që nuk deklarohen, kur nusja dhe dhëndri janë edhe kushërinj të shkallës së afërt të gjinisë së gjakut, pas gjyshërve të tyre. Këto raste mund të krijojnë probleme serioze shëndetësore në të ardhmen.

Duhet pasur kujdes edhe në përdorimin e një gjuhe neutrale, të ekuilibruar dhe jodiskriminuese në informimin e opinionit publik për parandalimin e martesave të hershme, duke shmangur kështu promovimin e stereotipave negativë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Informacioni i shpërndarë nëpërmjet medias duhet të respektojë mundësitë dhe trajtimin e barabartë për gratë dhe burrat, si dhe nuk duhet të përmbajë, promovojë e as provokojë asnjë formë diskriminimi, duke shmangur perceptimet dhe qëndrimet raciste.

Megjithatë, përsa i përket debateve në media për martesat e hershme në familjet e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, duhet intensifikuar debate të tilla dhe pjesëmarrjen pozitive, si dhe në mënyrë të konsiderueshme në hapjen dhe mbështetjen e tyre, gjë që nënkupton hapje drejt një shoqërie ndërkulturore, ku mbetet nevoja për një përpjekje të vazhdueshme të njohjes dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.

Nevoja për mirëkuptim midis komuniteteve mbetet sfidë e vazhdueshme për shoqërinë kosovare. Eliminimi i paragjyqimeve dhe perceptimeve raciste kërkon një qasje më të drejtë ndaj kulturës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, duke vlerësuar kontributin e tyre në shoqëri. Media ka rol thelbësor në ngritjen e vetëdijes mbi martesat e hershme dhe pasojat e tyre, duke ofruar informacione të sakta dhe argumente të fuqishme për ndryshimin e mentalitetit.

## VI. RASTE STUDI MI NGA HULUMTIMET NË TEREN DHE TË DHËNA STATISTIKORE LIDHUR ME FENOMENIN E MARTESAVE TË HERSHME

Ky hulumtim paraqet disa raste studimore për të ilustruar format e ndryshme të martesave në komunitetet Rom, ashkali dhe egjiptian, duke reflektuar edhe diversitetin brenda këtyre grupeve. Në të gjitha rastet, është evidentuar se familjet e përfshira përballen me vështirësi ekonomike.

Aspekti ekonomik është qendror dhe vazhdon të dominojë si shkak i lidhjes së martesave të hershme, i përcjellë edhe me ndalimin e vijimit të shkollës në rastin e vajzave, si dhe virgjërinë që përsëritet si motiv qendror në të gjitha llojet e martesave.

Një faktor tjetër thelbësor që ndikon në lidhjen e martesave të hershme është edhe mungesa e qasjes në informata të mirëfillta dhe të besueshme mbi të drejtat e fëmijëve në përgjithësi dhe për të drejtat e vajzave dhe grave të këtyre komuniteteve në veçanti. Nga hulumtimet e realizuara në teren, shihet se në të shumtën e rasteve, vajzat e reja nuk janë të informuara sa duhet për opsionet që kanë për të ndërtuar jetë të pavarur. Për më tepër, institucionet shtetërore shpesh nuk arrijnë të ndërhyjnë në mënyrë efektive tek këto komunitete për të parandaluar martesat e hershme, për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme dhe të trajnuara mirë për luftimin e këtyre fenomeneve.

Edhe pse deklaratat e fëmijëve në lidhje me vendimin për t'u martuar, si dhe dëshira për të festuar martesën e tyre u përket ekskluzivisht atyre, Policia dhe Prokuroria gjithmonë janë të obliguara me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale që të kryejnë hetime për rastin. Në shumicën e rasteve, te martesat e hershme, mashkulli është në moshë madhore dhe i njëjti konsiderohet të ketë kryer veprën penale të marrëdhënies seksuale me një të mitur, e për këtë duhet të zhvillohen hetime për të vërtetuar nëse ka elemente të veprës penale të dhunimit, apo veprave tjera penale. Këtu vjen në shprehje edhe nevoja që vajza t'i nënshtrohet një ekzaminimi në Institutin e Mjekësisë Ligjore për të vërtetuar nëse ka kryer marrëdhënie seksuale me të.

Bazuar në të dhënat e hulumtimit në teren, identifikohen mangësi në reagimin e autoriteteve publike në parandalim dhe ndalim të martesave të hershme. Këtu kemi të bëjmë me ndërhyrje të vonuar e zbatim të dobët të ligjit në përputhje me rrethanat, në rastin e martesës së hershme. Në këtë aspekt nuk janë identifikuar e as zbatuar masat më të përshtatshme për t'iu qasur fenomenit të martesave të fëmijëve nga ana e autoriteteve.

Nevoja për të ndryshuar gjendjen që cenon të drejtat themelore të fëmijëve është emergjente. Në këtë drejtim puna me fëmijët, e sidomos për gratë dhe vajzat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është thelbësore. Ky aspekt ka të bëjë me orientimin e fëmijëve në drejtime tjera që avancojnë njohuritë e tyre përmes shkollimit dhe rëndësinë e ngritjes së tyre graduale në karrierën e tyre profesionale, duke shmangur martesat e hershme.

Familjet e të rinjve duhet të respektojnë vendimet e autoriteteve (Qendra për Punë Sociale, Prokuroria, si dhe Gjykata) për ndarjen e të rinjve, për shkak se kjo është në interesin e dy fëmijëve, që të kenë paqen e nevojshme kundrejt çdo presioni apo përpjekjeje për ta shndërruar në ngjarje tradicionale për grupin etnik të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

■ Ulja e moshës së fëmijëve në martesë, sjell uljen e moshës së vajzave në shtatzëninë e parë. Rënia e moshës së fëmijëve të bashkuar në martesë lidhura nga prindërit e tyre, pa pasur të dhëna në këtë drejtim, vjen si pasojë e frikës së prindërve të vajzave rrom për uljen e numrit të djemve dhe mbetjen e vajzave pa u martuar. Situatat e vajzave në të cilat hasen edhe kompensime financiare për martesë nuk janë përmendur, ndërsa njerëzit hezitojnë të flasin për këtë fenomen, por nga bisedat vihet re dëshira e prindërve për të krijuar pasuri dhe mirëqenie më të mirë për familjen, duke mos përjashtuar edhe këto forma të rënda të shkeljes së të drejtave të fëmijëve.

Interesimi i opinionit publik për rastet e martesave të hershme zakonisht nxitet nga mediat kur vajzat sillen në maternitet për të lindur. Menjëherë duhet të vihen në lëvizje organet e hetuesisë për të zbuluar situatat e vajzave të martuara, e që në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, në disa raste, martesë e fëmijëve trajtohet si mënyrë normale e jetesës.

Një rol jashtëzakonisht me rëndësi në parandalimin e martesave të hershme luan edhe Qendra për Punë Sociale, e cila aktivitetin e saj e ushtron në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në rrezik ose të përfshirë në martesat e hershme.

Autoritetet publike, sipas kompetencave ligjore, janë të detyruara të ushtrojnë kontroll efektiv dhe të përbashkët mbi mënyrën se si prindërit përmbushin detyrimet e tyre në lidhje me fëmijën e tyre. Kjo përfshin edhe kujdesin nëse shëndeti fizik ose zhvillimi i fëmijës rrezikohet nga mosushtrimi, apo ushtrimi jo i duhur i të drejtave prindërore, nga sjelljet abuzive ose nga neglizhenca e rëndë në përmbushjen e detyrave prindërore, apo nëse edukimi, formimi profesional dhe përgatitja e fëmijës nuk bëhet në frymën që është në interesin më të mirë të fëmijës, ku me vendim të gjykatës, pas kërkesës së organit të kujdestarisë, do të kufizonte apo hiqte fare të drejtën prindërore.

Ka raste të shpeshta, ku shihet me fakte të pakontestueshme, që kanë qenë edhe mediale në Kosovë, ku është bërë e dukshme mungesa e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve për marrjen e masave të përbashkëta e koherente.<sup>79</sup> Megjithatë në rastin e martesave të hershme në familjet e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, ka një sfond kompleks (që thirret në tradita) dhe një mungesë të rëndësishme të dhënash për fenomenin, pengesat në identifikimin dhe zbatimin e zgjidhjeve më efektive shkaktohen edhe nga komunikimi i vështirë dhe mungesa e bashkëpunimit të mirëfilltë ndërmjet autoriteteve kompetente.

<sup>79</sup> <https://betimiperdrejttesi.com/rasti-i-dhunimit-te-11-vjecares-dosja-e-prokurorise-ndaj-kater-te-dyshuarve-per-rastin-e-ndodhur-nje-muaj-me-pare/>, qasur me datën 04.04.2025.

Kalimi në një fazë tjetër të respektimit të të drejtave të fëmijës, me eliminimin e martesave të hershme, nuk mund të ndodhë në Kosovë mbase edhe për shkak të mungesës të zbatimit të sanksioneve ndaj prindërve që martojnë fëmijët e tyre në moshën madhore. Gjithashtu, edhe mungesa e shembujve të familjeve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian që refuzojnë publikisht të fejojnë fëmijët e tyre në moshë të re është një tjetër element që inkurajon vazhdimësinë e kësaj praktike në Kosovë.

Rezistenca e popullatës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë lidhur me martesat e hershme, dhe jo vetëm, kufizon të drejtat individuale (për lirinë e zgjedhjes, për lirinë e shprehjes, për zhvillimin arsimor, etj.) të fëmijëve të martuar në këto rrethana nga prindërit e tyre. Shteti që ndalon martesat e hershme në komunitetet tradicionale romë nuk nënkupton privimin e së drejtës për të pasur jetën kulturore, siç argumentohet nga disa anëtarë të familjeve të këtyre komuniteteve, por vetëm imponon respektimin e të drejtave (individuale) të fëmijëve dhe të rinjve në këto komunitete.

Në Republikën e Kosovës ka tregues që tregojnë ekzistencën e traditës patriarkale dhe pasojat e saj, ku shumë gra, duke përfshirë gratë dhe vajzat e komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, fatkeqësisht nuk gëzojnë respekt të plotë për lirinë e tyre për të zgjedhur në çështjet që kanë të bëjnë me vendimet themelore për jetën e tyre, ndërsa aftësia e tyre për të ushtruar këto të drejta në mënyrë të pavarur kundërshtohet.

Raportet e mediave për shtatzënitë e hershme të vajzave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe lindjet e tyre duhet të mobilizojnë institucionet qendrore dhe lokale dhe organizatat e shoqërisë civile për të organizuar një sërë takimesh me synimin për të identifikuar masat konkrete dhe të menjëhershme (në përputhje me dispozitat të legjislacionit në fuqi dhe aktet juridike ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës dhe mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat) për të ndaluar fenomenin e rritjes së numrit të martesave të fëmijëve në përgjithësi, si dhe në pakicat romë, ashkali dhe egjiptianë në veçanti.

Sipas të dhënave të grumbulluara nga tereni, vlerësojmë se ka një numër më të madh të martesave të hershme që përfshijnë vajza më të reja se partnerët e tyre, sesa ato në të cilat vajzat janë në të njëjtën moshë me djemtë (partnerët).

Bashkësia faktike jashtëmartesore, e njohur si martesë e paligjshme, është marrëdhënie emocionale, fizike dhe intelektuale, që përfshin bashkëjetesën e partnerëve, por pa u lidhur sipas dispozitave ligjore. Ky bashkim konsensual pa karakter juridik të martesës është një formë alternative partneriteti, e cila përmbush funksionet dhe karakteristikat e një martese të plotë, pasi që qëllimi i bashkëjetesës është krijimi i familjes.

Martesa e hershme nënkupton jo vetëm një martesë me partnerin e saj, por edhe një përgjegjësi shtëpiake në shtëpinë ku ajo jeton, zakonisht në shtëpinë e vjehrrit të saj. Për më tepër, nevojat e vajzës së re, të mbuluara më parë nga prindërit e saj, transferohen te vjehri dhe bashkëshorti i saj. Edhe për sa i përket vendbanimit të saj ligjor pas martesës, vendbanimi zyrtar i vajzës vazhdon të jetë në adresën e prindërve të saj dhe jo në adresën ku ajo jeton realisht me bashkëshortin dhe familjen e tij, gjë e cila përbën një problem tjetër në vete.

Të drejtat riprodhuese janë të drejta themelore të të gjitha çifteve dhe individëve për të vendosur lirisht dhe me përgjegjësi numrin, hapësirën dhe kohën e fëmijëve të tyre, si dhe që të kenë informacionin dhe mjetet për ta bërë këtë, bashkë me të drejtën për të arritur standardin më të lartë seksual, shëndetësor dhe riprodhues. Në këtë drejtim, martesat e hershme, kanë ndikim të skajshëm negativ në shëndetin fizik dhe mendor, e ky fenomen ka edhe ndikim negativ edhe në varfërimin, braktisjen e shkollës, si dhe rrënjosjen e normave patriarkale. Shtatzënia e hershme mund të ketë pasoja të dëmshme për shëndetin riprodhues



të vajzave, por fatkeqësisht ka edhe raste kur prindërit e shohin martesën e fëmijëve të tyre si mekanizëm mbrojtës nga varfëria dhe për sigurinë e tyre sociale.

Rastet e paraqitura më sipër kanë për qëllim të shprehin diversitetin e fenomenit të martesave të hershme brenda komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, që haset në të gjitha këto komunitete.

## 1. Gjetjet kryesore nga hulumtimi sasior

Ky hulumtim synon të analizojë shtrirjen, shkaqet dhe ndikimet e martesave të hershme në Kosovë, duke siguruar një bazë empirike për rekomandime të bazuara në të dhëna dhe për të mbështetur zbatimin e masave konkrete dhe të informuara. Për këtë qëllim, UBO Consulting ka realizuar dy anketa sasiore me fëmijë dhe të rritur në 19 komuna të Kosovës me popullatë të madhe të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian: Deçan, Gjakovë, Gjiilan, Istog, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë, Lipjan, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Shtime, Suharekë, Ferizaj dhe Graçanicë.

*Një nga hapat më të rëndësishëm në këtë studim është modeli dhe madhësia e mostrës, pasi siguron saktësinë dhe përfaqësueshmërinë e informacionit të mbledhur. Për të dizajnuar mostrën janë ndjekur parimet e mëposhtme:*

- Mostra është projektuar për të përmbushur kërkesat kyçe të studimit dhe për të qenë përfaqësuese për popullatën e synuar.
- Është përdorur mostrim uniform rastësor brenda popullatës së shënjestruar.
- Korniza e mostrës është bazuar në të dhënat zyrtare për të pasqyruar madhësinë e popullsisë, shpërndarjen gjeografike dhe përfaqësimin gjinor, duke siguruar që rezultatet të jenë sa më gjithëpërfshirëse dhe të sakta.

Në total, janë realizuar 196 intervista ballë për ballë me fëmijë dhe 179 intervista me të rritur, duke përdorur një mostër të qytetarëve rom, ashkali dhe egjiptian të përzgjedhur në mënyrë rastësore në secilën prej 19 komunave të përfshira në studim. Mbledhja e të dhënave është realizuar përmes intervistave ballë për ballë “në shtëpi” duke përdorur teknikën CAPI (Computer-Assisted Personal Interviewing).

Korniza e mostrës për secilën komunë është bazuar në të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, duke siguruar shpërndarje të mirëfild të të anketuarve, si dhe një përfaqësim të saktë të komuniteteve të shënjestruara.

**TABELA 1.** Shpërndarja e mostrës për pyetëtorët me fëmijë dhe të rritur


| Nr.           | Komuna       | Pyetëtorë anonim me fëmijët (13-18 vjeç) | Pyetëtorë anonim me të rriturit (18-40 vjeç) |
|---------------|--------------|------------------------------------------|----------------------------------------------|
| 1             | Deçan        | 3                                        | 2                                            |
| 2             | Gjakovë      | 36                                       | 33                                           |
| 3             | Gjilan       | 2                                        | 2                                            |
| 4             | Istog        | 9                                        | 9                                            |
| 5             | Klinë        | 6                                        | 6                                            |
| 6             | Fushë Kosovë | 22                                       | 20                                           |
| 7             | Kamenicë     | 1                                        | 1                                            |
| 8             | Mitrovicë    | 7                                        | 6                                            |
| 9             | Lipjan       | 12                                       | 11                                           |
| 10            | Obiliq       | 7                                        | 6                                            |
| 11            | Rahovec      | 4                                        | 4                                            |
| 12            | Pejë         | 21                                       | 20                                           |
| 13            | Podujevë     | 4                                        | 4                                            |
| 14            | Prishtinë    | 3                                        | 3                                            |
| 15            | Prizren      | 25                                       | 22                                           |
| 16            | Shtime       | 4                                        | 4                                            |
| 17            | Suharekë     | 3                                        | 3                                            |
| 18            | Ferizaj      | 22                                       | 19                                           |
| 19            | Graçanicë    | 5                                        | 4                                            |
| <b>TOTALI</b> |              | <b>196</b>                               | <b>179</b>                                   |

### 1.1 Rezultatet e pyetëtorit me të mitur (13-18 vjeç)

Të dhënat në seksionet e mëposhtme përmbledhin rezultatet dhe perceptimet e pyetëtorit anonim të realizuar me 196 fëmijë të moshës 13 deri në 18 vjeç nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të shpërndarë në 19 komuna të Kosovës me popullsi më të lartë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Qëllimi i këtij hulumtimi është të kuptojë përvojat dhe qëndrimet e tyre ndaj martesave të hershme. Nga këta të anketuar, 57% janë djem dhe 43% vajza. Sa i përket vendbanimit, 42% e fëmijëve jetojnë në zonat urbane, ndërsa 58% në zonat rurale. Në aspektin etnik, pjesëmarrësit janë të ndarë si më poshtë: 34% janë nga komuniteti rom, 47% ashkali dhe 18% egjiptian. Mesatarisht, anëtarët e familjeve të këtyre të miturve janë 7 persona. Këto të dhëna ofrojnë pasqyrë të qartë të përbërjes dhe të kushteve të jetesës së komuniteteve në fjalë, të cilat janë thelbësore për të kuptuar kontekstin e martesave të hershme.


Në kuadër të studimit mbi martesat e hershme në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, është analizuar edhe vijueshmëria në arsim. Qëllimi ishte të kuptohej më mirë fenomeni i ndërprerjes së shkollimit në mesin e grupeve të marginalizuara. Nga të anketuarit që kanë deklaruar se kanë ndërprerë arsimin (37% e pjesëmarrësve – shih Figura 1), është kërkuar informacion mbi nivelin arsimor në të cilin ka ndodhur

ndërprerja. Rezultatet tregojnë se 59% e kanë ndërprerë shkollimin gjatë arsimit fillor, 40% gjatë arsimit të mesëm të ulët dhe vetëm 1% gjatë arsimit të mesëm të lartë. Këto të dhëna pasqyrojnë sfidat me të cilat përballen këto komunitete dhe ndihmojnë në identifikimin e faktorëve që mund të kontribuojnë në prevalencën e martesave të hershme.



**FIGURA 1.** Cili është niveli i arsimimit që po ndiqni momentalisht?


Sa i përket arsyeve të ndërprerjes së arsimit, 55% e të anketuarve kanë thënë se mungesa e interesimit ka qenë faktori kryesor. Problemet financiare janë një tjetër arsye e shpeshtë me 34%, ndërsa 27% e të anketuarve kanë thënë se kanë pasur vështirësi në mësim. Problemet me nxënës të tjerë dhe problemet shëndetësore secili zënë 4%. Martesa dhe zhvendosja në një vend tjetër janë shfaqur si arsye me nga 3% (Shih Figurën 2). Në përgjithësi, këta faktorë ndikojnë në një cikël ku mungesa e arsimit dhe presionet sociale dhe ekonomike i shtojnë të rinjtë në martesë të hershme, duke krijuar barriera shtesë për zhvillimin personal dhe profesional në jetën e tyre. Identifikimi i këtyre lidhjeve ofron një bazë për ndërhyrjet politike dhe programet sociale që synojnë të përmirësojnë arsimin dhe të mbrojnë të drejtat e të rinjve në këto komunitete.



**FIGURA 2.** Cilat janë arsyet kryesore që keni ndërprerë shkollimin/ braktisur shkollën?


Në kuadër të studimit janë analizuar edhe faktorë shtesë që ndikojnë në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, përfshirë arsimin dhe qasjen në shërbime bazë. Rezultatet tregojnë se një pjesë e madhe, 90% e të anketuarve, mësojnë në klasa ku janë të pranishëm nxënës nga komunitete të ndryshme, duke sugjeruar një nivel të caktuar të integritetit social. Nga ana tjetër, 10% ndjekin mësimin në klasa të përbëra vetëm nga

nxënës të komunitetit të tyre, çka mund të ndikojë në ndjenjën e izolimit dhe të kufizojë mundësitë për ndërveprim më të gjerë shoqëror.



**FIGURA 3.** A je në klasë me nxënës vetëm nga komuniteti yt, apo mëson edhe me nxënës nga komunitete të tjera?

Në lidhje me qasjen në shërbimet bazë si uji, energjia elektrike dhe transporti, 79% e të anketuarve kanë qasje të plotë, 20% kanë qasje të pjesshme, ndërsa vetëm 1% raporton mungesë totale të qasjes. Kjo tregon se shumica e pjesëmarrësve kanë njëfarë qasjeje në nevojat bazë, megjithatë një pjesë e vogël përballet me mungesa që mund të ndikojnë në cilësinë e jetës dhe në vendimmarrje të rëndësishme, përfshirë martesat e hershme.




**FIGURA 4.** A keni qasje në shërbimet bazë (si ujë, energji elektrike, transport)?

## 1.2 Njohuri dhe qëndrime për martesën e hershme


Ky seksion shqyrton nivelin e njohurive dhe qëndrimeve të të anketuarve mbi martesën e hershme, duke përfshirë ndërgjegjësimin e tyre për moshën ligjore të martesës dhe pasojat ligjore të martesave nën moshën 18-vjeçare. Gjithashtu, analizohen perceptimet mbi ndikimin e martesave të hershme te të rinjtë, faktorët kryesorë që i nxisin ato dhe roli i arsimit në parandalimin e këtij fenomeni. Të dhënat ofrojnë një pasqyrë mbi burimet e informacionit të të anketuarve dhe përvojat e tyre lidhur me këtë çështje në komunitetin e tyre.

Fillimisht, të anketuarit u pyetën nëse janë në dijeni se cila është moshë e lejuar me ligj për lidhjen e martesave në Kosovë. Sipas të dhënave, 56% e tyre u shprehën se e dinë këtë informacion, përsëri një përqindje shumë e madhe (44%) deklaruan se nuk janë në dijeni. Më tej, ata që pohuan se janë në dijeni u pyetën për moshën specifike të lejuar dhe burimin e informacionit të tyre.




**FIGURA 5.** A jeni në dijeni se cila është moshë e lejuar me ligj për lidhjen e martesave në Kosovë?

Analizat e mëtejshme të dhënave, të ndara sipas demografive të ndryshme, tregojnë ndryshime të rëndësishme në nivelin e informimit në bazë të grupit etnik që i takojnë të miturit. Nga të anketuarit, 45% e pjesëtarëve të komunitetit Ashkali deklaruan se janë të njohur me këtë kufi ligjor, krahasuar me 60% të komunitetit Rom dhe 75% të komunitetit Egjiptian. Këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e promovimit të informacionit ligjor në komunitetet ku niveli i informimit është më i ulët, në mënyrë që të mbështetet parandalimi i martesave në moshë të hershme.



**FIGURA 6.** A jeni në dijeni se cila është moshë e lejuar me ligj për lidhjen e martesave në Kosovë? Ndarje në grupe etnike


Rezultatet e ndarjes sipas nivelit të arsimit tregojnë një lidhje të qartë mes arsimit dhe informimit lidhur me moshën ligjore për martesë. Nga ata që vijojnë mësimin fillor 29% ishin në dijeni të moshës ligjore për martesë, ndërsa 43% e atyre që janë shkollën e mesme të ultë, dhe 93% e atyre në shkollën e mesëm të lartë thanë se janë të informuar. Këto të dhëna sugjerojnë se ndërgjegjësimi mbi ligjin është më i lartë në nivelet më të larta të arsimit, duke vënë në dukje nevojën për përpjekje të përqendruara në grupet me arsimim të ulët për të parandaluar martesat e hershme.



**FIGURA 7.** A jeni në dijeni se cila është moshë e lejuar me ligj për lidhjen e martesave në Kosovë? Ndarje me nivelin e arsimit

Në studim u përfshi një pyetje shtesë për të vlerësuar nivelin e njohurive rreth moshës ligjore për martesë në Kosovë, duke i kërkuar pjesëmarrësve të thonë moshën që ata mendojnë se është e lejuar me ligj për lidhjen e martesës. Kjo qasje kishte për qëllim të vlerësonte në mënyrë indirekte nëse pjesëmarrësit ishin të informuar saktësisht, pasi njohuria e saktë është e rëndësishme për të parandaluar keqkuptimet që mund të çojnë në vendime të nxituara. Nga të anketuarit që deklaruan se ishin të informuar për moshën ligjore, 75% e të anketuarëve dhanë përgjigje të saktë, duke përmendur moshën 18 vjeç si moshën ligjore. Megjithatë, kishte edhe një përqindje të konsiderueshme, 10%, që mendonin se moshë ligjore është 20 vjeç dhe 5% e të anketuarve thanë se është 22 vjeç. Gjithashtu, 4% e të anketuarve mendonin se moshë ligjore është 21 vjeç, dhe 2% e përgjigjeve ishin për moshën 17 vjeç.


Sipas Ligjit të Familjes së Kosovës (Ligji Nr. 2004/32), moshë minimale e lejuar për lidhjen e martesës është 18 vjeç, përveç disa përjashtimeve me miratimin e gjykatave kompetente.<sup>80</sup> Këto të dhëna tregojnë se, ndonëse shumica e të anketuarve që deklaruan se janë të informuar kanë njohuri të sakta, ende ka një përqindje të konsiderueshme që kanë informacione të pasakta ose të mangëta rreth kësaj çështjeje ligjore.



**FIGURA 8.** Shkruani moshën e lejuar me ligj për lidhjen e martesave në Kosovë (Shëno moshën në vite)

<sup>80</sup> LIGJI NR. 2004/32 LIGJI PËR FAMILJEN I KOSOVËS, në dispozicion: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2410>.

Për më tepër, të tregojnë burimet e informacionit që përdorin për moshën e lejuar për martesë në Kosovë, ku kishin mundësi të zgjidhnin disa opsione. Shumica (78%) thanë se janë informuar nga familja, ndërsa 55% thanë se janë informuar nga shkolla. Rreth 42% deklaruan se janë informuar nga shoqëria dhe miqtë, dhe 21% nga mediat si televizioni, radio dhe rrjetet sociale. Një përqindje më e vogël (6%) thanë se janë informuar nga organizata të ndryshme joqeveritare.



**FIGURA 9.** Kush ju ka informuar për moshën e lejuar me ligj për lidhjen e martesave? (Mund të zgjidhni më shumë se një opsion – me rotacion)

Në vijim të anketimit me të rinjtë nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, të moshës 13-18 vjeç, u bë një pyetje për të kuptuar nëse ata ishin të informuar se martesa nën moshën 18 vjeçare është e paligjshme dhe përbën vepër penale. Rezultatet e paraqitura në grafikun poshtë (Figura 10) tregojnë se një pjesë e madhe e të anketuarve, 57%, nuk ishin në dijeni të kësaj ligji, ndërsa 43% e dinin.




**FIGURA 10.** A jeni në dijeni që martesa nën moshën 18 vjeçare është e paligjshme, përbën vepër penale dhe mund të ndëshkohet, për personat madhorë që martohen me të mitur nën moshën madhore (18-vjeçare), pa leje të gjykatës?

Nga analiza e mëtejshme e të dhënave, të ndara sipas grupeve demografike, siç tregojnë testet statistikore, u konstatuan dallime që nuk ishin statistikisht të rëndësishme, përveç atyre që lidhen me nivelin e edukimit. Kështu, u vërejt se sa më i lartë të jetë niveli i edukimit, aq më të informuar janë individët për ligjin që rregullon martesat e hershme. Pas analizës së njohurive të të anketuarve mbi moshën ligjore për martesë, pyetjet e mëtejshme u përqendruan në perceptimet e tyre për martesat e hershme brenda komunitetit të tyre dhe ndërveprimin me faktorë të ndryshëm socialë dhe arsimorë. Të miturit u pyetën nëse mendojnë se ndjekja dhe vazhdimi i shkollës mund të kontribuojnë në parandalimin e martesave të hershme. Nga të




dhënat e mbledhura, shumica e të anketuarve, ose 63%, besojnë se arsimit luan një rol të rëndësishëm në parandalimin e martesave të hershme. Kjo tregon një njohuri të gjerë mbi rëndësinë e arsimit si mjet për të përmirësuar perspektivat e të rinjve dhe për të zgjeruar mundësitë e tyre përpara se të marrin vendime të rëndësishme si martesë. Në anën tjetër, 32% e të anketuarve nuk pajtohen me këtë mendim, që mund të reflektojë ndikimet e faktorëve kulturale, ekonomike ose të tjerë që reduktojnë efektin që arsimi mund të ketë në këto komunitete. Një përqindje më e vogël, 5%, nuk kanë një qëndrim të qartë mbi këtë çështje, duke treguar se ende ka një hapësirë për ndërgjegjësim dhe edukim më të thellë në lidhje me këtë temë.



**FIGURA 11.** *A mendoni se ndjekja dhe vazhdimi i shkollës mund të parandalojë martesat e hershme?*

Në analizën e të dhënave nga pyetësi, nuk kishte dallime të vlefshme statistikore që lidhen me demografi si vendbanimi, gjinia ose grupet etnike në lidhje me perceptimin e rolit të arsimit si parandalues i martesave të hershme. Ky fakt tregon se pavarësisht ndryshimeve në këto variabla, qëndrimet ndaj arsimit mbetën relativisht të ngjashme ndër të anketuarit. Megjithatë, një dallim u vërejt në lidhje me nivelin e edukimit. Rezultatet treguan se sa më shumë vite shkollimi kanë të përfunduar të miturit, aq më të ndërgjegjësuar janë ata për rolin pozitiv të arsimit.


Pas analizës së ndikimit të arsimit në parandalimin e martesave të hershme, pyetjet e mëtejshme në anketë synuan të thelloheshin në situata specifike brenda komuniteteve të anketuarve. Qëllimi ishte të kuptohej nëse fenomeni i martesave të hershme ndodh para përfundimit të arsimit të mesëm, duke u fokusuar veçanërisht te vajzat dhe djemtë. Në lidhje me vajzat, 66% e të anketuarve kanë raportuar se në komunitetin e tyre ka raste kur vajzat martohen para se të përfundojnë arsimin e mesëm. Ndërkohë, 27% thanë se nuk ekzistojnë raste të tilla dhe 7% nuk ishin të sigurt ose nuk kishin një përgjigje të qartë.



**FIGURA 12.** *A ka raste në komunitetin tuaj ku vajzat martohen para se të përfundojnë arsimin e mesëm?*


Për djemtë, situata është pothuajse e ngjashme: 64% e të anketuarve thanë se kanë vërejtur raste të djemve që martohen para mbarimit të arsimit të mesëm në komunitetin e tyre. 29% mohojnë ekzistencën e rasteve të tilla, dhe 7% janë të pavendosur ose të pasigurt.

Këto të dhëna sugjerojnë se fenomeni i martesave të hershme para përfundimit të arsimit të mesëm ka një prani të konsiderueshme tek të dyja gjinitë, që tregon nevojën për ndërhyrje të drejtuara për adresimin e faktorëve që e mundësojnë këtë fenomen.




**FIGURA 13.** A ka raste në komunitetin tuaj ku djemtë martohen para se të përfundojnë arsimin e mesëm?

Në vazhdim të pyetjeve mbi martesat e hershme, të anketuarit u pyetën për të shprehur perceptimet e tyre mbi ndikimin e këtij fenomeni në jetën e të rinjve. Përgjigjet tregojnë se shumica prej tyre, 64%, e vlerësojnë martesën e hershme si një fenomen negativ. Shumica prej tyre e vlerësojnë martesën e hershme si një pengesë që ka ndikime negative në zhvillimin personal, shëndetësor, arsimor dhe ekonomik të të rinjve. Nga ana tjetër, 23% e të anketuarve mendojnë se martesa e hershme nuk ka ndonjë efekt të dukshëm, duke e cilësuar si neutral. Vetëm 9% e të anketuarve shohin martesën e hershme si diçka pozitive, duke argumentuar se ofron mbështetje dhe stabilizim për të rinjtë. Ndërkohë, 4% e të anketuarve nuk kanë një qëndrim të qartë ose të përcaktuar mbi efektet e martesave të hershme.




**FIGURA 14.** Si e vlerësoni ndikimin e martesave të hershme tek të rinjtë?

Në analizën e përgjigjeve të të anketuarve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian mbi efektet e martesave të hershme, janë vërejtur ndryshime të dukshme që lidhen me grupet etnike dhe nivelin e arsimit. Në përgjithësi, 89% e Egjiptianëve vlerësojnë efektin e martesave të hershme si negativ, krahasuar me 67% të Ashkalive dhe 53% të Romëve.



**FIGURA 15.** Si e vlerësoni ndikimin e martesave të hershme tek të rinjtë? Ndarje me Grupe Etnike

Nga ana tjetër, në varësi të nivelit të arsimit, perceptimi i martesave të hershme ndryshon. Në këtë rast, 87% e të të anketuarve me arsim të mesëm të lartë e vlerësojnë martesën e hershme si negative, ndërsa kjo shifër bie në 74% për ata me arsim të mesëm të ulët dhe në 59% për ata me arsim fillor. Kjo sugjeron se individët me një nivel më të lartë arsimimi janë më të ndërgjegjshëm për ndikimet negative të martesave të hershme.



**FIGURA 16.** Si e vlerësoni ndikimin e martesave të hershme tek të rinjtë? Ndarje me Grupe Etnike

Pyetjet e mëtejshme në seksionin e anketës ishin të fokusuar në identifikimin e rasteve të martesave shumë të hershme, konkretisht ato që ndodhin para moshës 13-vjeçare, si dhe në kuptimin e faktorëve që kontribuojnë në këto martesë brenda komuniteteve të të anketuarve.

Siç shihet në figurën poshtë, rezultatet tregojnë se shumica dërrmuese, 86%, deklaruan se nuk njohin asnjë rast të tillë, ndërsa një përqindje më e vogël, 14%, konfirmuan se kanë dijeni për raste të martesave nën këtë moshë. Këto të dhëna sugjerojnë se martesat e hershme janë të pranishme në këto komunitete, por rastet e martesave para moshës 13-vjeçare janë më të rralla dhe raportohen në shkallë të vogël.




**FIGURA 17.** A njihni ndonjë rast në komunitetin tuaj ku dikush është martuar para moshës 13-vjeçare?

Në mesin e pjesëmarrësve të anketës që raportuan njohuri për raste të martesave të hershme nën moshën 13-vjeçare, një përqindje prej 14%, të cilët përbëjnë 27 të anketuar, u pyetën shtesë për të identifikuar gjininë e të martuarve të hershëm që ata njohin. Analiza e të dhënave tregoi një shpërndarje të balancuar mes gjinive: 30% e përgjigjeve ndikuan se rastet përfshijnë vetëm djem, një përqindje e njëjtë prej 30% raportoi se rastet përfshijnë vetëm vajza, dhe 41% e të anketuarve treguan se njohin raste që përfshijnë të dy gjinitë. Këto gjetje sugjerojnë se martesat e hershme nën moshën 13-vjeçare ndikojnë të dy gjinitë.

Në pyetjen e fundit të këtij seksioni, të anketuarve u kërkua të identifikonin faktorët kryesorë që, sipas tyre, kontribuojnë në martesat e hershme në komunitetin e tyre. Pjesëmarrësit kishin mundësinë të zgjidhnin më shumë se një opsion. Faktori më i raportuar ishte zgjedhja personale, e përmendur nga 50% e të anketuarve, zakonet me 39%, dhe mungesa e shkollimit me 31%. Gjithashtu, presioni nga familja u identifikua si një ndikues kyç nga 24% e pjesëmarrësve, ndërsa frika nga paragjykimi social u shënuar nga 20% e tyre.

Këto të dhëna tregojnë një gamë të gjerë të faktorëve që ndikojnë në fenomenin e martesave të hershme, të cilat variojnë nga zgjedhjet personale dhe ndikimet kulturore te presionet ekonomike dhe sociale. Njohja e këtyre faktorëve është thelbësore për zhvillimin e strategjive efektive që synojnë të ulin incidencën e martesave të hershme në këto komunitete.




**FIGURA 18.** Sipas mendimit tuaj, cilët janë faktorët kryesorë që kontribuojnë në martesat e hershme në komunitetin tuaj? (Mund të zgjidhni më shumë se një opsion – me rotacion)

### 1.3 Përvojat personale rreth martesës së hershme

Moduli i radhës i këtij studimi trajton përvojat personale rreth martesës së hershme, duke synuar të zbulojë detaje specifike mbi përvojat e të anketuarve që lidhen me martesën e tyre. Ky modul përfshin pyetje të drejtpërdrejta që lidhen me statusin e tyre martesor, detajet dhe motivet që ndikuan në vendimin për martesë, si dhe pasojat e tilla në aspektet e tyre personale dhe ekonomike.

Këto të dhëna do të ndihmojnë në krijimin e një pasqyre më të gjerë mbi sfidat që lidhen me martesat e hershme, si dhe mund të kontribuojnë në ndihmën që mund të ofrojnë politikat sociale për të mbështetur të rinjtë në komunitetet që përjetojnë këtë fenomen. Në lidhje me pyetjen mbi përvojat personale rreth martesës së hershme, rezulton se vetëm 7 nga 196 të anketuarit, ose rreth 4% e pjesëmarrësve, kanë deklaruar se janë të martuar. Specifikisht, vetëm 7 nga 196 të anketuarit kanë deklaruar se janë të martuar, që përbën rreth 4% të pjesëmarrësve.



**FIGURA 19.** A jeni i/e martuar?

Në vijim të analizës së përvojave personale rreth martesës së hershme, të dhënat nga 7 respondentët që kanë deklaruar se janë të martuar, tregojnë se shumica e tyre, 6 nga 7, janë vajza dhe jetojnë në zona rurale. Asnjëri prej këtyre të martuarve nuk vijon më arsimin, çka sugjeron një ndërprerje të mundshme të rrugëtimit arsimor për shkak të martesës.

Për sa i përket moshës së martesës, një person është martuar në moshën 15-vjeçare, një tjetër në moshën 16-vjeçare, dhe 5 të tjerë në moshën 17-vjeçare. Të gjitha këto martesë janë raportuar si joformale.

Kur është bërë pyetja rreth inicimit të martesës, 4 nga 7 persona kanë deklaruar se vendimin për t'u martuar e kanë marrë vetë, ndërsa të tjerët kanë thënë se babai i ka nxitur të marrin këtë hap. Ky rezultat tregon një ndikim të strukturave familjare dhe vlerave tradicionale në vendimmarrjen për martesë, duke reflektuar mundësinë që individët të ndjehen të detyruar të ndjekin pritshmëritë e familjes.

Motivet për martesat e hershme janë shumëdimensionale dhe ndahen në ato individuale, si dëshira për pavarësi, dhe ato shoqërore, si zakonet dhe presionet familjare. Zakonet janë përmendur si faktori kryesor nga 5 persona, ndjekur nga dëshira për pavarësi nga familja dhe mungesa e shkollimit, të cilat secila janë përmendur nga 4 persona. Shtatzënia dhe besimet janë përmendur nga 2 persona secili si arsye të rëndësishme, ndërsa vetëm një person ka theksuar se ishte zgjedhja e tyre personale.

Gjithashtu, një nga 7 personat ka fëmijë dhe mosha kur është bërë prind ishte 17-vjeç. Në përfundim të seksionit mbi përvojat personale rreth martesës së hershme, të anketuarit janë pyetur mbi ndryshimet në statusin dhe përgjegjësinë e tyre ekonomike pas martesës. Përgjigjet tregojnë një panoramë të qartë rreth ndikimit ekonomik të martesës së hershme te këta individë.

Vetëm një nga të anketuarit raporton se statusi i tyre ekonomik është përmirësuar pas martesës. Kjo mund të ndikojë se për shumicën, martesë e hershme nuk ka sjellë ndonjë përfitim material ose ndryshim pozitiv në situatën ekonomike. Pjesa dërrmuese, ose 6 nga 7 të anketuarit, thonë se statusi i tyre ekonomik ka mbetur i njëjtë, duke sugjeruar se martesë e hershme nuk ka ndikuar në përmirësimin e kushteve të tyre materiale.


Të gjithë të anketuarit, pra 7 nga 7, raportojnë se përgjegjësia e tyre ekonomike nuk ka ndryshuar shumë pas martesës. Këto të dhëna sjellin në pah sfidat dhe rrethanat që ndikojnë në jetën e të rinjve që hyjnë në martesë të hershme, duke përfshirë ndikimin e tyre në mundësitë arsimore dhe zhvillimin personal.

Është e rëndësishme të theksohet se, ndonëse ky studim përfshin një mostër më të gjerë, gjetjet në këtë seksion bazohen vetëm në përgjigjet e 7 të anketuarve që kanë deklaruar se janë të martuar. Për këtë arsye, rezultatet nuk mund të konsiderohen përfaqësuese për të gjithë të miturit apo për fenomenin e martesës së hershme në përgjithësi. Megjithatë, ato ofrojnë një pasqyrë mbi përvojat e një nëngrupi specifik të të rinjve dhe mund të ndihmojnë në kuptimin e disa aspekteve të këtij fenomeni.

## **1.4 Ndikimi dhe perspektivat e komunitetit**


Moduli i fundit i studimit synon të vë në pah perspektivat se si komunitetet e të anketuarve perceptojnë dhe ndikojnë në fenomenin e martesave të hershme. Ky modul përmban një seri pyetjesh që shqyrtojnë mbështetjen komunitare për martesat e hershme, pranueshmërinë e tyre për vajzat dhe djemtë, si dhe përvojat dhe mendimet rreth dhunës në familje si pasojë e martesave të hershme.

Në pyetjet që lidhen me ndikimin e martesës së hershme në zhvillimin personal dhe vendimmarrjen për këtë martesë në familjet e të anketuarve, të dhënat tregojnë qartë perceptimet dhe dinamikat familjare. Sipas përgjigjeve të mbledhura, 52% e të anketuarve mendojnë se martesa e hershme çon në izolim social, duke e larguar individin nga shoqëria dhe mundësitë që ajo ofron. Gjithashtu, 49% thonë se martesa e hershme pengon arritjen e potencialit në arsim dhe karrierë, duke iu mohuar të rinjve mundësinë për të ndjekur aspirata të mëtejshme në këto fusha. Një përqindje më e vogël (22%) beson se martesa e hershme ndihmon individët të ndihen më të sigurt emocionalisht, dhe 21% thonë se ofron përgjegjësi që ndihmojnë në rritjen personale.



**FIGURA 20.** Si mendoni se martesa e hershme ndikon në zhvillimin personal?

Sa i përket vendimmarrjes për martesën e hershme, 49% e të anketuarve, thonë se babai ka ndikimin më të madh në këtë vendim, që pasqyron një strukturë tradicionale dhe patriarkale në familje. Më tutje, 31% e të anketuarve thonë se vendimi për martesë është marrë nga vetë individët, që tregojnë një nivel të caktuar autonomie personale. Ndërsa, një përqindje më e ulët e përgjigjeve identifikon nënën (9%) ose gjyshërit (7%) si ndikues të rëndësishëm.




**FIGURA 21.** Kush ka ndikim më të madh në vendimin për martesën e hershme në familjen tuaj?

Në analizën e ndikimit të anëtarëve të familjes në vendimmarrjen për martesat e hershme, të dhënat janë ndarë sipas moshës dhe gjinisë për të zbuluar ndryshime dhe tendenca të qarta. Rezultatet tregojnë se babai mbetet një figurë ndikuese në të gjitha grupmoshat dhe për të dy gjinitë, por me një theks të veçantë




në jetën e vajzave. Për grupmoshën 13-15 vjeç, 55% e të anketuarve raportojnë se babai ka ndikimin më të madh, ndërsa për grupmoshën 16-17 vjeç, ky ndikim bie në 42%. Ky zvogëlim sugjeron se ndërsa të rinjtë fillojnë të marrin më shumë kontroll mbi vendimet e tyre, ndikimi prindëror, veçanërisht ai i babait, fillon të zvogëlohet.



**FIGURA 22.** Kush ka ndikim më të madh në vendimin për martesën e hershme në familjen tuaj? Ndarja me grupmoshë

Sipas gjinisë, 46% e djemve dhe 55% e vajzave ndikohen më shumë nga babai në vendimmarrjen për martesën, duke treguar një rol më të theksuar të babait në jetën e vajzave. Nga ana tjetër, autonomia personale në vendimmarrje rritet me moshën dhe është më e lartë te djemtë se te vajzat.




**FIGURA 23.** Kush ka ndikim më të madh në vendimin për martesën e hershme në familjen tuaj? Ndarja me gjini

Kjo ndarje sipas moshës dhe gjinisë në vendimmarrjen për martesat e hershme tregon se si strukturat tradicionale familjare dhe normat gjinore vazhdojnë të formësojnë vendimet e të rinjve. Pavarësisht një tendence për autonomi më të madhe, prania e një ndikimi të fortë prindëror, veçanërisht nga babai te vajzat, sugjeron se ende ekziston një nevojë për të adresuar çështjet e barazisë gjinore dhe për të nxitur një vendimmarrje më e pavarur në çështje kaq të rëndësishme si martesë.


Në lidhje me mbështetjen për martesën e hershme nga njerëzit rreth të anketuarve, gjetjet tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve, 53%, nuk e mbështesin këtë praktikë, ndërsa 42% e mbështesin

dhe një numër i vogël, 5%, nuk kanë një qëndrim të qartë. Kjo ndarje në qëndrime tregon një polarizim në opinionet e njerëzve në lidhje me këtë çështje.



**FIGURA 24.** A mbështetet martesë e hershme nga njerëzit rreth jush?


Kur shqyrtohet analiza ndërmjet grupeve etnike, ndryshimet bëhen më të dukshme. Komuniteti rom shfaqet si më pranues ndaj martesave të hershme me 55% të të anketuarve që raportojnë se martesë e hershme mbështetet nga njerëzit rreth tyre, ndërsa 42% e kundërshtojnë dhe vetëm 3% nuk janë të sigurt. Përkundrazi, komuniteti ashkali dhe ai egjiptian tregojnë qëndrime më kritike. Në komunitetin ashkali, 38% e mbështesin martesën e hershme dhe 55% janë kundër saj, me 8% të të anketuarve që nuk janë të vendosur. Edhe më tepër, në komunitetin egjiptian, vetëm 31% e mbështesin këtë praktikë dhe një shumicë prej 69% janë kundër, që tregon një refuzim më të theksuar ndaj martesave të hershme.



**FIGURA 25.** A mbështetet martesë e hershme nga njerëzit rreth jush? Ndarje me grupe etnike


Sa i përket pranueshmërisë së martesës së hershme në komunitet, të dhënat tregojnë se ndjenjat ndaj kësaj praktike janë të ngjashme për djemtë dhe vajzat, por me një prirje pak më të madhe të pranueshmërisë për djemtë.

Për vajzat, 23% e të anketuarve mendojnë se martesë e hershme është shumë e pranueshme, ndërsa 57% e konsiderojnë atë deri diku të pranueshëm, dhe 20% thonë se nuk është e pranueshme.



**FIGURA 26.** Sa e pranueshme është nga komuniteti juaj martesë e hershme për vajzat?


Për djemtë, 24% e pjesëmarrësve mendojnë se martesë e hershme është shumë e pranueshme, gati një përqindje e njëjtë me atë për vajzat, por me një përqindje pak më të lartë të atyre që e konsiderojnë deri diku të pranueshme (56%), dhe përsëri 20% e shohin si e papranueshme.



**FIGURA 27.** Sa e pranueshme është nga komuniteti juaj martesë e hershme për djemtë?


Këto rezultate sugjerojnë një nivel relativisht të lartë të tolerancës ndaj martesës së hershme në komunitet, me një diferencë minimale midis gjinive. Megjithatë, proporcioni i konsiderueshëm i pjesëmarrësve që e shohin si të papranueshme tregon një ndërgjegjësim të rritur mbi pasojat potencialisht negative të kësaj praktike. Kjo ndarje në qëndrime ofron një bazë për diskutime më të thelluara dhe nisma të mundshme edukative për të adresuar dhe ndryshuar normat shoqërore rreth martesës së hershme.

Në pyetjen nëse kanë dëgjuar për raste të dhunës në familje ndërmjet çifteve që janë martuar në moshë të re, shumica e të anketuarve, 81%, deklarojnë se nuk kanë dëgjuar për të tilla raste. Vetëm 15% e të anketuarve thonë se kanë dëgjuar për raste të dhunës në familje ndërmjet çifteve të martuara në moshë të re, ndërsa një pjesë e vogël, 4%, nuk janë të sigurt ose nuk kanë njohuri mbi këtë çështje. Kjo mund të tregojë se, megjithëse dhuna në familje nuk është perceptuar si një fenomen dominues në lidhje me martesat e hershme, ndodhin incidente të tilla që mund të jenë më pak të dukshme ose të raportohet më pak.




**FIGURA 28.** A keni dëgjuar për raste të dhunës në familje ndërmjet çifteve që janë martuar në moshë të re?

Nga të anketuarit që kanë dëgjuar për raste të dhunës në familje ndërmjet çifteve të martuara në moshë të re, forma më e shpeshtë e dhunës që ata kanë raportuar është dhuna fizike, me një total prej 20 përgjigjesh që e identifikojnë këtë lloj. Dhuna psikologjike është e dyta më e raportuara, me 5 përgjigje që tregojnë për raste kur dikush përdor fjalë ose sjellje për të kontrolluar ose frikësuar dikë tjetër. Dhuna ekonomike, ku një person kontrollon ose mban peng qasjen në paratë ose burimet financiare të partnerit, është raportuar vetëm në një rast. Një numër më i vogël i përgjigjeve, 4 në total, kanë thënë se kanë dëgjuar për të gjitha llojet e përmendura të dhunës.



**FIGURA 29.** Për çfarë lloji të dhunës keni dëgjuar më shpesh? n=30


Të anketuarit në studimin kanë shprehur një qëndrim të qartë se martesë e hershme ndikon negativisht në shëndetin e të rinjve. Shumica prej tyre, 55%, mendojnë se kjo ndikon negativisht në shëndetin e vajzave, ndërsa 36% besojnë se ndikon gjithashtu negativisht në shëndetin e djemve. Një përqindje të konsiderueshme, 23%, e shohin këtë ndikim si jo të pranishëm për asnjërën gjini, ndërsa një pjesë e vogël, 4%, nuk janë të sigurt për ndikimin e martesës së hershme.



**FIGURA 30.** A mendoni se martesë e hershme ndikon në shëndetin e vajzave dhe djemve në komunitetin tuaj?

Në lidhje me masat që mund të merren për të parandaluar këtë fenomen, të anketuarit kanë propozuar disa alternativa. Mbështetja ekonomike për familjet në nevojë është zgjidhja më e preferuar, e mbështetur nga 49% e pjesëmarrësve. Përmirësimi i qasjes në arsim për vajzat vjen si një masë e rëndësishme për 37% të pjesëmarrësve, ndërsa 32% përkrahin ngritjen e programeve që fuqizojnë vajzat dhe gratë. Forcimi i zbatimit të ligjeve kundër martesave të hershme është një prioritet për 31%, dhe 26% besojnë në rritjen e ndërgjegjësimit përmes programeve edukative. Sigurimi i shërbimeve të këshillimit për familjet dhe të


rinjtë është i rëndësishëm për 23%, ndërsa angazhimi i liderëve fetarë dhe komunitarë për të ndryshuar normat kulturore është i preferuar nga 14% e të anketuarve.



**FIGURA 31.** Sipas jush, çfarë mendoni se mund të bëhet për të parandaluar martesat e hershme në komunitetin tuaj?

Këto rezultate tregojnë një kuptim të thellë të nevojave dhe të sfidave që lidhen me martesat e hershme, si dhe një gatishmëri për të ndërmarrë një gamë veprimesh për të adresuar këtë çështje në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Në pyetjen finale të studimit, të anketuarit janë pyetur për këndvështrimin e tyre në lidhje me martesën dhe moshën e përshtatshme për të. Rezultatet tregojnë se shumica, 54%, mendojnë se të rinjtë duhet të presin deri në moshën madhore (18 vjeç) për t'u martuar. Një përqindje e konsiderueshme, 38%, besojnë se të rinjtë duhet të përfundojnë shkollimin dhe të punësohen para se të martohen, duke vënë theksin në rëndësinë e stabilitetit personal dhe profesional para hyrjes në një lidhje të tillë serioze. Vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve, 6%, mendon se të rinjtë mund të martohen edhe nën 18 vjeç nëse dëshirojnë, ndërsa 2% nuk kanë një mendim të qartë mbi këtë çështje.



**FIGURA 32.** Cili është këndvështrimi juaj në lidhje me martesën?


Këto rezultate pasqyrojnë një konsensus të qartë midis të anketuarve që mbështesin një qasje më të matur ndaj martesës, duke vlerësuar përgatitjen dhe stabilitetin personal si elemente kyçe para angazhimit në një marrëdhënie kaq të rëndësishme. Kjo tregon për një ndërgjegjësim në rritje rreth rëndësisë së arsimit dhe të pavarësisë ekonomike para marrjes së përgjegjësisë të mëdha siç është martesë.

## 1.5 Rezultatet e pyetësorit me të rritur (18-40 vjeç)

Të dhënat në seksionet e mëposhtme përmbledhin rezultatet dhe perceptimet e pyetësorit anonim të realizuar me 179 të rritur të moshës 18 deri 40 vjeç, të cilët janë martuar para moshës 18 vjeçare, dhe që përkasin komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Edhe ky hulumtim u realizua në 19 komuna të Kosovës, të cilat kanë një popullsi më të lartë të këtyre komuniteteve. Qëllimi i këtij studimi është të kuptojë përvojat dhe qëndrimet e individëve ndaj martesave të hershme.


Për të kuptuar më qartë profilin e të anketuarve si dhe për të vendosur gjetjet në kontekst, në fillim janë paraqitur disa të dhëna demografike. Këto të dhëna na ndihmojnë në interpretimin e rezultateve dhe identifikimin e faktorëve që mund të ndikojnë në perceptimet dhe përvojat e komuniteteve të anketuara.

Rezultatet e anketës lidhur me nivelin më të lartë të arsimit të të anketuarve tregojnë një nivel arsimor relativisht të ulët. Më shumë se një e treta e të anketuarve (38%) raportuan se nuk kanë ndjekur arsimin formal. 28% kanë përfunduar arsimin fillor, ndërsa 30% kanë përfunduar arsimin e mesëm të ulët (deri në klasën e 9-të). Vetëm 3% e të anketuarve kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë (klasën e 12-të), dhe vetëm 1% kanë përfunduar arsimin profesional. Këto të dhëna sugjerojnë një nivel të kufizuar arsimit formal brenda këtij komuniteti.



**FIGURA 33.** *Niveli më i lartë i arsimit që keni përfunduar*

Në lidhje me statusin e punësimit aktual të të anketuarve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, të dhënat tregojnë se 44% e individëve janë të papunë, ndërsa 32% raportojnë se janë shtëpiakë. 15% e të anketuarve punojnë në sektorin privat, ndërsa 5% janë punonjës me kohë të pjesshme ose të rastit dhe së fundmi 4% raportojnë se janë të vetëpunësuar. *Një aspekt i rëndësishëm që vërehet është se asnjë individ nga ky komunitet nuk ka raportuar se është i punësuar në sektorin publik.*



**FIGURA 34.** Statusi i punësimit aktual

Për sa i përket përbërjes familjare, pjesëmarrësit e anketës nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian raportuan një mesatare prej 6.59 anëtarësh për familje, duke treguar se këto komunitete kanë familje relativisht të mëdha. Ky numër është më i lartë se mesatarja e popullsisë, ku Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2024 tregon se numri mesatar i anëtarëve në një ekonomi familjare është 4.5.<sup>81</sup> Ky dallim mund të reflektojë një normë kulturore dhe sociale ku familjet janë të lidhura ngushtë dhe kanë një strukturë më të gjerë. Po ashtu, variacioni i madh i të dhënave, me familje që përfshijnë nga 2 deri në 30 anëtarë, sugjeron një gamë të gjerë të madhësisë së familjes, e cila mund të lidhet me faktorë të ndryshëm si vendndodhja, statusi socio-ekonomik dhe traditat kulturore.

**TABELA 2.** Sa është numri i anëtarëve në familjen tuaj?

|                                              | Minimumi | Maksimumi | Mesatarja | Devijimi standard |
|----------------------------------------------|----------|-----------|-----------|-------------------|
| Sa është numri i anëtarëve në familjen tuaj? | 2        | 30        | 6.59      | 2.784             |


## 1.6 Seksioni rreth martesave të hershme

Seksioni rreth martesave të hershme synon të masë faktorët dhe kushtet që lidhen me iniciativën, vendimmarrjen dhe motivet për martesat e hershme duke përfshirë rolin e familjes, ndikimin e shoqërisë dhe faktorët ekonomikë dhe kulturorë. Qëllimi është të kuptohet nëse martesat e hershme në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë ndikuar nga presionet shoqërore dhe familjare, dhe sa informacion dhe liri zgjedhjeje kishin individët në këtë proces.

Të dhënat tregojnë se shumica dërmuese e të rriturve të anketuar janë martuar në moshën 17 vjeç (56%), ndërsa një pjesë e konsiderueshme është martuar në moshën 16 vjeç (29%). Përqindja e atyre që janë martuar më herët është më e ulët, duke filluar nga 8% për moshën 15 vjeç, 4% për moshën 14 vjeç, 2% për moshën 13 vjeç dhe vetëm 1% për moshën 12 vjeç.


Ata që janë martuar në moshën 16 ose 17 vjeç janë pyetur nëse kishin leje të gjykatës për lejimin e martesës së tyre. Rezultatet tregojnë se shumica dërmuese (82%) nuk kanë pasur një leje të tillë, ndërsa vetëm 18% e kanë deklaruar se e kanë marrë atë.

<sup>81</sup> <https://ask.rks-gov.net/Releases/Details/8226> qasur më 03 Mars 2025.



**FIGURA 35.** Në çfarë moshe jeni martuar?


Të anketuarit janë pyetur se kush e inicioi martesën e tyre të hershme, dhe shumica (66%) janë shprehur se e kanë marrë vetë këtë vendim. Ndërkohë, për 20% të tyre, iniciatori ka qenë babai, ndërsa në raste më të rralla, iniciativa është marrë nga bashkëshorti/ja (6%), nëna (3%) ose e gjithë familja (3%). Vetëm 2% kanë dhënë përgjigje të tjera. Këto rezultate sugjerojnë se, edhe pse shumica e të anketuarve e konsiderojnë martesën si një zgjedhje personale, ndikimi i familjes, veçanërisht i babait, mbetet i pranishëm.



**FIGURA 36.** Kush e inicioi martesën tuaj të hershme?

Për më tepër, të anketuarit u pyetën se kush vendosi për martesën e tyre. Rezultatet e mëposhtme tregojnë se 60% e tyre e morën vetë këtë vendim, ndërsa në 30% të rasteve, vendimi u mor nga babai. Në raste më të rralla, vendimmarrësi ishte nëna (4%), e gjithë familja (3%) ose të afërmit e tjerë (2%). Vetëm 1% kanë dhënë përgjigje të tjera si për shembull vëllai dhe nëna, apo ata vetë së bashku me nënën.






**FIGURA 37.** *Kush vendosi për martesën tuaj?*

Analiza e vendimmarrjes për martesën tregon dallime të rëndësishme midis burrave dhe grave. Burrat në shumicën dërrmuese të rasteve (88%) raportojnë se e kanë marrë vetë këtë vendim, ndërsa tek gratë kjo përqindje është dukshëm më e ulët (47%), duke sugjeruar se gratë kanë më pak autonomi në marrjen e këtij vendimi.


Për gratë, vendimi për martesë duket se është ndikuar ndjeshëm nga figura mashkullore në familje, pasi 40% raportojnë se ishte babai ai që mori këtë vendim, krahasuar me vetëm 9% tek burrat. Ndërkohë, ndikimi i nënës është më i vogël, me vetëm 6% të grave që raportojnë se nëna e tyre mori këtë vendim. Vendimmarrja familjare është më e zakonshme tek gratë (4%) sesa tek burrat, ndërsa përfshirja e të afërmeve të tjerë mbetet në nivele të ulëta për të dyja gjinitë (2%).



**FIGURA 38.** *Kush vendosi për martesën tuaj? \*Ndarja me gjini*


Të pyetur nëse kishin marrë ndihmë ose këshilla nga jashtë para martesës së tyre, sipas rezultateve të pyetësorit me të rriturit, 59% e të intervistuarve kishin marrë ndihmë të tillë, ndërsa 41% u shprehën se nuk kishin marrë asnjë këshillë apo mbështetje.

Ata që janë përgjigjur po, u pyetën gjithashtu se kush e kishte dhënë këtë mbështetje dhe sipas të dhënave, 98% e të anketuarve që morën mbështetje, e kishin marrë atë nga anëtarët e familjes, ndërsa vetëm 2% e kishin marrë nga miqtë.




**FIGURA 39.** A keni pasur ndonjë mbështetje ose këshillë të jashtme përpara martesës suaj?

Në lidhje me nivelin e informacionit për martesën para lidhjes së saj, 32% e të anketuarve u shprehën se kishin informacion të mjaftueshëm, ndërsa një shumicë prej 68% u shprehën se nuk kishin marrë informacion të mjaftueshëm përpara se të martoheshin. Këto rezultate tregojnë se shumica e të anketuarve ndihen se kanë hyrë në martesë pa pasur informacion të plotë mbi atë që ajo përfshin, gjë që mund të ndikojë në pritshmëritë dhe përgatitjen e tyre për jetën bashkëshortore.



**FIGURA 40.** A mendoni se keni pasur informacion të mjaftueshëm për martesën përpara se të martoheni?

Për sa i përket motivit kryesor për martesën e hershme, të anketuarit mund të zgjidhnin më shumë se një opsion. Sipas rezultateve, 47% e tyre caktuan si motivin kryesor zgjedhjen e tyre personale, ndërsa 45% e lidhnin martesën me zakonet. Besimet dhe mungesa e shkollimit u përmendën si arsye nga 23% dhe 18% e të anketuarve, përkatësisht. Presioni nga familja u identifikua nga 15%, ndërsa ndikimi i bashkëmoshatarëve dhe dëshira për pavarësi nga familja u përmendën nga 11% dhe 10% e të intervistuarve. Rolet dhe pritjet gjinore u përmendën nga 8%, ndërsa 7% e shpjeguan martesën me frikën nga paragjykimi social. Shtatzënia dhe arsye të tjera ishin motive për 6% dhe 3% të të anketuarve, respektivisht. Ndërsa 2% e lidhën martesën me nevojën për para ose presionin ekonomik.




**FIGURA 41.** Cili ishte motivi kryesor për martesën tuaj të hershme?

Kur motivet për martesën e hershme analizohen sipas grupmoshës, vërehet se zgjedhja personale është arsyeja më e përmendur nga të rinjtë 18-24 vjeç (66%), ndërsa kjo përqindje bie ndjeshëm tek grupmoshat më të vjetra (39% tek 25-34 vjeç dhe 36% tek 35-40 vjeç). Kjo mund të sugjerojë një tendencë më të madhe drejt autonomisë në vendimmarrje tek të rinjtë sot në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, krahasuar me të kaluarën.


Nga ana tjetër, zakonet kanë luajtur një rol më të madh tek grupmosha 25-34 vjeç (53%), duke sugjeruar se normat tradicionale kanë pasur më shumë ndikim tek kjo gjeneratë. Ndërsa mungesa e shkollimit është përmendur më shpesh si faktor nga grupmoshat më të vjetra (23% tek 35-40 vjeç), duke sugjeruar një lidhje të fortë midis mungesës së arsimit dhe martesave të hershme në të kaluarën. Presioni familjar gjithashtu duket më i lartë tek grupmosha 25-34 vjeç (18%) sesa tek të rinjtë (10%), por mbetet relativisht konstant në grupmoshën më të vjetër (16%).

Ndër faktorët më pak të përmendur janë shtatzënia dhe presioni ekonomik, të cilët mbeten në nivele të ulëta në të gjitha grupmoshat. Në tërësi, këto të dhëna tregojnë një ndryshim në perceptimet dhe rrethanat që çojnë në martesat e hershme, me një rënie të ndikimit të faktorëve kulturorë dhe një rritje të autonomisë në vendimmarrje tek të rinjtë e sotëm në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian me të cilët është realizuar anketa.




**FIGURA 42.** Cili ishte motivi kryesor për martesën tuaj të hershme? \*Ndarja me grupmoshë

Për sa i përket natyrës së martesës, 80% e të anketuarve e përshkruajnë atë si një martesë me vullnetin e tyre (konsensuale). Ndërkohë, 7% e të anketuarve e përjetuan martesën si të detyruar ose nën presion, dhe 13% përshkruan ndjenja të përziera, duke raportuar se ishte pjesërisht zgjedhja e tyre dhe pjesërisht ishin nën presion.




**FIGURA 43.** *Martesa juaj ishte:*

Dallimet mes burrave dhe grave janë domethënëse sa i përket natyrës së martesës së tyre. Burrat raportojnë më shpesh se martesa e tyre ishte me vullnet të plotë (91%), ndërsa kjo përqindje është më e ulët tek gratë (74%). Nga ana tjetër, gratë raportojnë më shumë se martesa e tyre ishte e detyruar ose e bërë nën presion (9% kundrejt 3% të burrave) dhe të kenë ndjenja të përziera rreth zgjedhjes së tyre (17% krahasuar me 5% të burrave), duke sugjeruar se gratë përballen më shpesh me ndikime apo presion nga familja dhe rrethanat kur bëhet fjalë për martesën.



**FIGURA 44.** *Martesa juaj ishte: \*Ndarja me gjini*


Në lidhje me formën e martesës, 85% e të anketuarve raportuan se martesa e tyre ishte joformale, siç është bashkëjetesa, ndërsa vetëm 15% e përkrahuan martesën e tyre si formale, e ligjshme dhe e kurozuar zyrtarisht. Ky rezultat sugjeron se në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, martesat joformale, si bashkëjetesa, janë një normë e zakonshme, ndërsa martesat formale mbeten më të rralla. Ky trend mund të lidhet me faktorë si traditat komunitare, barrierat ligjore dhe administrative për regjistrimin e martesave në momentin e lidhje së saj (si për shembull mosha minimale për martesë), si dhe nivelet e informimit apo qasjes në institucionet shtetërore. Për më tepër, martesat joformale mund të kenë implikime të rëndësishme për gratë dhe fëmijët, duke ndikuar në të drejtat e tyre ligjore, përfshirë qasjen në mbrojtje sociale, trashëgimi dhe kujdestari. Kjo thekson nevojën për ndërgjegjësim dhe mbështetje për të siguruar që të gjitha familjet të kenë qasje në të drejtat dhe shërbimet që ofron martesa ligjore.



**FIGURA 45.** A ishte kjo një martesë formale apo joformale?

Shumica e të anketuarve (68%) shprehen se nuk kanë pasur informacion të mjaftueshëm për martesën përpara se të martoheshin, ndërsa 32% besojnë se kishin njohuritë e nevojshme. Këto rezultate sugjerojnë se një pjesë e madhe e të martuarve në moshë të re mund të jenë futur në këtë hap jetësor pa pasur mjaftueshëm udhëzime apo mbështetje për të kuptuar plotësisht përgjegjësitë dhe sfidat që sjell martesa.

Kur rezultatet analizohen sipas gjinisë, vërehet se burrat raportojnë një nivel më të lartë të informimit për martesën përpara se të martoheshin, me 47% që u shprehën se kishin informacion të mjaftueshëm, krahasuar me vetëm 25% të grave. Nga ana tjetër, 75% e grave deklaruan se nuk kishin njohuri të mjaftueshme për martesën, një përqindje dukshëm më e lartë se ajo e burrave (53%) duke sugjeruar një hendek gjinor në qasjen ose perceptimin e informacioneve të nevojshme para martesës. Kjo thekson nevojën për më shumë ndërgjegjësim dhe mbështetje për vajzat dhe gratë e reja.




**FIGURA 46.** A mendoni se keni pasur informacion të mjaftueshëm për martesën përpara se të martoheni?

\*Ndarja me gjini

## 1.7 Arsimimi dhe shkollimi

Seksioni i mëposhtëm synon të masë ndikimin e martesës në arsimin dhe shkollimin e individëve të anketuar në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Ky seksion shqyrton nëse personat ishin të regjistruar në shkollë kur u martuan, nëse martesë ka shkaktuar ndërprerjen e arsimit dhe cili ka qenë vendimi për këtë ndërprerje. Gjithashtu, seksioni kërkon të kuptojë nëse martesë ndikon në vendimin për të vazhduar shkollimin dhe nëse shoqëria ushtron presion mbi vajzat e reja për t'u martuar, duke i penguar ato të vazhdojnë arsimimin.

Në momentin e martesës, 11% e të anketuarve apo 19 individë raportojnë se ishin të regjistruar në shkollë, ndërsa një shumicë prej 89% nuk ishin të regjistruar në shkollë në atë kohë.




**FIGURA 47.** A ishit i/e regjistruar në shkollë kur u martuat?

Ata që ishin të regjistruar në shkollë kur u martuan (19 individë në total), u pyetën nëse arsimimi i tyre ishte ndërprerë si rezultat i martesës. Sipas rezultateve, 12 persona apo 63% e tyre u përgjigjën po, duke treguar se martesë kishte ndërprerë arsimimin e tyre, ndërsa 7 persona apo 37% u shprehën se arsimimi i tyre nuk ishte prekur nga martesë.

Të gjitha gratë që raportuan se ishin të regjistruara në shkollë në momentin e martesës (11 vajza/gra) u shprehën se arsimimi i tyre u ndërpre si rezultat i martesës. Nga ana tjetër, vetëm 1 nga 8 burrat e regjistruar në shkollë kur u martuan deklaroi se arsimimi i tij ishte ndërprerë pas martesës. (Shih Figurën 48)

Për më tepër, ata që raportuan se kishin ndërprerë arsimimin si pasojë e martesës, u pyetën për nivelin e arsimit në të cilin ndodhën ndërprerjet. Sipas rezultateve, 75% e tyre (9 individë) kishin qenë në arsimin e mesëm të ulët (klasa 6-9), ndërsa 25% (3 individë) ishin në arsimin e mesëm të lartë (klasa 10-12) kur kishin ndërprerë shkollimin.


Së fundmi, ata që raportuan se kishin ndërprerë shkollimin, u pyetën se kush kishte vendosur për ndërprerjen. Sipas rezultateve, 75% e të anketuarve (9 individë) e kishin vendosur vetë të ndërprisnin shkollimin, ndërsa 25% (3 individë) raportuan se vendimi ishte marrë nga bashkëshorti/ja.



**FIGURA 48.** A u ndërpre arsimimi juaj si rezultat i martesës? \* Ndarja me gjini (n=19)

Kur të anketuarit u pyetën nëse martesë në përgjithësi ndikon në vendimin për të vazhduar shkollimin, 57% e të anketuarve përgjigjën po, duke besuar se martesë ka një ndikim në këtë vendim, ndërsa 43% u shprehën se martesë nuk ndikon në vendimin për të vazhduar shkollimin.


Për më tepër, 51% e të anketuarve besojnë se shoqëria ushtron presion mbi vajzat e reja për t'u martuar në moshë të re, edhe kur ato dëshirojnë të vazhdojnë shkollimin, ndërsa 49% nuk e mendojnë këtë dhe nuk e shohin një presion të tillë.



**FIGURA 49.** A mendoni se martesë ndikon në vendimin për të vazhduar shkollimin?

Në tërësi, vetëm 2% e të anketuarve kanë vijuar shkollimin pas martesës, ndërsa një shumicë e madhe prej 98% nuk e kanë vazhduar atë pas martesës. Ky rezultat sugjeron se një shumicë e madhe e individëve në komunitetet me të cilat është zhvilluar pyetësi nuk kanë pasur mundësi ose nuk kanë zgjedhur të vazhdojnë shkollimin pas martesës. Kjo mund të pasqyrojë një ndikim të fortë të faktorëve shoqërorë dhe kulturorë, të tilla si pritshmëritë tradicionale për rolin e gruas pas martesës, mungesa e mbështetjes për arsimimin e mëtejshëm, ose sfida të tjera si ngarkesa me detyra familjare.






**FIGURA 50.** A keni vijuar shkollim pas martesës?

## 1.8 Ndikimi i martesës së hershme në mirëqenie dhe punësim


Seksioni në vijim ka për qëllim të masë ndikimin e martesës së hershme në mirëqenien dhe punësimin e individëve. Ai shqyrton sesi martesa e hershme ka ndikuar në aspektet psikologjike, fizike dhe sociale të jetës së individëve. Pjesa tjetër e modulit fokusohet në përvojat e dhunës gjatë martesës, duke identifikuar burimin dhe llojin e dhunës të përjetuar.

Nga këndvështrimi i të anketuarve, rezultatet tregojnë se martesa e hershme ka pasur ndikime të ndryshme në mirëqenien psikologjike, fizike dhe sociale. Shumica, përkatësisht 42% për mirëqenien psikologjike, 43% për atë fizike dhe 47% për jetën sociale, u shprehën se martesa nuk ka pasur ndikim të dukshëm, duke sugjeruar se për ta martesa e hershme nuk ka ndryshuar ndjeshëm cilësinë e jetës. Megjithatë, një përqindje e konsiderueshme ka perceptuar ndikime pozitive, veçanërisht në aspektin psikologjik (37%), fizik (38%) dhe social (34%), ndërsa një pjesë më e vogël ka ndjerë ndikime negative, përkatësisht 20% për mirëqenien psikologjike dhe jetën sociale, dhe 19% për mirëqenien fizike.




**FIGURA 51.** Si ka ndikuar martesa e hershme në mirëqenien tuaj?

Të anketuarit u pyetën nëse kanë fëmijë, dhe shumica dërrmuese (92%) janë përgjigjur po. Të anketuarit që kanë fëmijë u pyetën edhe për numrin e fëmijëve të tyre. Rezultatet e paraqitura në Figurën 58 tregojnë se 28% kanë tre fëmijë, ndërsa 22% kanë dy ose katër fëmijë. Një përqindje më e vogël ka një fëmijë (13%), pesë fëmijë (7%) ose gjashtë fëmijë (6%). Rastet kur të anketuarit kanë shtatë ose tetë fëmijë janë shumë të rralla, me nga 1% secili. Këto të dhëna nga anketa me të rritur sugjerojnë se shumica e të intervistuarve në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë nga dy deri në katër fëmijë.




**FIGURA 52.** *Sa është numri i fëmijëve që keni?*

Për më tepër, ata që kanë deklaruar se kanë fëmijë janë pyetur se në çfarë moshe janë bërë prindër për herë të parë. Rezultatet tregojnë se shumica kanë pasur fëmijën e parë në moshën 18 vjeçare (39%) ose 19 vjeçare (23%). Një pjesë e konsiderueshme, por më e vogël është bërë prind në moshën 17 vjeçare (14%) dhe 16 vjeçare (7%). Rastet kur prindërimi ka ndodhur në moshën 14 dhe 22 vjeçare janë më të rralla (2% secili), ndërsa një përqindje shumë e vogël raportoi se janë bërë prind në moshën 23 ose 29 vjeçare (1% secili).



**FIGURA 53.** *Në çfarë moshe jeni bërë prind për herë të parë?*


Më shumë se gjysma e të anketuarve (56%) raportuan se statusi i tyre ekonomik mbeti i njëjtë pas martesës. Ndërkohë, për 23% situata ekonomike u përmirësua, ndërsa 21% përjetuan një përkeqësim. Kjo sugjeron se për shumicën e të anketuarve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, martesë nuk ka ndikuar ndjeshëm në statusin e tyre ekonomik, ndërsa për një pjesë të konsiderueshme, veçanërisht 21%, ajo ka sjellë sfida financiare shtesë.



**FIGURA 54.** A ndryshoi statusi juaj ekonomik pas martesës?

Për më tepër, për shumicën e të anketuarve (68%), përgjegjësia e tyre ekonomike nuk pësoi ndryshime të mëdha pas martesës. Megjithatë, për disa, martesë solli sfida të reja financiare ku 22% u detyruan të fillonin punë për të mbajtur familjen, ndërsa 10% u larguan nga shkolla për t'u angazhuar në punë.

Kur këto të dhëna analizohen sipas gjinisë, vërehet një ndryshim i qartë në ndikimin e martesës mbi përgjegjësitë ekonomike. Ndërsa 47% e burrave raportojnë se duhej të fillonin punë për të mbajtur familjen, vetëm 10% e grave e kanë përjetuar këtë ndryshim. Po ashtu, 16% e burrave dhe 7% e grave deklarojnë se iu desh të linin shkollën për të punuar. Nga ana tjetër, shumica dërrmuese e grave (83%) thonë se përgjegjësitë e tyre ekonomike nuk ndryshuan pas martesës, krahasuar me 38% të burrave.




**FIGURA 55.** A ndryshoi përgjegjësia juaj ekonomike pas martesës? \*Ndarja me gjini

Përfshirja e pyetjeve në lidhje me dhunën në familje në pyetësor ishte vendimtare për të nxjerrë në pah çështjen serioze të dhunës në martesë. Ky hulumtim ka për qëllim të tërheqë vëmendjen për përhapjen dhe ashpërsinë e këtij problemi, duke kontribuar në krijimin e politikave dhe veprimeve të ardhshme që synojnë mbrojtjen e individëve të rrezikuar në këto komunitete. Sipas rezultateve të anketës, 11% e të anketuarve kanë raportuar se kanë përjetuar ndonjë formë dhune gjatë martesës së tyre.

Nga ata që raportuan përjetimin e dhunës gjatë martesës, 7 individë (35%) theksuan se burimi i dhunës ka qenë bashkëshorti/ja, ndërsa 12 individë (60%) raportuan se dhuna ka ardhur nga familja e bashkëshortit. Vetëm 1 individ (5%) ka përmendur burime të tjera të dhunës, e në këtë rast ka qenë vetë bashkëshorti ashtu edhe familja e bashkëshortit që ka ushtruar dhunë ndaj të anketuarit.

Së fundmi, ata që raportuan përjetimin e dhunës gjatë martesës, 9 individë (45%) raportuan se kanë përjetuar dhunë fizike, 10 individë (50%) kanë përjetuar dhunë psikologjike, dhe 1 individ (5%) ka përjetuar dhunë ekonomike.




**FIGURA 56.** A keni përjetuar ndonjë formë të dhunës gjatë martesës suaj?

## 1.9 Perceptimet dhe normat e komunitetit

Ky seksion ka për qëllim të masë perceptimet dhe normat shoqërore që lidhen me martesën e hershme në komunitet. Ai shqyrton nëse martesa e hershme është e zakonshme dhe të cilat janë normat dhe praktikrat shoqërore që e mbështesin këtë fenomen. Po ashtu, fokusohet në mendimin e individëve për çështje si dhuna në martesë, njohuritë për ligjin që ndalon martesat e hershme, dhe nëse familjet janë të vetëdijshme për pasojat e mundshme negative.

Të pyetur nëse martesa e hershme është e zakonshme në komunitetin e tyre, 74% e të anketuarve përgjigjën po, ndërsa 26% e konsiderojnë të padëshirueshme.


Kur të anketuarit u pyetën për normat shoqërore që mbështesin martesat e hershme në komunitet, 66% e të anketuarve kanë theksuar besimin se vajzat janë më të sigurta në martesë. Gjithashtu, 41% e kanë lidhur martesën e hershme me presionin për të ruajtur nderin e familjes, ndërsa 35% kanë përmendur pritjet fetare ose kulturore si faktor mbështetës. Më tutje, 28% e konsiderojnë presionin e komunitetit si një element që ndikon në martesat e hershme, ndërkohë që 14% e kanë lidhur këtë me praktikrat e çmimit nusëror, ose dhuratat që sjell familja e bashkëshortit.



**FIGURA 57.** Cilat janë normat shoqërore që mbështesin martesat e hershme në komunitetin tuaj?

Kur rezultatet analizohen sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se normat shoqërore që mbështesin martesat e hershme janë të ngulitura thellë në besimin se vajzat janë më të sigurta në martesë, një perceptim që ndajnë pothuajse njësoj burrat (67%) dhe gratë (65%). Pritshmëritë fetare ose kulturore luajnë një rol më të madh për burrat (45%) sesa për gratë (31%), ndërsa presioni për të ruajtur nderin e familjes është një faktor pothuajse i barabartë për të dyja gjinitë (40% e burrave dhe 42% e grave).

Ndërkohë, praktikatat ekonomike si çmimi nusëror ose dhuratat martesore kanë më pak ndikim në mbështetjen e martesave të hershme, por përsëri raportohen më shpesh nga burrat (19%) sesa nga gratë (12%). Një dallim i qartë vihet re te presioni i komunitetit, i cili përmendet nga 34% e grave, krahasuar me vetëm 16% të burrave, duke sugjeruar se gratë ndihen më të prekura nga normat kolektive të komunitetit.




**FIGURA 58.** Cilat janë normat shoqërore që mbështesin martesat e hershme në komunitetin tuaj? \*Ndarja me gjini

Në analizën sipas vendbanimit, rezulton se disa norma shoqërore që mbështesin martesat e hershme janë më të theksuara në zonat rurale sesa në ato urbane. Besimi se vajzat janë më të sigurta në martesë është më i përhapur në zonat rurale (71%) krahasuar me ato urbane (62%), duke reflektuar një qasje më tradicionale ndaj rolit të martesës si një mekanizëm mbrojtës për vajzat.

Presioni për të ruajtur nderin e familjes është gjithashtu më i lartë në komunitetet rurale (55%) sesa në ato urbane (30%), çka tregon se normat sociale mbi sjelljen dhe reputacionin e vajzave mbeten më të forta


në këto zona. Në të kundërt, pritjet fetare ose kulturore raportohen më shpesh si faktor mbështetës për martesat e hershme në zonat urbane (42%) sesa në ato rurale (27%).

Presioni i komunitetit është i njëjtë në të dyja zonat (28%), duke treguar se ky faktor mbetet një element i qëndrueshëm në normalizimin e martesave të hershme. Ndërkohë, ndikimi i praktikave të çmimit nusëror është relativisht i ulët si në zonat urbane (13%), ashtu edhe në ato rurale (15%).




**FIGURA 59.** Cilat janë normat shoqërore që mbështesin martesat e hershme në komunitetin tuaj? \*Ndarja me vendbanimim

Përgjigjet në lidhje me pyetjen “A mendoni se është e drejtë për një burrë të rrahë gruan në këto raste?” tregojnë një perceptim dominues se dhuna ndaj gruas nuk është e justifikueshme brenda komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Në të gjitha situatat e paraqitura, shumica e të intervistuarve përfshirë 89% për rastin kur gruaja del pa leje, 91% për kur nuk kujdeset për fëmijët, 88% për refuzimin e marrëdhënieve seksuale, si dhe 88% për djegien e ushqimit, janë përgjigjur se nuk e mendojnë të drejtë që një burrë të rrahë gruan. Po ashtu, 90% e të intervistuarve nuk e shohin të drejtë dhunën kur gruaja debaton me burrin. Pavarësisht nga këto përgjigje, një përqindje e vogël e të intervistuarve ka konsideruar se është e drejtë që burri të përdorë dhunë në këto raste (11% për “kur del pa leje”, 9% për “kur nuk kujdeset për fëmijët”, 8% për “kur refuzon marrëdhënie seksuale” dhe 8% për “kur djeg ushqimin”). Këto rezultate, pavarësisht mendimeve të shumicës që nuk e justifikojnë dhunën, mund të pasqyrojnë ende ekzistencën e disa normave patriarkale që ndikojnë në qëndrimet e disa individëve brenda këtyre komuniteteve.




**FIGURA 60.** A mendoni se është e drejtë për një burrë të rrahë gruan në këto raste?

Pyetja nëse normalizimi i martesës së hershme ka pasoja afatgjata për brezat e ardhshëm ka marrë përgjigje që sugjerojnë njohjen e ndikimit të mundshëm afatgjatë të këtij fenomeni. Në total, 61% e të intervistuarve mendojnë se martesë e hershme ka pasoja afatgjata negative për brezat e ardhshëm, ndërsa 33% janë të mendimit se ajo nuk ka ndikim të tillë. Një përqindje më e vogël (6%) nuk janë të sigurt në lidhje me këtë çështje.




**FIGURA 61.** A besoni se normalizimi i martesës së hershme në komunitetin tuaj ka pasoja afatgjata për brezat e ardhshëm?

Një shumicë prej 58% e të anketuarve mendon se familjet që praktikojnë martesën e hershme janë të vetëdijshme për pasojat e mundshme negative të saj. Ndërkohë, 35% e përgjigjeve sugjerojnë se ato nuk janë të vetëdijshme, ndërsa 7% e të anketuarve nuk kanë një mendim të qartë në lidhje me këtë çështje.



**FIGURA 62.** A mendoni se familjet që praktikojnë martesën e hershme janë të vetëdijshme për pasojat e mundshme negative të saj?


Në lidhje me njohuritë mbi moshën e lejuar me ligj për martesë në Kosovë, 54% e të anketuarve raportuan se janë në dijeni të këtij kufizimi ligjor, ndërsa 46% deklaruan se nuk e dinë ose nuk janë të informuar për këtë informacion. Ky rezultat tregon një nivel të ndryshëm të informimit brenda komunitetit, duke theksuar nevojën për më shumë ndërgjegjësim mbi legjislacionin që rregullon martesat.



**FIGURA 63.** A jeni në dijeni se cila është moshë e lejuar me ligj për lidhjen e martesave në Kosovë?

Përgjigjet e dhëna nga ata që kanë deklaruar se janë të informuar për moshën e lejuar me ligj për lidhjen e martesave në Kosovë, tregojnë një dominim të përgjigjes së saktë, që është 18 vjeç, e cila është e dhënë nga 83% e individëve. Megjithatë, ka edhe disa individë që kanë dhënë moshë të gabuar, përfshirë 1% për moshat 15, 16, 19, 21, dhe 27 vjeç, 2% për moshën 17 dhe 22 vjeç, dhe 7% për moshën 20 vjeç. Ky rezultat reflekton njohuritë e përgjithshme të individëve në lidhje me ligjin për martesën, por gjithashtu tregon se ka ende paqartësi dhe moskuptime rreth moshës minimale të lejuar, që mund të ndikohen nga normat dhe praktikët lokale ose keqinformimi. Sipas Ligjit të Familjes së Kosovës (Ligji Nr. 2004/32), moshë minimale e lejuar për lidhjen e martesës është 18 vjeç, përveç disa përjashtimeve me miratimin e gjykatave kompetente. Kjo tregon se ndonëse shumica e individëve janë të vetëdijshëm për moshën e duhur, ende ekzistojnë disa perceptime të gabuara që mund të lidhen me mungesën e informacionit të saktë ose me ndikimet kulturore dhe shoqërore.


Kur të anketuarit u kërkuan të shkruajnë moshën e lejuar për martesë në Kosovë, rezultatet e ndara sipas nivelit arsimor tregojnë një lidhje të qartë midis arsimit dhe njohurive mbi këtë çështje ligjore. Përqindja e atyre që dhanë përgjigjen e saktë (18 vjeç) rritet ndjeshëm me nivelin arsimor, nga 74% tek ata pa arsimim formal në 93% tek ata me arsim të mesëm të ulët, duke arritur 100% tek ata me arsim të mesëm të lartë apo arsim profesional.



**FIGURA 64.** Shkruani moshën e lejuar me ligj për lidhjen e martesave në Kosovë



Sipas të dhënave, shumica e të anketuarve janë informuar për moshën e lejuar për martesë nga familja (79%), ndërsa një numër i konsiderueshëm ka marrë informacion nga shoqëria dhe miqtë (43%). Më pas, 26% shprehen se janë informuar nëpërmjet shkollës dhe 13% nga mediat, përfshirë TV, radio dhe platformat sociale. Pjesa më e vogël, 6%, ka marrë informacion nga organizatat joqeveritare, ndërsa vetëm 1% kanë përmendur burime të tjera. Këto rezultate sugjerojnë se familja dhe rrjetet shoqërore janë burimet kryesore të informacionit për martesën, ndërsa mediat dhe organizatat joqeveritare luajnë një rol më të vogël në informimin e individëve mbi këtë çështje.



**FIGURA 65.** *Kush ju ka informuar për moshën e lejuar me ligj për lidhjen e martesave?*

Më shumë se dy të tretat e të anketuarve (70%), nuk kanë qenë të informuar që martesat nën moshën 18-vjeçare është e paligjshme dhe mund të ndëshkohet, si për prindërit ashtu edhe për personat madhorë që martohen me të mitur pa leje të gjykatës. Ndërsa 30% e të anketuarve u shprehën se kanë qenë të dijeni për këtë duke treguar nevojën të madhe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit rreth kësaj çështjeje, për të parandaluar martesat e hershme dhe për të siguruar respektimin e të drejtave të fëmijëve.




**FIGURA 66.** *A keni qenë në dijeni që martesat nën moshën 18-vjeçare është e paligjshme, përbën vepër penale dhe mund të ndëshkohet, si për prindërit ashtu edhe për personat madhorë që martohen me të mitur nën moshën madhore (18-vjeçare), pa leje të gjykatës?*

## 1.10 Politikat dhe rekomandimet

Moduli mbi politikat dhe rekomandimet synon të masë nivelin e njohurive dhe përvojave të individëve lidhur me politikat dhe masat për parandalimin e martesave të hershme, si dhe perceptimet e tyre për pasojat dhe mënyrat më efektive për të adresuar këtë fenomen. Gjithashtu, ky modul eksploron qëndrimet e të anketuarve mbi përfshirjen e komunitetit dhe angazhimin e burrave dhe djemve në luftën kundër martesave të hershme.


Në këtë kontekst, më shumë se 90% e të anketuarve nuk janë të informuar për ndonjë masë apo politikë që synon parandalimin e martesave të hershme, ndërsa vetëm 7% kanë treguar se janë të dijeni për ekzistencën e një politike të tillë.

Nga ata që kanë deklaruar se janë në dijeni për masa apo politika që synojnë parandalimin e martesave të hershme, vetëm 1 person ka kërkuar mbështetje/ndihmë për të adresuar martesën e tyre të hershme në polici, e cila iu është ofruar plotësisht nga këta të fundit. Ndërkohë, shumica dërrmuese, 11 persona, nuk kanë kërkuar ndihmë, gjë që mund të tregojë mungesë informacioni mbi shërbimet e disponueshme ose barrierat tjera në qasjen ndaj tyre.



**FIGURA 67.** A jeni në dijeni për ndonjë masë apo politikë që synon parandalimin e martesave të hershme?


Rezultatet tregojnë se tre masat më të mbështetura për parandalimin e martesave të hershme në komunitet rom, ashkali dhe egjiptian sipas vetë atyre janë: mbështetja ekonomike për familjet në nevojë (64%), përmirësimi i qasjes në arsim për vajzat (52%) dhe rritja e ndërgjegjësimit përmes programeve edukative (38%).



**FIGURA 68.** Çfarë mendoni se mund të bëhet për të parandaluar martesat e hershme në komunitetin tuaj?


Vetëm 7% e të anketuarve kanë qenë të përfshirë në ndonjë përpjekje të komunitetit për të parandaluar martesat e hershme, ndërsa shumica dërrmuese, 93%, nuk kanë marrë pjesë në iniciativa të tilla.

Angazhimi i burrave dhe djemve në luftën kundër martesave të hershme shihet si i rëndësishëm nga 49% e të anketuarve, ndërsa 37% nuk e konsiderojnë një faktor kyç. Një pjesë më e vogël, 14%, mbeten të pasigurt. Këto rezultate tregojnë ndasi në perceptime, duke sugjeruar nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rolin që burrat dhe djemtë mund të luajnë në parandalimin e martesave të hershme dhe në ndryshimin e normave shoqërore që e mundësojnë këtë fenomen.




**FIGURA 69.** A keni qenë ndonjëherë i përfshirë në ndonjë përpjekje të komunitetit për të parandaluar martesën e hershme?

Sipas të anketuarve, tri pasojat më të shprehura të martesave të hershme në komunitet, sipas të anketuarve, janë mungesa e mundësive për punësim (42%), ndërprerja e shkollimit (41%) dhe izolimi social i vajzave të reja (36%). Këto gjetje tregojnë se martesat e hershme mund të ndikojnë kryesisht në kufizimin e mundësive arsimore dhe profesionale të vajzave, si dhe në shkëputjen e tyre nga jeta sociale, çka mund të ketë pasojë të gjera në zhvillimin dhe mirëqenien e tyre.



**FIGURA 70.** Cilat mendoni se janë pasojat kryesore të martesave të hershme në komunitetin tuaj?


Shumica e të anketuarve rekomandojnë që fëmijët e tyre të presin moshën madhore (39%) ose të përfundojnë shkollimin dhe të punësohen para martesës (31%). Këto qëndrime tregojnë një prirje drejt sigurimit të pavarësisë dhe stabilitetit përpara krijimit të një familjeje. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme (26%) mbështet mundësinë që fëmijët të martohen në moshë të hershme, nëse dëshirojnë, duke reflektuar prirje të ndryshme brenda komunitetit lidhur me këtë çështje.



**FIGURA 71.** Duke marrë parasysh përvojën tuaj, çfarë do t'u rekomandonit fëmijëve tuaj lidhur me martesën?

Këshillat që prindërit do t'u jepnin fëmijëve të tyre për martesën ndryshojnë ndjeshëm midis burrave dhe grave. Një përqindje më e lartë e burrave (41%) sesa e grave (18%) mbështesin idenë që fëmijët e tyre të mund të martohen në moshë të hershme nëse dëshirojnë. Ky rezultat sugjeron se burrat janë më të hapur ndaj martesave të hershme, ndërsa gratë tregojnë një qasje më të kujdesshme.


Ndërkohë, 40% e grave dhe 36% e burrave rekomandojnë që fëmijët të presin të arrijnë moshën madhore (18+) përpara se të martohen, duke reflektuar një përjasje më pragmatike ndaj martesës. Gjithashtu, një përqindje dukshëm më e lartë e grave (38%) sesa e burrave (17%) theksojnë rëndësinë e përfundimit të shkollimit dhe sigurimit të një pune përpara martesës, gjë që tregon një vetëdije më të madhe të grave për rëndësinë e pavarësisë ekonomike dhe zhvillimit personal para angazhimit në martesë.



**FIGURA 72.** Duke marrë parasysh përvojën tuaj, çfarë do t'u rekomandonit fëmijëve tuaj lidhur me martesën?

\*Ndarja me gjini

Kur të dhënat analizohen sipas grupit etnik, vërehen dallime të rëndësishme në qëndrimet ndaj martesës. Ndërsa një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve në të gjitha grupet mbështet pritjen deri në moshën madhore për martesë, ka dallime në masën e mbështetjes për martesën e hershme dhe përfundimin e shkollimit përpara martesës. Mbështetja për martesën e hershme është më e lartë tek komuniteti rom (39%) dhe më e ulët tek komuniteti ashkali (15%). Ndërkohë, përfundimi i shkollimit dhe punësimi përpara martesës rekomandohet më shumë nga të anketuarit e komunitetit ashkali (46%), krahasuar me komunitetet e tjera.



**FIGURA 73.** Duke marrë parasysh përvojën tuaj, çfarë do t'ju rekomandonit fëmijëve tuaj lidhur me martesën?  
\*Ndarja me grupin etnik

## 2. Gjetjet kryesore nga hulumtimi cilësor

### 2.1 Mostra e realizuar

Në total janë zhvilluar 11 intervista me 14 respondentë nga 11 komuna të Kosovës. Prej tyre, 9 intervista janë realizuar me përfaqësues të Qendrave për Punë Sociale (QPS), një intervistë me përfaqësues të një strehimoreje dhe një intervistë tjetër me Departamentin për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore në nivel komune.

Përveç intervistave, janë organizuar edhe dy fokus-grupe me përfaqësues të organizatave joqeveritare që punojnë në ndërgjegjësimin, parandalimin dhe zvogëlimin e fenomenit të martesave të hershme në Kosovë, QPS-ve, Agjencionit për Barazi Gjinore dhe strehimoreve. Diskutimet u përqendruan në situatën e viktimave të dhunës në familje, me fokus të veçantë te vajzat që janë viktimat e martesave të hershme.

Përmes fokus-grupeve u siguruan gjithashtu informacione për komunat e Mitrovicës dhe Pejës, duke zgjeruar më tej kuptimin mbi sfidat dhe mekanizmat e mbrojtjes që ofrohen në këto raste. Në këtë proces janë përfshirë 13 komuna: Lipjani, Gjlani, Fushë Kosova, Kamenica, Ferizaji, Obiliqi, Podujeva, Vushtrrija, Prizreni, Prishtina, Mitrovica, Peja, dhe Gjakova, si vijon:

| Numri i Intervistave         | 11 intervista me 14 përfaqësues                                                                                |                                                                                                                                              |
|------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Institucionet e intervistuar | 9 Qendra për Punë Sociale (QPS)<br>1 Strehimore<br>1 Departament për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore |                                                                                                                                              |
| Fokus-grupe të realizuara    | FGD 1 (11 pjesëmarrës/e)                                                                                       | FGD 2 (9 pjesëmarrës/e)                                                                                                                      |
|                              | 6 OJQ të përfaqësuara<br>2 Strehimore të Viktimave të Dhunës në Familje<br>Agjencioni për Barazi Gjinore       | 5 OJQ të përfaqësuara<br>1 Shkollë e Mesme e Ulët<br>1 Strehimore të Viktimave të Dhunës në Familje<br>1 QPS<br>1 Zytar/e për Barazi Gjinore |

Të dhënat e mbledhura në terren dhe identiteti i respondentëve në këtë studim mbetet i mbrojtur në përputhshmëri me kodin e etikës, përkatësisht ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale<sup>82</sup>.

## 2.2 Kufizimet e hulumtimit cilësor

Hulumtimi cilësor është përballur me disa kufizime që kanë ndikuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Një nga sfidat kryesore lidhet me sigurimin e të dhënave nga komunat për tri vitet e fundit mbi rastet e martesave të hershme. Mungesa e të dhënave të agreguara, kapacitetet e kufizuara për raportim dhe hezitimi i institucioneve për të ndarë informacione kanë kufizuar qasjen në të dhëna të plota. Si rezultat, vetëm një e katërta e komunave të kontaktuara kanë ofruar të dhëna, duke ndikuar në gjerësinë e analizës cilësore.

Një tjetër kufizim lidhet me mungesën e të dhënave të përditësuara mbi kontaktet e përfaqësuesve të QPS-ve, gjë që ka vështirësuar komunikimin dhe ka ndikuar në pjesëmarrjen e disa komunave. Disa QPS kanë refuzuar ose hezituuar të marrin pjesë në intervista dhe fokus grupe, duke ndikuar në përfaqësimin e tyre në hulumtim. Për më tepër, disa intervista janë zhvilluar në periudha kur përfaqësuesit e QPS-ve po trajtonin raste urgjente, çka ka ndikuar në thellësinë dhe cilësinë e përgjigjeve të dhëna.

Megjithë këto kufizime, të dhënat e mbledhura ofrojnë një pasqyrë të rëndësishme mbi fenomenin e martesave të hershme dhe sfidat institucionale në adresimin e tij.

## 2.3 Fenomeni i martesave të hershme

Analiza e intervistave dhe fokus-grupeve konfirmon se martesa e hershme mbetet një fenomen prezent, por në rënie të dukshme, sidomos gjatë tre viteve të fundit. Ky fenomen është më i përhapur te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, megjithëse ka ende raste edhe në komunitete të tjera, përfshirë shumicën shqiptare. Punonjësit socialë kanë vënë në dukje se martesa e lejuara me vendim gjyqësor, e cila kërkon miratim zyrtar, është bërë gjithnjë e më e rrallë, ndërsa format e bashkëjetesës dhe martesat joformale vazhdojnë të jenë më të zakonshme, shpesh duke mbetur jashtë regjistrimeve institucionale.

Intervistat tregojnë se, ndonëse në të kaluarën martesa e hershme ishte më e përhapur në zonat rurale, tashmë nuk ka një dallim të theksuar mes fshatrave dhe qyteteve. Këtë ndryshim punonjësit socialë e shpjegojnë pjesërisht me zhvendosjen masive të popullsisë në mjedise urbane.

***“Me aq sa na bjen neve me u marrë me raste, nuk ka fort dallim mes fshatit e qytetit. Tash shumica kanë dal e po jetojnë nëpër qytete...”***

Një çështje kryesore e identifikuar nga QPS-të është se ky trend/fenomen i prekë dukshëm më shumë vajzat në krahasim me djemtë. Punonjësit socialë theksojnë se ky fenomen lidhet me faktin që në shumicën e rasteve vajza është më e re në moshë sesa djali apo burri me të cilin martohet, duke rritur gjasat që ato të preken nga martesa e hershme në mënyrë më të madhe sesa djemtë e moshës së tyre. Për më tepër, ata vërejnë se një rast tipik i martesës së hershme përfshin një burrë mbi 18 vjeç që martohet me një të mitur, por ekzistojnë edhe raste ku të dy partnerët janë të mitur, edhe pse këto raportohen më rrallë. Këtë e kanë mbështetur edhe përfaqësuesit/et e strehimoreve dhe OJQ-ve.

<sup>82</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18616>

***“Shumë më e zakonitë është martesë mes një çiftit ku vajza është nën moshën 18 vjeçare e djali/burri është i moshës madhore.”***

Tradicionalisht, si në komunitetin shqiptar ashtu edhe në atë Rom, Ashkali dhe Egjiptian, vajzat janë trajtuar ndryshe nga djemtë për shkak të roleve gjinore, theksojnë punonjësit socialë. Për shumë familje, martesë e vajzave në moshë të re është parë si një mënyrë për të ulur barrën financiare, pasi ato bëhen pjesë e një familjeje tjetër. Ndërkohë, djemtë, si trashëgimtarë të shtëpisë, nuk përballen me të njëjtat pritshmëri. Martesë e hershme e vajzave shpesh justifikohet me idenë se ato “i përkasin derës së huaj” dhe qëndrimi i gjatë në shtëpinë prindërore mund të shihet si barrë apo rrezik për nderin e familjes. Kështu, familjet e arsyetojnë martesën e hershme si zgjedhje ekonomike e sociale, ndërsa për djemtë ajo shihet si mundësi për të siguruar një grua që ndihmon me punët e shtëpisë dhe kujdesin familjar janë shprehur disa nga QPS-të.

***“Vajza cilësohet si mall i derës t’huaj edhe e martojnë ma herët. Kjo është përshtytja e njerëzve - jo mendimi jem. Plus për ma tepër, është përshtypje e komunitetit; çka unë dëgjoj prej tyre. Se ky nuk është mendim i jem. Po pa e trajtu ndryshe (vajzën) kërkush me mend n’kry nuk e lëshon evladin pa i bo 20 vjet prej shpijës.”***

■ Megjithatë, ata theksojnë se shumica e popullsisë me vite ka avancuar dhe është ndërgjegjësuar dukshëm më shumë në krahasim me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të cilët ende me shumë fanatizëm ruajnë praktikën e martesave të hershme mes tyre. Mirëpo, kishte edhe nga ata që theksuan se ndonëse në numër shumë më të vogël, në disa komuna trendi i martesave të jashtëligjshme faktike të vajzave minore ka filluar të rritet edhe në mesin e komunitetit shqiptar.

Lidhur me dallimet në arsyet që çojnë në martesat e hershme ndërmjet komuniteteve përfaqësuesit e QPS-ve kanë treguar se ndërsa tek komuniteti shqiptar martesat e hershme shpesh lidhen me interesin për të siguruar dokumentacion për bashkim familjar në vendet evropiane, apo edhe dëshirat romantike, tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, faktorët kryesorë mbeten tradita dhe mentaliteti që favorizon martesën e vajzave dhe të djemve në moshë të re. Sipas kësaj logjike, vajzat duhet të martohen sa më shpejt, shpeshherë para moshës 15-vjeçare, meqenëse konsiderohet se pas kësaj moshe humbin vlerën si nuse të përshtatshme për martesë, e edhe pse edhe djemtë martohen herët, për ta kjo normë sociale nuk është aq rigorozë.

***“Në komunë tonën asnjë çikë rome sun e gjen të pamartume e 20 vjeçare.”***

Respondentët e fokus-grupeve dhe intervistave në disa raste janë pajtuar se edhe gjendja e rënduar ekonomike kontribon në nxitjen e martesave të hershme në të gjitha grupet shoqërore, por meqë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian jetojnë në standard më të ulët socio-ekonomik, kjo praktikë është më prezente tek ta krahasuar me pjesën tjetër të popullatës ku mirëqenia dhe standardi jetësor është përmirësuar në masë të konsiderueshme. Për më tepër, ata njohin se në të kaluarën, shoqëria kosovare, pa dallime etnike, kishte të njëjtën mendësi falë kushteve të dobëta, mungesës së arsimit dhe ndërgjegjësisë.

***“Mos t’thom, po para 40-50 vjetëve edhe shqiptarët qashtu jemi kanë. Ty mundet me t’u dokë e papranushme me mendu ashtu, ama unë e kam përjetu se jam qasi gjenerate - menxi s’pritshin m’u rritë pak vajza e me qitë prej shpisë, plus e njihshin si rahatllëk këtë sen... Me zhvillimin ekonomik ka ndryshu praktika, se kur familja e ka suguru ekzistencën e ka vendbanim t’mjaftushëm; ka dhoma mjaftushëm - s’e ka kompleks me hjekë çikën prej shpije.”***



Faktor tjetër nxitës i identifikuar të këtij fenomeni në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është mungesa e hapësirës për të jetuar – faktor ky që ndikon në vendimet familjare për martesën e vajzave në moshë të re.

***“Romët edhe janë n’zorr qysh me i hek çikat pi shpije se s’kanë vend. S’kanë hapësirë edhe pajtohen herët me dhon çikën - edhe me 13-14 vjet, me hek pi shpijës me lëshu ni sobë, se djali e bjen nusen e s’kanë ku rrijnë.”***

Intervistat zbulojnë se praktikë e përhapur në këto komunitete është ajo e “shitjes” së vajzave ose pritshmëritë për shpërblim financiar nga familja e dhëndrit në këmbim të dorës së vajzës. Për shumë familje, kjo praktikë përfaqëson një strategji mbijetese për shkak të kushteve të rënda ekonomike. Si rezultat, shumë familje nxisin këto martesë, duke i parë ato si një mënyrë për të siguruar stabilitet financiar të përkohshëm, ose edhe për të respektuar normat tradicionale të komunitetit. Këto perceptime, sipas shumicës së punonjësve socialë dhe disa përfaqësuesve të OJQ-ve janë rrënjësuar në normat tradicionale dhe pasqyrojnë një mungesë të theksuar ndërgjegjësimi mbi pasojat negative të martesës së hershme.

***“Se s’di a e dini, po këta e kanë traditë edhe me marrë pare kur jepin nuse.”***

Megjithëse martesat e hershme, sidomos martesat e lejuara me vendim gjyqësor, janë në rënie, pjesëmarrësit e hulumtimit theksojnë nevojën për masa më të forta nga institucionet dhe OJQ-të për të adresuar format e fshehura të këtij fenomeni. Ata veçojnë rolin e shkollave, sidomos atyre me nxënës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, pasi braktisja e mësimi shpesh sinjalizon raste të martesave të hershme. Përfaqësuesit e OJQ-ve dhe QPS-ve nënvizojnë rëndësinë e edukimit dhe ndërgjegjësimi, duke përfshirë jo vetëm nxënësit, por edhe prindërit, mësuesit dhe komunitetin e gjerë. Po ashtu, sfidimi i normave tradicionale dhe mbështetja socio-ekonomike për familjet në vështirësi janë kyçe për parandalimin e këtij fenomeni.

***“E këtu shkollat duhet me pas’ një plan-program për arsye se janë qendra që punojnë direkt me fëmijët, e derisa të vijnë te QPS-të zakonisht dami veçse ka ndodhë. Prandaj me mujt me parandalu (martesën), se kur vijnë te na zakonisht ajo veçse ka ndodhë.”***

Shumica e QPS-ve nuk kanë punuar me programe për parandalimin e martesave të hershme, por njohin rolin kyç të OJQ-ve përmes trajnimeve, kampanjave dhe ndërgjegjësimi në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Disa OJQ sugjerojnë përfshirjen e gjinekologëve, psikologëve, juristëve dhe punëtorëve socialë në këto iniciativa për të ofruar informacion më të plotë për dëmet e martesave të hershme. Ata theksojnë nevojën për një manual apo material të përbashkët që mund të përdoret nga të gjithë akterët, përfshirë edhe mësimdhënësit. Po ashtu, përfaqësuesit e QPS-ve dhe strehimoreve njohin kontributin e OJQ-ve në mbështetjen e rasteve të martesave të hershme, duke ofruar shërbime që institucionet shpesh nuk kanë kapacitet të ofrojnë.

Gjysma e QPS-ve dhe të gjitha OJQ-të vlerësojnë se edukimi seksual mund të reduktojë numrin e martesave të hershme, por edhe të ndikojë në parandalimin e shtatëzanive të padëshirueshme që shpesh rezultojnë me martesë të hershme.

***“Duhet me u shtu edukata seksuale në shkolla. Duhet me fillu prej klasës së gjashtë, se qatherë na i shohim rritjen e rasteve delekuente. Unë e shoh mëse të nevojshme (futjen e edukatës seksuale në shkollë) se na i këshillojmë vajzat që futen në bashkëjetesë edhe për masat mbrojtëse ama ato duhet me u mbrojtë qysh mos me bo fëmijë deri kur te mrrijnë moshën mardhore, që me mujt me marrë vendime të mirëinformume për lidhjen seksuale dhe planifikimin e fëmijëve.”***

Tutje, intervistat kanë zbuluar tendenca të refuzimit kategorik të disa përfaqësuesve të QPS-ve për përfshirjen e lëndës së edukimit seksual si rezultat i mendësisë së tyre të shfaqur patriarkale e tradicionale të cilët janë në moshë më të shtyer. Ato po ashtu kanë vënë në pah tendencën që refuzimi dhe aversioni ndaj përfshirjes së lëndës së edukatës seksuale të jetë më prezent tek respondentët burra, gjersa tek gratë ekziston një tendencë për ta përqafuar çdo iniciativë që ndërgjegjëson vajzat dhe gratë, përfshirë këtu edhe edukimin seksual.

### ***“Përmbajtja e edukimit seksual veç i stimulon (minorët) ma shumë...”***

Një aspekt i rëndësishëm që u nxjerr në pah gjatë intervistave dhe fokus-grupeve është edhe elementi i dhunës psikologjike dhe i presionit të vazhdueshëm, i cili konsiderohet si një nga efektet anësore më të dëmshme të martesave të hershme, sidomos për vajzat e reja. Disa punëtorë socialë, kryesisht gra, theksojnë se dhuna psikologjike lind shpesh nga pritjet dhe presionet e mjedisve familjare dhe shoqërore, ku vajzat mësohen të pranojnë sjellje që i vendosin nën presion dhe i detyrojnë të përshtaten me role të caktuara.

***“Dhuna psikike ka me egzistuar kur fëmija vajzë, mësohet të prind’it me flet - e m’u çu kur të don. Kur shkon në famije tjetër ka mungesë psikike me i marrë përgjegjësitë në familjen në bashkësi. Mosha nuk i përkon me përgjegjësitë që i merr me martesë. Vet ndërrimi i ambientit i krijon dhunë psikike le mo t’tjerat. Mendoj kanë presione të vazhdueshme...”***

Ky presion i vazhdueshëm, i cili lind nga ndryshimi i ambientit dhe nga normat tradicionale të cilat i imponojnë vajzave një përgjegjësi që nuk i përkon me moshën e tyre, mund të çojë në një rëndim të mirëqenies psikologjike dhe asaj emocionale janë shprehur jo vetëm QPS-të, por edhe OJQ-të e strehimoret. Andaj edhe rekomandojnë ndryshimin e kornizës ligjore në mënyrë që mosha minimale për martesë të vendoset në 18 vjeç, pasi kjo përfaqëson moshën ligjore të plotë të të rriturit.

## **2.4 Zbatueshmëria e ligjeve në praktikë**

Të pyetur se sa janë të zbatueshme në praktikë ligjet dhe masat ndëshkuese, të gjithë përfaqësuesit e QPS-ve pajtohen se, pavarësisht bazës ligjore ekzistuese, zbatimi në praktikë mbetet i mangët dhe shpesh i pamundur. Edhe përfaqësuesit e OJQ-ve, strehimoreve dhe zyreve për barazi gjinore ndajnë këtë shqetësim, veçanërisht për martesat faktike dhe bashkëjetesat, ku ndërhyrja ligjore has në vështirësi. Në disa raste, pala minore mund të presë të mbushë 16 vjeç për një martesë me leje, ndërsa në raste të tjera, edhe pas ndërhyrjes së institucioneve, të rinjtë rikthehen në këto martesë, duke kufizuar efektivitetin afatgjatë të masave institucionale.

***“Kemi pasë rast në 13 vjeçare romë (e komunës tjetër), o martu këtu. Na nuk mujshim me dorëzuar atje e na thanë me dërgu në strehimore. Po e maj mend sa shumë ka qajt, me dënësë. Policia thojke s’un e lojmë të burri - ajo ka nejt të djali 2 muj edhe ai djali kajke. Ata insistojshin që duhën. Të nesërmën masi e kontaktum babën, baba i vajzës erdh në strehimore me e marrë edhe drejt e të burri i saj shkun (te miqt)... - çka me bo na në këto raste?!”***

Shumica e punonjësve socialë raportojnë bashkëpunim të mirë me institucionet për adresimin e martesave të hershme. Ata shpesh kontaktohen nga punonjësit shëndetësorë kur një vajzë e mitur është shtatzënë ose në lindje dhe nga shkollat kur një nxënëse mungon gjatë, duke ngritur dyshime për martesë. Po ashtu, kur policia sinjalizon një rast, ata kanë detyrimin të ndërhyjnë menjëherë për mbrojtjen e vajzës, janë shprehur QPS-të. Megjithatë bashkëpunimi me strehimoret për viktimat e dhunës me bazë gjinore është i

mirë, ndarja e përgjegjësi mbetet sfidë, sidomos për strehimin urgjent të vajzave të larguara nga martesë e hershme. Kjo vështirësi buron nga mungesa e një qendre të specializuar dhe pengesat burokratike në referimin e tyre në strehimoret ekzistuese.

***“Dikur i çojshim n’Prishinë, që mos me i lanë në strehimore të dhunës në familje. Kemi pasë problem ka ni here deri kur janë dhanë pëlqimet, plus ka ni here viktimat nuk pranojshin me shku. Mirëpo, kur strehimorja i ka marrë, i ka trajtu (vajzat) me krejt mundësitë që i kanë. Pra, qato shërbime që i kanë ja u japin edhe atyne, por nuk ka strehimore adekuate (për fëmijë).”***

Një nga sfidat kryesore është se për vajzat nën 16 vjeç, pranimi në strehimore kërkon praninë e nënës ose kujdestarit ligjor, një kusht shpesh i porealizueshëm kur familja nuk mbështet largimin nga martesë e hershme. Drejtuesit e strehimoreve, bazuar në kornizën ligjore, hezitojnë të pranojnë vajza të mitura pa një të rritur përgjegjës, duke detyruar punonjësit socialë të ushtrojnë presion për pranimin e tyre. Megjithatë, sipas të gjithë akterëve të hulumtimit, rastet e refuzimit të vajzave të mitura janë të rralla, ndonëse drejtuesit e strehimoreve e konsiderojnë sfiduese menaxhimin dhe mbështetjen adekuate të këtyre rasteve.

***“E kemi strehu një rast për tre muaj derisa i ka bo 16 vjet, por vajza bojke probleme. Se ajo ish fëmijë ama dojke me e lujt rolin e grave, e nëse ti ke dasht me e marrë nëpër aktivitete të fëmijeve, ajo i ka refuzu aktivitetet e fëmijëve. E në anën tjetër as so kon e pjekun me i bo aktivitetet e grave, i refuzojke edhe shërbimet e psikologës - nuk u përshtatke kërkah...”***

Të gjithë respondentët janë pajtuar se ambientet e përbashkëta të strehimoreve nuk janë të përshtatshme për vajzat e mitura të larguara nga martesë e hershme, pasi ato kanë nevojë të ndryshme nga gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës në familje. Riintegrimi i tyre duhet të fokusohet në rikthimin në shkollë, ndërtimin e një rrethi social të sigurt dhe përfshirjen në aktivitete rehabilituese. Përvojat e rënda të dhunës në shumicën e strehimoreve ekzistuese mund të ndikojnë negativisht në përshtatjen e tyre. Për këtë arsye, shumica e respondentëve theksuan nevojën urgjente për një strehë të dedikuar për këto vajza, me përjashtim të një strehimoreje që raportoi hapjen e Qendrës së Strehimit për Fëmijët në Gjakovë.

## **2.5 Pasojat e martesave të hershme**

Të gjitha palët e përfshira në hulumtim theksojnë se martesat e hershme, veçanërisht ato nën 16 vjeç, sjellin pasoja të rënda fizike, psikologjike dhe sociale për vajzat. Ato shpesh përballen me dhunë, izolim dhe mungesë arsimimi, duke u bërë të varura nga bashkëshortët dhe të privuara nga mundësitë për zhvillim personal e profesional. Edhe pse djemtë përballen me përgjegjësi të papritura ekonomike, vajzat mbeten më të prekura, pasi pritet të kujdesen për familjen, shtëpinë dhe shtatzëninë, shpesh pa mbështetje adekuate.

Në rastet e martesave mes 16-17 vjeç, disa përfaqësues të QPS-ve i shohin vajzat si më të zhvilluara fizikisht dhe mendërisht, por pasojat mbeten të rënda, pavarësisht vlerësimit nga ekspertët. Ata theksojnë se këto vajza, megjithëse pak më të rritura, shpesh nuk kanë pjekurinë emocionale për të përballuar martesën dhe sfidat që ajo sjell, duke u ekspozuar ndaj konflikteve dhe stresit të lartë. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e OJQ-ve e kundërshtojnë kategorikisht martesën nën 18 vjeç, duke argumentuar se asnjë vlerësim nuk mund të justifikojë martesën e një të miture.

Kur martesë e hershme shoqërohet me shtatzëni, pasojat bëhen edhe më të rënda. Sipas QPS-ve, vajzat e mitura nuk janë të gatshme për shtatzëni dhe lindje, duke rrezikuar komplikime shëndetësore. Për më tepër, fëmijët e lindur në këto kushte rriten shpesh në një mjedis të paqëndrueshëm dhe të varfër, me prindër të mitur që nuk mund të ofrojnë mbështetje të mjaftueshme emocionale, financiare apo arsimore.

## 2.6 Dhuna dhe abuzimet seksuale

Mungesa e vetëdijes për të drejtat ligjore dhe qasja e kufizuar në informacion e bëjnë martesën e hershme një cikël izolimi dhe pasigurie, ku vajzat dhe familjet e tyre shpesh nuk e shohin raportimin si opsion. Papunësia dhe përjashtimi social i lënë pa burime ekonomike të pavarura, duke i penguar të largohen nga situatat abusive kanë deklaruar akterë të ndryshëm. Ata janë pajtuar se martesat e hershme shpesh përfundojnë në dhunë në familje. Disa QPS dhe strehimore kanë raportuar se gjatë asistimit të rasteve të dhunës, zbulohet se viktimat ka qenë e martuar herët. Dhuna në këto martesat shkon përtej asaj fizike, duke përfshirë dhunë emocionale, psikologjike, financiare dhe izolim kanë shtuar ata.

***“Dhuna osht element i pashmangshëm i secilës martesë t’hershme, nuk po flas veç për dhunën fizike se ajo vjen e para, po po flas për krejt llojet e dhunës, duke fillu me presionin që familja e burrit jau bon çikave, largimi prej shkolle, shkëputja prej shoqërisë - s’mбетet aty me pasë çika jetë të ndame prej burrit... tani normalisht aty lind konflikti.”***

QPS-të kanë nënvizuar edhe raste kur vajzat nën moshën 16 vjeçare janë përfshirë në martesat faktike të hershme, që kërkojnë nisjen e hetimeve për përdhunim, pasi vajza nuk ka moshën e pëlqimit seksual. Sipas punonjësve socialë, rastet ku vajza është nën 14 vjeç dhe partneri mbi 16 ose 18 vjeç kërkojnë ndërhyrje urgjente dhe masa më të rrepta ndëshkuese. Ndërkohë, për vajzat 14-16 vjeç, ata kanë shprehur mendime të ndryshme, duke theksuar se çdo rast ka specifika që ndikojnë në përcaktimin nëse bëhet fjalë për përdhunim apo jo.

***“Normal që konsiderohet dhunim kur çika s’i ka as 14 vjet t’plota. Për mu osht dhunim edhe nëse çika i ka 16 a 17 vjet, po tash na po flasim me ligj qysh osht...”***

Kështu në rastet kur vajza mund të jetë pajtuar për aktin seksual, apo edhe ta ketë inicuar ndonjë veprim shtytës mbrohet qëndrimi nga disa zyrtarë të QPS-ve se rasti nuk ka elemente të mjaftueshme për tu cilësuar si përdhunim.

***“Nuk pajtohna me dispozitën se vajza nuk e ka pjekurinë e duhur, përderisa ajo me dëshirë kryen marrëdhënie intime. Vajza ka deklaruar, une vet e kom thirrë (djalin)... Vajza 14 e pak vjeçare ka sjellë partnerin, prokuroria e vlerëson dhunim se osht nën moshë, por ajo s’ka pasë as dhunë, as presion bile e ka inicuar vet. Qysh m’u konsideru kjo gja dhunim?! Une kom lobu mos me denu djalin”***

Ndërkaq OJQ-të e përfshira në hulumtim kanë shfaqur qëndrime më kundërshtuese krahasuar me deklaratat paraprake. Intervistat dhe fokus grupet theksuan mungesën e një interpretimi të unifikuar ligjor, veçanërisht nga QPS-të, dhe sfidat që kjo sjell. Këto bëhen edhe më të vështira për t’u menaxhuar kur rastet përfshijnë edhe shtatzëni të vajzave minore.

***“Na ka lajmëru gjinekologjia për një çikë 14 vjeçare që ish shku me lindë. Prokuroria ja nisi hetimet, po nuk e di çka u bo, se fëmija erdh n’jetë e na duhet me kqyrë me marrë parasysh edhe ma t’mirën për fëmijën.”***

Në raste të tilla, prokuroria, gjykata, prindërit dhe punonjësit socialë shpesh përqendrohen te interesi i fëmijës së sapolindur ose që pritët të vijë në jetë, duke rezultuar në ndëshkime më të ulëta ose

mosndëshkueshmëri për kryerësit e veprës penale janë shprehur përfaqësuesit/et e QPS-ve. Zyrtarët për barazi gjinore dhe OJQ-të kanë ngritur shqetësimin se kjo praktikë lehtëson përsëritjen e fenomenit, duke e bërë martesën e hershme një rreth vicioz.

Sipas OJQ-ve, për të siguruar një zbatim më efektiv të ligjeve dhe mbrojtjen e vajzave nga dhuna dhe abuzimi, është thelbësore një qasje e integruar. Kjo përfshin ngritjen e vetëdijes në komunitete, forcimin e mekanizmave të raportimit dhe përmirësimin e kapaciteteve institucionale për të trajtuar dhunën me bazë gjinore. Vetëm përmes këtyre masave vajzat, veçanërisht ato nga komunitetet e marginalizuara, mund të kenë mbrojtjen dhe mbështetjen që u takon me ligj.

## 2.7 Sfidat me të cilat përballen QPS-të në trajtimin e rasteve të martesave të hershme

Përfaqësuesit/et e QPS-ve kanë shpjeguar se mungesa e departamenteve të specializuara dhe burimeve të mjaftueshme njerëzore, teknike e financiare e bën të vështirë menaxhimin efektiv dhe prioritar të rasteve që kërkojnë ndërhyrje urgjente. Struktura aktuale organizative dhe numri i ulët i punëtorëve të licencuar socialë krijojnë mbingarkesë, pengojnë monitorimin afatgjatë dhe ulin cilësinë e shërbimeve. Si pasojë, fëmijët dhe të miturit, veçanërisht në raste të ndjeshme si martesa e hershme, mbeten pa mbrojtje adekuate. Mungesa e mjeteve të transportit dhe fondeve për vizita në terren përkeqëson situatën, duke pamundësuar ndjekjen e rregullt të rasteve – një prej kritikave kryesore të ngritura edhe nga OJQ-të e përfshira në këtë hulumtim.

## 3. Gjetjet kryesore nga të dhënat e siguruar nga Policia e Kosovës 2022-2024

Nga policia e Kosovës, është kërkuar përmes emailit disa herë sigurimi i të dhënave lidhur me martesat e hershme dhe rastet e inicimit të ndonjë procedure penale lidhur me rastet e tilla. Sipas një përgjigjeje zyrtare të Divizionit përkatës I Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, të datës 24.02.2024, të dërguar përmes emailit, po citoj me sa vijon: “DDPB – 05/1 – 101/2005, Ju njoftoj se martesa e hershme mund të regjistrohet vetëm në rastet kur ndodhin shkelje të ligjit, si për shembull dhuna në familje, ose kur është e nevojshme të ndërhyjnë autoritetet për mbrojtjen e të miturëve. Kështu, gjatë vitit 2024, kemi pasur **një rast** të bashkëjetesës nën moshën 16 vjeçare në komunitetin ashkali”.

Nga kjo shihet një diskrepancë e thellë në mes të pjesës së hulumtimit të mësipërm dhe të dhënave të policisë, ku shihet se mungojnë të dhëna të sakta dhe nuk ka raportime të këtyre rasteve, e rrjedhimisht as gjurmim, zbulim dhe hetim të mirëfilltë dhe as zbatim të ligjit sa duhet nga ana e institucioneve ligj zbatuese, duke mos përjashtuar as mungesën e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe të qytetarëve me policinë sa do duhej të ishte. Përmendet vetëm një rast në vitin 2024, ndërsa për vitin 2022 dhe 2023 nuk përmendet asnjë rast i trajtuar nga ana e policisë, e i cili ka të bëjë me martesat e hershme në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Kjo mungesë e të dhënave tregon nevojën për përmirësimin e mekanizmave të raportimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve. Po ashtu, është thelbësore fuqizimi i kapaciteteve të Policisë për identifikimin proaktiv të rasteve dhe trajnimit të zyrtarëve policer për ndjeshmërinë dhe ndërlkueshmërinë e martesave të hershme, veçanërisht në komunitete të marginalizuara që janë object i këtij hulumtimi.

# TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET

## 1. TË GJETURAT

### 1.1 Të përgjithshme:

Siç shihet nga ky hulumtim, Republika e Kosovës ka legjislacionin shumë të avancuar dhe në pajtim me standardet më të larta evropiane dhe ndërkombëtare edhe në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në përgjithësi, duke përfshirë edhe martesat e hershme, në veçanti. Megjithatë, një nga problemet që është identifikuar ka të bëjë me zbatim të pamjaftueshëm të legjislacionit, kapacitete të pamjaftueshme profesionale dhe institucionale për trajtimin e fenomenit të martesave të hershme, si dhe mungesë koordinimi të mirëfilltë midis palëve të përfshira në hulumtimin, parandalimin dhe raportimin e fenomenit të martesave të hershme.

Martesat e hershme janë fenomen shqetësues, prezent në Republikën e Kosovës, si pasojë e përjashtimit dhe diskriminimit nga shoqëria të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në përgjithësi, në veçanti vajzave dhe grave. Si pasojë e këtij përjashtimi dhe për arsye tjera socio-ekonomike, këto komunitete shpesh e shohin martesën e hershme si mjet stabiliteti dhe mbijetese. Megjithatë, kjo praktikë cenon të drejtat elementare të fëmijëve dhe autonominë e tyre për të vendosur për fatin e jetës së tyre në moshën madhore, kur janë të vetëdijshëm për të kuptuar të drejtat dhe detyrimet e tyre, duke përfshirë edhe përgjegjësitë martesore.

Ajo që shihet pas gjitha vlerësimeve të bëra në këtë hulumtim është edhe fakti se ka ndjeshmëri të pamjaftueshme lidhur me fenomenin e martesave të hershme të fëmijëve të këtyre komuniteteve, si nga institucionet, mediat, e gjithashtu edhe shoqëria civile në përgjithësi. Ndërgjegjësimi i mediave dhe trajnimi i tyre për mënyrën e raportimit të përshtatshëm për këto çështje është jetik. Po ashtu, ka munguar vullneti i duhur për të hartuar politika të mirëfillta dhe të zbatueshme për të trajtuar me ngulm çrrënjosjen e segregacionit dhe diskriminimit ndaj këtyre komuniteteve, që e bën martesën e hershme një mekanizëm mbijetese.

### 1.2 Nga hulumtimi:

Studimi i kryer me të miturit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë ka sjellë në pah një sërë të dhënash të rëndësishme mbi ndërprerjen e arsimit, njohuritë dhe qëndrimet ndaj martesës së hershme, si dhe ndikimin e saj në individ dhe komunitet. Bazuar në rezultatet e mbledhura nga të dhënat e vetëraportuara nga anketa me të mitur të grupmoshës 13-17 vjeç, një pjesë e konsiderueshme e të rinjve të



intervistuar e ndërpret shkollimin në moshë të hershme për shkak të mungesës së interesit dhe problemeve financiare, me ndërprerjen më të theksuar në nivelet e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët.

Sipas të dhënave të anketës, martesat e hershme vazhdojnë të mbështeten në disa segmente të këtyre komuniteteve, pavarësisht njohurive të kufizuara për pasojat ligjore dhe sociale që ato sjellin. Një pjesë e madhe e të anketuarve nuk janë të informuar mbi moshën ligjore për martesë dhe shprehin shqetësime për ndikimin negativ të këtyre martesave në shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve. Për më tepër, dhuna në familje, të lidhur ngushtë me martesat e hershme, raportohet si një problem i vazhdueshëm që ndikon negativisht në jetën e të rinjve të martuar.

Për të adresuar këto sfida, të anketuarit sugjerojnë masa të ndryshme si përmirësimi i qasjes në arsim për vajzat, mbështetja ekonomike për familjet në nevojë, dhe rritja e ndërgjegjësimit përmes programeve edukative. Këto sugjerime pasqyrojnë perceptimin e tyre mbi rolin e arsimit dhe stabilitetit ekonomik në reduktimin e martesave të hershme. Në bazë të këtyre gjetjeve, mund të konstatohet se ekziston një ndërgjegjësim i lartë për nevojën e ndryshimeve strukturore dhe kulturore për të mbrojtur të rinjtë nga këto praktika.

Nga ana tjetër, hulumtimi i realizuar me të rriturit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët janë martuar para moshës 18 vjeç, ofron një pasqyrë mbi përvojat dhe faktorët që kanë ndikuar në këto martesë. Ndërsa një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve të kësaj grupmoshe e perceptojnë martesën si zgjedhje personale, normat tradicionale, presioni familjar dhe pritshmëritë gjinore vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në vendimmarrje. Dallimet gjinore janë të dukshme, ku gratë raportojnë më pak autonomi në vendimin për martesë dhe përballen më shpesh me ndikime të jashtme, veçanërisht nga babai apo familja e zgjeruar.

Martesa e hershme ka ndikime të drejtpërdrejta edhe në arsim e ekonomi, veçanërisht për gratë. Të gjitha gratë që ishin të regjistruara në shkollë në momentin e martesës e kanë ndërprerë atë, ndërsa tek burrat kjo përqindje është më e ulët. Në tërësi, shkalla e ulët e arsimimit sugjeron se martesat e hershme mund të kufizojnë mundësitë për zhvillim personal dhe profesional, veçanërisht për gratë, duke krijuar një cikël të vazhdueshëm të pabarazisë dhe varësisë ekonomike.

Sa i përket punësimit, një pjesë e madhe e të anketuarve shprehen se aktualisht janë të papunë ose shtëpiakë, me shumë pak përfaqësim në tregun formal të punës. Për më tepër, për disa individë, situata ekonomike është përkeqësuar pas martesës, duke reflektuar sfidat financiare me të cilat përballen çiftet e reja që martohen herët dhe kanë kufizime në mundësitë e tyre për punësim dhe të ardhura të qëndrueshme. Përgjegjësitë ekonomike pas martesës gjithashtu dallojnë sipas gjinisë, me burrat që raportojnë më shumë presion për të punuar për të mbajtur familjen.

Njohuritë mbi ligjet që ndalojnë martesën e hershme janë të kufizuara, ndërsa ndërgjegjësimi mbi pasojat e saj mbetet i ulët, si në nivelin familjar ashtu edhe në atë komunitar. Për më tepër, më shumë se 90% e të anketuarve nuk kanë informacion mbi ndonjë politikë ose masë për parandalimin e këtij fenomeni. Këto gjetje tregojnë nevojën për ndërhyrje institucionale, përmirësim të qasjes në arsim, rritje të ndërgjegjësimit mbi pasojat e martesës së hershme dhe angazhim më të madh të komunitetit në mbrojtjen e të drejtave të vajzave dhe grave të reja.

### 1.2.1 Nga pyetësi me të mitur (13-18 vjeç):

- Një pjesë e konsiderueshme, 37% e të anketuarve të kësaj grupmoshe, raportojnë se nuk vijnë arsim në momentin e intervistimit të tyre. Shumica e këtyre ndërprerjeve, 55%, raportohet se janë për shkak të mungesës së interesit, ndërsa 34% e ndërprerjeve janë rezultat i problemeve financiare, duke treguar një nevojë të madhe për mbështetje financiare për familjet në këto komunitete.
- Sa i përket njohurive ligjore për martesën, 44% e të anketuarve nuk janë të informuar mbi moshën ligjore për martesë në Kosovë, një statistikë që shpalos një mangësi në ndërgjegjësimin e të rinjve. Kjo mungesë informimi dallon në bazë të grupit etnik dhe nivelit të arsimit, me disa grupe që tregojnë nivele më të larta të ndërgjegjësimit krahasuar me të tjerët.
- Rreth 63% e pjesëmarrësve në studim besojnë se arsimi ka një rol të rëndësishëm në parandalimin e martesave të hershme, ndërsa një tjetër 32% janë të mendimit të kundërt. Kjo tregon se edukimi është i perceptuar si një faktor kyç në formimin e qëndrimeve dhe zgjedhjeve personale.
- Martesat e hershme janë njohur si një pengesë serioze për zhvillimin personal dhe profesional të individëve, me 64% të të anketuarve që i shohin ato si të dëmshme. Kjo vë në pah nevojën për ndërhyrje për të ndryshuar perceptimet dhe për të ofruar alternativa më të mira për të rinjtë.
- Në lidhje me mbështetjen e këtij fenomeni nga rrethi ku jetojnë, 53% e të anketuarve tregojnë se martesat e hershme nuk mbështeten nga komunitetet e tyre, një shenjë se qëndrimet po ndryshojnë gradualisht kundër kësaj praktike.
- Dhuna në familje, sidomos ajo fizike, ka qenë një fenomen i raportuar në 20 raste nga pjesëmarrësit në studim, duke treguar për pasojat e martesave të hershme në stabilitetin familjar dhe mirëqenien personale.
- Për të luftuar martesat e hershme, 49% e të anketuarve sugjerojnë se mbështetja ekonomike për familjet është kritike, ndërsa 37% e theksojnë si të rëndësishme përmirësimin e qasjes në arsim për vajzat, duke treguar se arsimi dhe mbështetja financiare janë mjete kyçe në parandalimin e kësaj praktike.

### 1.2.2 Nga pyetësi me të rritur (18-40 vjeç):

- Martesat e hershme në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian kanë ndodhur kryesisht në moshën 16-18 vjeç, me 56% të të anketuarve që raportojnë se janë martuar në moshën 17 vjeç dhe 29% në moshën 16 vjeç.
- Vendimarrja për martesën shpesh ndikohet nga familja, veçanërisht për gratë. Ndërsa 60% e të anketuarve raportuan se e morën vetë vendimin për martesë, babai ishte vendimarrës për 30% të tyre, me ndikim më të madh tek gratë.
- Mungesa e informacionit mbi martesën është e përhapur, pasi 68% e të anketuarve ndihen se nuk kishin informacion të mjaftueshëm përpara se të martoheshin. Kjo është veçanërisht e theksuar tek gratë, ku 75% raportojnë mungesë informacioni.
- Arsimimi ndikohet ndjeshëm nga martesat, sidomos për gratë. Të gjitha gratë që ishin të regjistruara në shkollë në momentin e martesës raportuan se e ndërprejnë atë, ndërsa vetëm 1 nga 8 burrat pati të njëjtën përvojë.
- Përgjegjësitë ekonomike pas martesës ndryshojnë sipas gjinisë, me 47% të burrave që raportojnë se u detyruan të punojnë për të mbajtur familjen, ndërsa vetëm 10% e grave përjetuan të njëjtën situatë.
- Normat dhe presionet shoqërore luajnë një rol të rëndësishëm në martesat e hershme, sipas perceptimeve të të anketuarve. 66% besojnë se vajzat janë më të sigurta në martesë, dhe 41% e lidhin martesën e hershme me ruajtjen e nderit familjar. Ky presion perceptohet si më i lartë nga të anketuarit në zonat rurale.
- Zgjedhja personale dhe normat tradicionale janë ndër arsyt kryesore për martesën e hershme. Shumica e të anketuarve (47%) raportojnë se martesat ishin zgjedhja e tyre, ndërsa 45% e lidhin atë me zakonet. Faktorë të tjerë si besimet fetare, mungesa e shkollimit dhe presioni familjar gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm.



- Njohuritë mbi ligjin që ndalon martesat e hershme janë të kufizuara, pasi 70% e të anketuarve nuk ishin të informuar se martesa nën moshën 18 vjeç pa leje gjyqësore është e paligjshme dhe e dënueshme.

Ndërgjegjësimi dhe politikat për parandalimin e martesave të hershme janë të dobëta, pasi më shumë se 90% e të anketuarve nuk ishin në dijeni të ndonjë mase apo politike për të parandaluar këtë fenomen, duke theksuar nevojën për ndërhyrje më të forta institucionale dhe komunitare.

## 2. REKOMANDIME

### 2.1. Për institucionet e administratës shtetërore:

- Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe legjislacionit të ri gjithëpërfshirës që synon harmonizimin e kuadrit ligjor të Republikës së Kosovës me standardet e Konventave ndërkombëtare, sidomos në plotësimet dhe ndryshimet e reja të propozuara në ligjet që gjenden në proces të rishikimit, ku duhet të specifikohen edhe aspekte që ndalojnë martesat e hershme dhe martesat nën moshën madhore, të mbështetura edhe në dokumentet ekzistuese strategjike. Këto politika duhet të forcojnë masat për luftimin e diskriminimit, të garantojnë arsimim të detyrueshëm dhe cilësor për të gjithë fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe të ofrojnë mbështetje sociale të qëndrueshme për të parandaluar martesat e hershme dhe për të fuqizuar rolin e vajzave dhe grave të reja në këto komunitete;
- Fuqizimi i masave ligjore dhe ndëshkuese për prindërit dhe personat që mundësojnë martesat e fëmijëve;
- Krijimi i qendrave të këshillimit për edukimin e prindërve dhe orientimin e të rinjve në karrierë;
- Mbështetja me bursa dhe fonde për vajzat e rrezikuara nga martesa e hershme për të ndjekur arsimin e mesëm dhe të lartë do të ishte një factor shumë i rëndësishëm dhe me këtë shkaku ekonomik i martesave të hershme do të zvoglohej dhe shkollimi do të ndikonte edhe në ndryshimin e praktikave të dëmshme;
- Rritja e bashkëpunimit me organizatat vendore dhe ndërkombëtare për të implementuar programe të edukimit dhe fuqizimit të vajzave dhe grave;
- Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe integritit social të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, përmes politikave të zhvillimit urban dhe social;
- Zgjerimi i kapaciteteve të QPS-ve dhe trajnimi adekuat i zyrtarëve për ofrimin e shërbimeve psikologjike dhe ligjore për viktimat;
- Krijimi i strehimoreve specifike për vajzat që janë viktimat të martesave të hershme dhe ofrimi i shërbimeve përkatëse të specializuara, në të gjitha rastet kur viktimat duhet të largohet nga ambienti familjar dhe të merr trajtimet dhe shërbimet adekuate.
- Monitorimi dhe raportimi vjetor i progresit lidhur me zbatimin e politikave për parandalimin e martesave të hershme.

### 2.2. Për organet e hetuesisë dhe gjyqësisë:

- Të zbatohet me rigorozitet legjislacioni në fuqi, me theks të veçantë pjesa e dispozitave që i referohen parandalimit dhe trajtimi adekuat i rasteve të martesave të hershme, sipas dispozitave përkatëse;
- Interpretimi i dispozitave kushtetuese dhe ligjore në pajtim me vendimet e GJEDNJ-së nga ana e gjykatave vendore në vendimet e tyre, bazuar në nenin 53 të Kushtetutës;

- Parandalimi në mënyrë proaktive i martesave të hershme përmes bashkëpunimit dhe koordinimit me të gjithë akterët dhe komunitetet, përmes veprimeve hetimore të policiës dhe prokurorisë. Kjo do të shërbente si preventivë edhe për rastet tjera potenciale.
- Gjykatat duhet të ndërmarrin veprime për anulimin e martesave të dëmshme, përkatësisht largimi i fëmijëve nga martesat e hershme, kur plotësohen kushtet ligjore dhe në rastet kur një gjë e tillë konsiderohet më e arsyeshme, pas referimit të **rasteve në gjykatë**. Gjithashtu gjykatat duhet të **kujdesen për detyrimin e organeve përkatëse për** ofrimin e shërbimeve mbështetëse për këta fëmijë për ofrimin e shërbimeve sociale, familjare dhe shëndetësore, si dhe minimizimi i pasojave të tyre.
- Gjykatat duhet të vlerësojnë secilin rast veç e veç për mundësinë e legalizimit të martesave të hershme, kur ato janë lidhur mbi moshën 16 vjeçare, aty ku plotësohen kushtet ligjore dhe **nëse vlerësohet se kjo formë është në interesin më të mirë të tyre**;
- Mbështetja e gjithanshme e viktimave të martesave të hershme dhe ofrimi i ndihmës juridike falas në çdo procedurë sipas detyrës zyrtare, pasi që shumë nga fëmijët që janë viktimë të **martesave të hershme, mund të mos kenë njohuri për të drejtat e tyre dhe as për organet kompetente të cilave ato mund t'iu drejtohen** për ofrimin e mbështetjes përkatëse;
- Ndryshimi i perceptimit dhe zbatimi më konsekuent i ligjit nga ana e organeve të zbatimit të ligjit si dhe gjyqësorit, por edhe përpjekje për të mos u ndikuar nga zakonet, traditat dhe kulturat dhe refuzimi i të drejtave zakonore të **komuniteteve**, por zbatimi i ligjeve në vendimet e tyre;
- Akademia policore, Akademia e Drejtësisë, Qendra Trajnuese e Odës së Avokatëve dhe mekanizmat tjerë institucionalë dhe shoqërorë duhet të përditësojnë kurrikulat e trajnimeve mbi anti-diskriminimin, barazinë gjinore, veprat penale kundër integritetit seksual dhe specifikisht problematikën e martesave të hershme;
- Policia dhe Prokurorët të kenë rol më aktiv në çështjet familjare dhe parandalimin e martesave të hershme përmes ndjekjes penale ex-officio, nga çfarëdo burimi i informacionit, duke përfshirë edhe median dhe rrjetet e ndryshme sociale;
- Të sigurohet se avokatët njohin dhe janë në gjendje të mbrojnë të drejtat e fëmijëve nga martesa e hershme;
- Të merren masa dhe veprime urgjente lidhur me rastet e martesave nën moshë dhe të **ketë koordinim dhe bashkëveprim me të gjithë mekanizmat shtetërorë** të sistemit të drejtësisë dhe administratës shtetërore, si dhe monitorimin nga shoqëria civile të rasteve që kanë të bëjnë me martesat e hershme me qëllim të parandalimit, mbrojtjes, luftimit, si dhe reintegrimin e viktimave të këtij fenomeni dhe eliminimin sa më shumë që është e mundur të pasojave të tyre.

### 2.3. Për shoqërinë civile dhe organizatat për mbrojtjen e të drejtave të vajzave dhe grave:

- Organizimi i fushatave brenda komuniteteve për të debatuar çështjen e martesave të hershme, e në veçanti të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Ngritja e vetëdijes të gratë dhe vajzat për të luftuar këtë praktikë me anë të edukimit dhe fuqizimit ekonomik;
- Mbështetja e institucioneve për krijimin dhe funksionalizimin e mekanizmave të posaçëm për raportimin dhe hetimin e rasteve të martesave të hershme dhe ndërmarrjen e veprimeve hetimore dhe gjykimin e rasteve, duke përfshirë edhe zbatimin e sanksioneve penale;
- Ofrimi i trajnimeve profesionale për gratë dhe vajzat, për vetëdijësimin e tyre për shmangjen e martesave të hershme, nxitjen e shkollimit të tyre dhe për t'i ndihmuar ato të krijojnë pavarësi ekonomike;
- Përfshirja e profesionistëve të të gjitha fushave, në përpjekje për të ndryshuar mentalitetin rreth martesave të hershme dhe eliminimin e traditave dhe kulturave që janë në kundërshtim me ligjin.

## 2.4. Organizatat ndërkombëtare dhe donatorët:

- Koordinimi ndër-institucional për mbështetjen financiare dhe teknike të programeve që kanë në fokus parandalimin e martesave të hershme është i domosdoshëm;
- Fuqizimi i organizatave që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e komuniteteve të marginalizuara, përmes mbështetjes së projekteve konkrete të ndërhyrjes në jetën e komuniteteve të prekura nga martesat e hershme;
- Implementimi i projekteve pilot për të ofruar alternativa për vajzat që rrezikohen nga martesa e hershme, përmes edukimit dhe mundësive ekonomike.

## 2.5. Mediat dhe vetëdijësimi:

- Media dhe fushatat informuese të përdoren për promovimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të fëmijëve në veçanti, duke i informuar komunitetet se lidhja e fejesës nuk krijon detyrim ligjor që domosdoshmërisht duhet edhe të lidhet martesa, ndërsa martesa e hershme e lidhur me detyrim dhe pa pëlqimin e bashkëshortëve duhet të parandalohet;
- Trajnimi i gazetarëve dhe mediave mbi gjurmimin, hulumtimin, gjetjen dhe raportimin e duhur të martesave të hershme;
- Trajnimi i gazetarëve mbi etikën e raportimit dhe mbrojtjen e privatësisë së viktimave të martesave të hershme.

## 2.6. Përpjekjet brenda komuniteteve:

- Përkushtimi i vetë komuniteteve dhe liderëve të tyre për të promovuar edukimin dhe pavarësinë ekonomike të grave dhe vajzave;
- Shmangia e presionit familjar dhe të komunitetit mbi vajzat e reja dhe djemtë e rinj për lidhjen e martesës së hershme;
- Zhvillimi i programeve të ndryshme të mentorimit, ku gratë dhe vajzat e suksesshme brenda komunitetit ofrojnë këshilla dhe ndihmojnë të rejat dhe të rinjtë për domosdoshmërinë e shmangies së martesave të hershme;
- Ofrimi i mbështetjes institucionale për organizimin e grupeve mbështetëse për fëmijët në përgjithësi, ndërsa për vajzat dhe familjet e tyre, në veçanti, për të ofruar alternativa dhe ndihmë për të ndërtuar një të ardhme, ku martesat e hershme do të mbeten pjesë e historisë së kaluar të dhimbshme të këtyre komuniteteve.

## 2.7. Qasja e lehtë në informacione, ndihma juridike dhe këshillimi falas, si dhe përditësimi i të dhënave statistikore lidhur me martesat e hershme

- Krijimi i qendrave të këshillimit familjar, paramartesor dhe për rastet e shkurorëzimit, për t'i informuar çiftet e reja për përgjegjësitë dhe ndalesat e martesave të hershme, përfshirë edhe sanksionet penale, si dhe mbi të drejtat dhe detyrimet martesore për ata që janë të moshës madhore;
- Të dhënat mbi martesat e hershme të të dy gjinive, si dhe për rastet e pabarazisë gjinore duhet të jenë të përditësuara dhe të harmonizuara mes institucioneve si Agjencia e Statistikave të Kosovës, policisë, prokurorisë, gjykatave, shërbimeve arsimore, shërbimeve shëndetësore, shërbimeve sociale, si dhe akterëve tjerë institucional dhe shoqërisë civile.

## **2.8. Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë së arsimit, ndërgjegjësimi ligjor, fuqizimi i mekanizmave, mbështetja ekonomike, ndryshimi i normave shoqërore dhe promovimi i barazisë gjinore**

### **A) Përmirësimi i qasjes dhe ngritja e cilësisë në arsim**

- Sigurimi i një mjedisi adekuat në shkolla, duke krijuar një ambient miqësor që nuk nxit dhe nuk favorizon diskriminimin dhe ku nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ndihen të integruar, duke shmangur veçimin në klasa;
- Futja e më shumë njësive mësimore për edukimin mbi të drejtat e fëmijëve dhe barazinë gjinore në kurrikulën e MASHTI-t, të cilat duhet të zbatohen nga ana e shkollave me përpikmëri;
- Zhvillimi i trajnimeve për mësuesit lidhur me antigjipsizmin si dhe për parandalimin dhe pasojat e ngacmimeve seksuale të nxënësve;
- Edukimi lidhur me pasojat ligjore, shëndetësore dhe sociale të martesave të hershme, duke përmirësuar edhe kurrikulat shkollore, si dhe përfshirja e shkollave në parandalim dhe ndërgjegjësim;
- Investimi në infrastrukturën arsimore në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për të përmirësuar kushtet dhe tërheqjen e nxënësve në shkolla;
- Zhvillimi i programeve motivuese dhe bursave për të mbështetur familjet në nevojë dhe për të zvogëluar arsyet ekonomike që çojnë në martesë të hershme;
- Sigurimi i mbështetjes për vajzat dhe gratë e reja që të vijnë shkollimin pas martesës;
- Rritja e programeve edukative në shkolla mbi të drejtat e fëmijëve, ndikimet e martesës së hershme dhe rëndësinë e arsimit.

### **B. Rritja e ndërgjegjësimi dhe edukimit ligjor**

- Organizimi i sesioneve të ndërgjegjësimi për të rinjtë dhe komunitetin mbi moshën ligjore për martesë dhe pasojat ligjore të martesave të hershme;
- Bashkëpunimi me liderët e komuniteteve dhe shkollat për të integruar edukimin ligjor dhe të drejtat civile në kurrikulat shkollore;
- Rritja e informimit të qytetarëve mbi ligjin që ndalon martesën nën moshën 18 vjeç dhe ndëshkimet për shkelësit;
- Organizimi i fushatave të informimit për prindërit dhe komunitetin mbi pasojat afatgjata të martesës së hershme, duke përfshirë ndikimet në arsim, ekonomi dhe mirëqenie;
- Promovimi i historive të suksesit të individëve që kanë vijuar arsimin dhe karrierën për të sfiduar normat shoqërore që mbështesin martesat e hershme.

### **C. Fuqizimi i mekanizmave ligjorë dhe zbatimi i politikave**

- Fuqizimi i institucioneve për të identifikuar dhe trajtuar rastet e martesave të hershme, duke përfshirë angazhimin e shkollave, shërbimeve sociale dhe organizatave joqeveritare, duke i fuqizuar ato, me theks të veçantë kapacitetet e pamjaftueshme të QPS-ve dhe trajnimin e punëtorëve social;
- Thëllimi i bashkëpunimit mes institucioneve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile për të parandaluar dhe adresuar martesat e hershme në komunitet.

### **D. Mbështetje sociale dhe ekonomike për vajzat dhe familjet**

- Krijimi i programeve të trajnimit profesional dhe mundësive të punësimit për gratë që janë martuar në moshë të hershme, për të ndihmuar në pavarësinë e tyre ekonomike;
- Ofrimi i mbështetjes psikologjike dhe sociale për gratë dhe vajzat që përjetojnë presion për martesë ose janë martuar në moshë të hershme.

#### **E. Promovimi i barazisë gjinore dhe ndryshimi i normave shoqërore**

- Përfshirja e programeve që fuqizojnë vajzat përmes arsimit, trajnimeve për aftësi jetësore dhe mbështetjes për pavarësi ekonomike;
- Përfshirja e djemve dhe burrave në programe edukative për të sfiduar stereotipat gjinorë dhe për të promovuar respektin dhe barazinë gjinore;
- Angazhimi i liderëve komunitarë dhe fetarë në promovimin e normave që mbështesin arsimimin dhe fuqizimin e vajzave, në vend të martesës së hershme.
- Organizimi i forumeve të diskutimit me prindër, të rinj dhe anëtarë të komunitetit për të sfiduar perceptimet se martesa e hershme është një zgjidhje e favorshme për vajzat.
- Krijimi i rrjeteve të mbështetjes për vajzat dhe gratë e reja, për t'u dhënë atyre mundësi të ndajnë përvojat dhe të marrin këshillim nga profesionistët.

Përfundimisht, mund të thuhet se zgjidhja për këtë problem nuk është e thjeshtë, por përmes reformave dhe investimeve ngritjen e cilësisë në arsim, avokim, fuqizimit ekonomik, reforma ligjore dhe institucionale, martesat e hershme mund të zvogëlohen në masë të madhe, në afatmesme, si dhe mund të eliminohet si praktikë e përhapur brenda komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në një periudhë më të gjatë kohore, nëse vazhdohet me ndërgjegjësim dhe zbatim më të mirë të ligjit.

# REFERENCAT

## I. Libra të konsultuar:

1. Barbara Stark, *"E drejta ndërkombëtare familjare: hyrje"*, publikuar nga Ashgate Publishing Limited, Britani të Madhe, 2013;
2. Barbara Stark, *"E drejta ndërkombëtare familjare: hyrje"*, SHBA, 2005, faqe 17.
3. Bicchieri C, Jiang T, Lindemans J. A, *"Social Norms Perspective on Child Marriage: The General Framework. Draft report for UNICEF"*, Philadelphia: Behavioral Ethics Lab, University of Pennsylvania; (2014).
4. Grup autorësh *"E drejta familjare"*, Tiranë, 2006.
5. Galgano. F, *"E drejta Private"*, Luarasi, Tiranë.
6. Hamdi Podvorica, *"Pengesat dhe ndalesat martesore"*, publikuar nga *"e drejta"*, nr.1, Prishtinë, 2005.
7. Hamdi Podvorica, *"E drejta familjare"*, Prishtinë, 2011, faqe 69.
8. Kneller G., *"Educational Anthropology: An Introduction. London"*, UK: John Wiley & Sons; (1965).
9. J. Cherlin, Andrew, *"Deinstitucionalizimi i Martesës Amerikane"*, edicioni 4, vëllimi 66, publikuar nga Këshilli Kombëtar për Marrëdhëniet Familjare, në mentor 2004, faqe 854.
10. Julian Le Grand, Bill New, *"Paternalizmi Qeveritar: Shtetë i dadove apo mikë i dobishëm"* (Government Paternalism: Nanny State Or Helpful Friend?), Britania e Madhe, botuar nga Universiteti i Princetonit, 2015, faqe 22.
11. Karl Hanson, *"Pjesëmarrja e fëmijëve dhe agjencive kur fëmijët nuk bëjnë gjenë e duhur"* (Children's Participation and Agency When They Don't Do the Right Thing), volumni 23, nr.4, *"Sage Journal"* me 09.11.2016, faqe 471–475.
12. Le Grand, Julian, New, Bill, *"Paternalizmi Qeveritar: Shtetë i dadove apo mikë i dobishëm"* (Government Paternalism: Nanny State Or Helpful Friend?), Britania e Madhe, botuar nga Universiteti i Princetonit, 2015, faqe 22.
13. Mandro Arta, *"E Drejta Familjare"*, Ermal, Tiranë.
14. Mandro Arta, Lamçe Juleda, *"E drejta familjare përmes rasteve praktike"*, Tiranë.
15. Margaret Jolly, *"Woman Ikat Raet Long Human Raet O No?" Women's Rights, Human Rights and Domestic Violence in Vanuatu"*, Feminist Review, nr.52 (1996): 169–90.
16. Peter Bydlinski, *"E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme"* vëllimi I, botimi 6, përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe nga Prof.Asoc.Dr.iur.Iset Morina LL. M. dhe Bekim Sermaxhaj M. A., 2013, Vjenë, faqe 49–50.
17. Rachel Vogelstein, *"Ending Child Marriage: How Elevating the Status of Girls Advances U.S. Foreign Policy Objectives"* publikuar nga Shtetet e Bashkuara: Këshilli për Punët e Jashtme, 2013.
18. Ruzhdi Berisha, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, *"E drejta familjare KIEAI, doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës"*, Prishtinë, 2004, faqe 496.

19. Abdulla Aliu & Haxhi Gashi, "E drejta familjare", ribotim, Prishtinë, Mars 2022.
20. Abdulla Aliu, "E Drejta Civile- Pjesa e përgjithshme", botuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Juridik, 2013, faqe 240.
21. Sally Engle Merry, "Të drejtat globale të njeriut dhe lëvizjet sociale lokale në një botë juridikisht pluralë" (Global Human Rights and Local Social Movements in a Legally Plural World), Canadian Journal of Law and Society, 1997, 247–72.
22. Sonila Omari, "E drejta familjare", Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 2010, faqe 45.
23. Stephan Hopgood, "Moderniteti në Përparësi: Të Drejtat e Njeriut Takohen me FGM, në Paternalizmi përtej kufijve" (Modernity at the Cutting Edge: Human Rights Meets FGM, in Paternalism Beyond Borders), ed. Michael N. Barnett, Kembrixh –Britania e Madhe, publikuar nga Shtypi i Universitetit Cambrige, 2017, faqe 256–91.
24. Valentina Zaçe, "Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar", Tiranë 1999, faqe 45.
25. Enver Hasani dhe Ivan Čukalović, "Kommentar-Kushtetuta e Republikës së Kosovës", botimi I, 2013, publikuar nga GLZ, i qasshëm në këtë link: [http://jus.igjk.rks-gov.net/487/1/Komentari\\_Kushtetuta\\_11\\_Shqip.pdf](http://jus.igjk.rks-gov.net/487/1/Komentari_Kushtetuta_11_Shqip.pdf)
26. Haxhi Gashi, Abdulla Aliu dhe Adem Vokshi, "Kommentar i Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës", publikuar nga GLZ, Prishtinë, 2012, faqe 86.
27. Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani (2014), "Kommentari Kodit Penal të Republikës së Kosovës", GLZ, Prishtinë, faqe 676, i qasshëm në këtë link: <http://jus.igjk.rksgov.net/485/1/Komentari%20%20Kodi%20Penal%20i%20Kosoves.pdf> [Parë për herë të fundit 10 shkurt 2025].

## II. Legjislacioni vendor:

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, numër K-09042008, e publikuar në Gazetën Zyrtare, me dt.09.04.2008;
2. Kodi Penal i Republikës së Kosovës me nr.06/L-074, i publikuar në gazetën zyrtare me nr.2 i datës 14 janar 2019;
3. Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2022;
4. Ligji Nr. 08/L -187 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, i vitit 2023;
5. Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2018 dhe ka filluar të zbatohet nga viti 2019;
6. Ligji me nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore i publikuar në Gazetën Zyrtare me nr.45/2019 me dt.12.01.2019;
7. Ligji nr.04/L-003 për Gjendjen Civile i publikuar në gazetën zyrtare me nr. 6/2011 me 22.07.2011;
8. Ligji nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, i publikuar në gazetën zyrtare me nr.14/17 i datë 17 korrik 2019;
9. Ligji me nr.08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare i publikuar në Gazetën Zyrtare me nr.1/2024, me dt.05.01.2024;
10. Ligji nr.08/L-028 për të Drejtën Ndërkombëtare Private, publikuar në Gazetën Zyrtare me nr.30/5, shtator 2022, Prishtinë, nenet 26-27;
11. Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, i publikuar në gazetën zyrtare me nr.4/2006, me dt.01.09.2006;
12. Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2015;
13. Ligji nr. 08/L-185 Për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, i cili ka hyrë në vitin 2023;
14. Ligji Nr. 05/L -021 Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2015;
15. Ligji Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2012;
16. Ligji Nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas Ndihmë Juridike Falas, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2022;
17. Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2019;
18. Ligji Nr. 04/L-076 Për Policinë, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2012;



19. Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgiminë, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2004;
20. Ligji Nr. 03/L-110 për Ndërprerjen e Shtatzënisë, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2009;
21. Ligji Nr. 08/L-158 Për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme;
22. Ligji Nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës;
23. Ligji Nr. 04/L-037 Për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës;
24. Ligji Nr. 04/L-125 Për Shëndetësi, në pjesën që i referohet kujdesit shëndetësor;
25. Ligji Nr. 2004/38 Për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Banorëve të Kosovës në Sistemin Shëndetësor.

### III. Legjislacioni Ndërkombëtar

Republika e Kosovës, ndonëse nuk është anëtare e organizatave ndërkombëtare si OKB, BE, Këshilli i Evropës, të cilat kanë nxjerrë marrëveshjet dhe instrumentet e mësipërme juridike ndërkombëtare, megjithatë, me nenin 22 të Kushtetutës së saj, i ka bërë drejtëpërdrejt të zbatueshme disa nga marrëveshjet dhe instrumentet kryesore ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, të listuara si më poshtë:

1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 10 dhjetor 1948;
2. Konventa Ndërkombëtare për të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 3 janar 1976;
3. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, 23 mars 1976;
4. Karta e të Drejtave Fundamentale të Bashkimit Evropian, 1 dhjetor 2009;
5. Karta Sociale Evropiane e Këshillit të Evropës, 26 shkurt 1965;
6. Konventa e Këshillit të Evropës për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve, 25.1.1996;
7. Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj, Romë, 4.XI.1950;
8. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore dhe poshtëruese, 26 qershor 1987;
9. Konventa mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës, e miratuar më 25 tetor 1980 në Hagë;
10. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, e nënshkruar në vitin 1995 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1998;
11. Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave” e cila ka hyrë në fuqi me 3 shtator 1981, neni 16, tani e tutje e njohur si “CEDAW”;
12. Konventa për të Drejtat e Fëmijës”, 25 nëntor 1989;
13. Organizata e Kombeve të Bashkuara, “Konventa për pëlqimin për martesë, moshën minimale për martesë dhe regjistrimin e martesave”;
14. Konventa plotësuese për heqjen e skllavërisë, tregtisë së skllavërve dhe institucioneve dhe praktikave të ngjashme me skllavërinë;
15. Konventa në Parandalimin dhe Luftimi i dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje” e njohur si “Konventa e Stambollit”;
16. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, “Raporti i Raportuesit Special për Format Bashkëkohore të Skllavërisë, përfshirë Shkaqet dhe Pasojat e saj - Raport Tematik mbi Martesën Servile (të detyruara)”, publikuar më 10 korrik 2012, faqe 7, pika 27, për më shumë shikoni në linkun: [https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/HRBodies/HRCouncil/RegularSession/Session21/A-HRC-21-41\\_en.pdf](https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/HRBodies/HRCouncil/RegularSession/Session21/A-HRC-21-41_en.pdf) [Parë për herë të fundit 09 shkurt 2025];
17. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, “Rekomandim në pëlqimin për martesë, mosha minimale për martesë dhe regjistrimin e martesave” i publikuar më 1 nëntor 1965, me nr.A/RES/2018(XX)<https://www.refworld.org/docid/3b00f05a63.html> [parë për herë të fundit më 09 shkurt 2025];

18. Bashkimi Europian, "Rezoluta e 4 tetorit 2017 për përfundimin e martesës së fëmijës" me nr.2017/2663(RSP), pikat B, C, E, G, H dhe K, rezoluta mund të lexohet në këtë link: [https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2017-0379\\_EN.html](https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2017-0379_EN.html) [parë për herë të fundit me 10 shkurt 2025];
19. Bashkimi Europian, "Rezoluta e 4 korrikut 2018 drejt një strategjie të jashtme të BE-së kundër martesave të hershme dhe të detyruara – hapat e ardhshëm" e 4 korrik 2018, pika A, C dhe F, rezoluta e qasshme në këtë link: [https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2018-0292\\_EN.html](https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2018-0292_EN.html), [parë për herë të fundit me 12 shkurt 2025];
20. Bashkimi Europian, "Rezoluta e 24 qershorit 2021 mbi situatën e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe të drejtave në BE, në kuadër të shëndetit të grave" me nr.2020/2215(INI), faqe 18, pika 61, e qasshme në këtë link: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52021IP0314>, [parë për herë të fundit me 13 shkurt 2025];
21. Këshilli i Europës, "Rezoluta 1468 për Martesat e Detyruara dhe Martesat e Fëmijëve" e datës 5 tetor 2005, e qasshme në këtë link: <https://www.refworld.org/docid/43f5d5184.html> [parë për herë të fundit me 15 shkurt 2025];
22. Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve (CRC), "Komenti i përgjithshëm nr.4 (2003): Shëndeti në adoleshencë dhe Zhvillim në kontekst të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve", 1 korrik 2003, CRC/GC/2003/4, i qasshëm në këtë link: <https://www.refworld.org/docid/4538834f0.html> [Parë me datë 17 shkurt 2025];
23. Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF), "Koment i përgjithshëm nr. 14 (2013) mbi të drejtën e fëmijës që interesat e tij/saj më të mira të merren si konsideratë parësore (neni 3, para. 1)", CRC / C/GC/14, 29 maj 2013, <https://www.refworld.org/legal/general/crc/2013/en/95780>[Parë për herë të fundit më 13 shkurt 2025];
24. Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), "Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 21 i CEDAW: Barazia në Marrëdhëniet Martesore dhe Familjare", 1994, i disponueshëm në këtë link: <https://www.refworld.org/docid/48abd52c0.html>[Parë për herë të fundit me 15 shkurt 2025];
25. Organizata e Kombeve të Bashkuara, "Deklaratë e përbashkët e shkruar - dorëzuar nga Girls Not Brides: Partneritet Ndërkombëtar për ti dhënë fund martesës së fëmijëve", publikuar nga Këshilli për të drejtat e njeriut, 30 maj 2023, faqe 2, i qasshëm në menyrë elektronike në këtë link: [https://www.girlsnotbrides.org/documents/1987/HRC\\_written\\_statement\\_for\\_ID\\_with\\_UNSR\\_VAWG\\_7328\\_A\\_HRC\\_53\\_NGO\\_Sub\\_En.pdf](https://www.girlsnotbrides.org/documents/1987/HRC_written_statement_for_ID_with_UNSR_VAWG_7328_A_HRC_53_NGO_Sub_En.pdf) [parë për herë të fundit më 13 shkurt 2025];
26. Rezoluta 1325 e Këshilit të Sigurimit të OKB-së,"Gruaja, Paqja dhe Siguria", 31 tetor 2000.

#### IV. Burime tjera të konsultuara:

1. Raport i Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut "Parandalimi dhe eliminimi i martesave të hershme dhe të detyruara të fëmijëve", A/HRC/26/22, 2 prill 2014, në dispozicion tek <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/n11/469/02/pdf/n1146902.pdf?token=h1O6UXfoHdESSkCOYG&fe=true>;
2. UNHCR, "Historiku Legjislativ i Konventës për të Drejtat e fëmijëve" volumni I, New York dhe Gjenevë, 2017, faqe 305-313, i qasshëm në këtë link: [https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Publications/LegislativeHistorycrc1\\_en.pdf](https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Publications/LegislativeHistorycrc1_en.pdf), [parë të herë të fundit me më 09 qershor 2024];
3. Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, "Fëmijët dhe Martesa e Detyruar, të përfshira në cilësimin humanitar - OHCHR dhe të drejtat e grave dhe barazia gjinore" i qasshëm në menyrë elektronike në këtë link: <https://www.ohchr.org/en/women/child-and-forced-marriage-including-humanitarian-settings> [Parë për herë të fundit me më 09 qershor 2024];
4. Michaels, Ralf. "Martesat e huaja të fëmijëve dhe ligji kushtetues – Gjykata Kushtetuese Gjermane konsideron se janë jo kushtetuese pjesë të ligjit gjerman për luftimin e martesave të fëmijëve, Konflikti i Ligjeve" 12 Prill 2023, artikull i qasshëm në këtë link: <https://conflictoflaws.net/2023/foreign-child-marriages-and-constitutional-law/>, [Parë për herë të fundit më 09 qershor 2024];

5. Organizata Botërore e Shëndetësisë, *"Parandalimi i shtatzënësisë së hershme dhe rezultatet e dobëta riprodhuese: Në mesin e adoleshentëve të vendeve në zhvillim"*, Gjenevë -Zvicërr, 2011 [https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/44691/9789241502214\\_eng.pdf?sequence=1](https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/44691/9789241502214_eng.pdf?sequence=1) [Parë për herë të fundit më 09 qershor 2024];
6. Prof. Dr. Arta Mandro-Bilali, *"Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore: Roli i gjyqësorit shqiptar në eliminimin e tij"* publikuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe UNDP, faqe 66, për më shumë mund të lexoni studimin e autores të qasshëm në këtë link: <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Diskriminimi-gjinor-ne-ceshtjet-familjare-A-Mandro.pdf> [Parë për herë të fundit më 09 qershor 2024];
7. Prof. Dr. Arta Mandro – Bilali, *"Martesë në Gjykatë? Të drejtat e fëmijëve, martesë nën moshë dhe roli i Gjykatës"*, raporti 2, Tiranë, qershor 2018, faqe 14, për më shumë lexoni në linkun: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/07/Raport2-Analiza-ligjore-dhe-sociale-e-marteseve-n%C3%ABn-mosh%C3%AB-Qershor2018.pdf> [parë për herë të fundit më 09 qershor 2024];
8. Republika e Kosovës, Ministria e Drejtësisë, *"Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhunandaj Grave 2022–2026"*, publikuar në janar 2022, faqe 17, e qasshme në këtë link: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ALB-Strategjia-Kombe%CC%88tare-pe%CC%88r-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne%CC%88-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-%E2%80%932026.pdf>. [parë për herë të fundit më 09 qershor 2024];
9. Republika e Kosovës *"Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve"*, faqe 14, i qasshëm në këtë link: [https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/11-38-06\\_05122018/Strategjia\\_per\\_te\\_drejta\\_%20e\\_femijeve.pdf](https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/11-38-06_05122018/Strategjia_per_te_drejta_%20e_femijeve.pdf);
10. UNICEF Data: Monitoring the situation of children and women -Early childbearing, në këtë link : <https://data.unicef.org/topic/child-health/adolescent-health/> [Parë për herë të fundit më 09 qershor 2024];
11. UNICEF, *"25 Million Child Marriages Prevented in Last Decade Due to Accelerated Progress, According to New UNICEF Estimates"*, 6 Mars 2018, i qasshëm në këtë link: [https://www.unicef.org/media/media\\_102735.html](https://www.unicef.org/media/media_102735.html);
12. United Nations Population Fund (UNFPA) and United Nations Children's Fund (UNICEF), *"Raporti i vitit 2019 për martesën e fëmijëve"* në kuader të programit global për përfundimin e martesave të fëmijëve, gusht 2020, i qasshëm në këtë link: <https://www.unicef.org/media/83516/file/Child-marriage-annual-report-2019.pdf>;
13. Protokoll i shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale 23.11.2022;
14. Strategjia kundër dhunës në familje dhe Dhuna Ndaj Grave 2022-2026;
15. Platforma për Veprim në aspektet e dhunës ndaj grave, e miratuar në Konferencën e katërt Botërore për Gratë, e organizuar nga OKB, Pekin, Kinë, Shtator 1995;
16. Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzues për Politikën Ndeshkimore, që përfshin udhëzimet për gjyqtarë për caktimin e sanksioneve penale në rastet e dhunës në marrëdhënie familjare.

## V. Raste nga praktika gjyqësore e GJEDNJ:

1. **B. dhe L. kundër Britanisë së Madhe**, nr. 36536/02; vendim i 13 shtatorit 2005, vendimi i plotë mund të lexohet për më shumë në këtë link: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22tabview%22:%22document%22},%22itemid%22:%22001-70136%22}>
2. **Delecalle kundër Francës**, numri i aplikimit 37646/13, 25 tetor 2018, paragrafi 43 [GJDNJ], duke përfshirë edhe mendimin mospajtues (mendim i ndarë) nga gjyqtari Nussberger, rasti i qasshëm në këtë link: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22tabview%22:%22document%22},%22itemid%22:%22001-187455%22}>

3. **F. kundër Zvicrës**, vendim nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, aplikimi nr.11329/85, vendim i datës 18 dhjetor 1987, Seria A nr.128, paragrafi 32 [CP].
4. **Frasik kundër Polonisë**, vendim i 5 janar 2010, paragrafi 83, Strasburg. Vendimin e plotë mund ta lexoni në këtë link: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22tabview%22:\[%22document%22\],%22itemid%22:\[%22001-96453%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22tabview%22:[%22document%22],%22itemid%22:[%22001-96453%22]})
5. **Janis Khan kundër Britanisë së Madhe**, me numër aplikimi 11579/85, vendim i dt.7.07.1986, i qasshëm në këtë link: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22display%22:\[2\],%22itemid%22:\[%22001-76851%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22display%22:[2],%22itemid%22:[%22001-76851%22]})
6. **Jaremowicz kundër Polonisë**, numri i aplikimit 24023/03, me 5 janar 2010, Strasburg, paragrafi 49, i qasshëm në këtë link: - [https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-96455#{%22itemid%22:\[%22001-96455%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-96455#{%22itemid%22:[%22001-96455%22]})
7. Urdhër pezullimi dhe referimi, Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, i datës 14 nëntor 2018 (XII ZB 292/16)”, faqe 10, pika 112, i qasshëm në këtë link: [https://www.bundesverfassungsgericht.de/SharedDocs/Downloads/EN/2023/02/Is20230201\\_1bvl000718en.pdf?\\_\\_blob=publicationFile&v=2](https://www.bundesverfassungsgericht.de/SharedDocs/Downloads/EN/2023/02/Is20230201_1bvl000718en.pdf?__blob=publicationFile&v=2)
8. **Z.H. dhe R.H. kundër Zvicrës**, aplikimi me nr.60119/12, vendim i formës së prerë me dt.08 mars 2016, Strasburg, [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-159050%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-159050%22]}).



